

**INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVO
ADMINISTRATA E PERKOHSHME E KOSOVËS
PRIVREMENA ADMINISTRACIJA KOSOVA**

GJYKATA E QARKUT PRIZREN

Mban seancën në ambientet e Gjykatës së Qarkut Gjilan

P. Nr. 85/2005

10 Gusht 2006

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut Prizren, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ndërkombëtar Vinod Boolell si Kryetar i Trupit Gjykues, dhe Gjyqtarët Ndërkombëtarë Leonard Assira dhe Nurul Khan, si anëtarë të trupit Gjykues

Në procedimet penale kundër:

Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj dhe Islam Gashi të akuzuar për Krime Luftë të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunim të shëndetit trupor të të ndaluarve civil dhe aplikimin e masave të kanosjes dhe terrorit, në përputhje me Nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (KP RSFJ) në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së dhe Krime Luftë të Vrasjeve në kundërshtim me Nenin 142 të KP të RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së,

Xhavit Elshani dhe Isuf Gashi të akuzuar për Krime Luftë të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm, në përputhje me Nenin 142 të KP RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së, Krime Luftë të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunim të shëndetit trupor të të ndaluarve civil dhe aplikimin e masave të kanosjes dhe terrorit, në përputhje me Nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (KP RSFJ) në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së dhe Krime Luftë të Vrasjeve në kundërshtim me Nenin 142 të KP të RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së,

Agron Krasniqi i akuzuar për Krime Luftë të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunim të të shëndetit trupor të të ndaluarve civil dhe aplikimin e masave të kanosjes dhe terrorit, në përputhje me Nenin 142 të KP RSFJ në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së dhe Krime Luftë të Vrasjeve në kundërshtim me Nenin 142 të KP të RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së,

në praninë e procesmbajtëses Nina Maric, për shqyrtimit kryesor të mbajtur në 29 Shtator, 14, 19, 26 Tetor, 9, 10, 16, 23, 30 Nëntor, 1, 14, 15 Dhjetor 2005 dhe 8, 9, 15, 16, 22 Shkurt, 1, 15, 16, 22 Mars, 3, 10, 11, 17, 18, 23, 24, 25, 31 Maj, 1, 2, 7, 8, 14, 21, 22, 28, 29 Qershor, 19, 27 Korrik, 7, 8, 10 Gusht 2006 në prani të Prokurorit Publik Ndërkombëtar Jude Romano (nga 29 Shtatori 2005 deri 22 Shkurt 2006) dhe Paul Flynn (nga 1 Marsi deri në 10 Gusht 2006), Këshilltares Ligjore për Divizionin Penal, Andrey Antonov, të akuzuarit, Selim Krasniqi, dhe Avokatit të tij Mbrojtës, Mahmut Halimi, të akuzuarit, Bedri Zyberaj, dhe Avokatëve të tij Mbrojtës, Haxhi Millaku (nga 29 Shtatori deri në 15 Dhjetori 2005) dhe Rexhep Hasani, i emëruar sipas detyrës zyrtare, (nga 8 Shkurti deri në 10 Gusht 2006), të akuzuarit, Xhavit Elshani, dhe Avokatit të tij Mbrojtës sipas detyrës zyrtare, Fatmir Celina (të dy nga 29 Shtatori 2005 deri në 27 Korrik 2006, dhe në 10 Gusht 2006), të akuzuarit, Isuf Gashi dhe Avokatit të tij Mbrojtës, Ethem Rogova (nga 29 Shtatori 2005 deri në 27 Korrik 2006, dhe në 10 Gusht 2006), të akuzuarit, Islam Gashi, dhe Avokatit të tij Mbrojtës Mexhid Sylja, të akuzuarit Agron Krasniqi dhe Avokatit të tij Mbrojtës, Fazli Balaj (nga 3 Maji deri në 10 Gusht 2006), dhe Këshilltares Ligjore për IJSD-së Virginie Monchy, (e zëvendësuar më vonë nga Këshilltari Ligjor për IJSD Leanne Ho).

Publikisht shpall në këtë ditë, 10 Gusht 2006, si më poshtë:

AKT GJYKIMIN

Në përputhje me Nenin 391 Paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK-së),

Selim KRASNIQI, i lindur në 1 Prill 1970 në fshatin Vllashki Dranovc, Komuna e Malishevës, me nofkën: “Çeliku” apo “Çelik”, emri i babait: ██████ Krasniqi, emri i nënës: ██████ ██████, shqiptar i Kosovës, banues në Ortokoll, Prizren, i martuar dhe ka dy (2) fëmijë, Komandant i RTG2 – TMK, Prizren, Gjeneral Brigade, di shkrim dhe lexim, ka kryer shkollën e mesme dhe po diplomohet për ekonomik, me gjendje të mesme financiare, numri i identifikimit ne TMK 00624, pa ndonjë çështje tjetër penale kundër tij, në paraburgim që prej 16 Shkurtit 2004, është

FAJTOR

Sepse në një datë mes 1 Majit 1998 dhe 31 Gushtit 1998, Selim Krasniqi, në bashkëpunim me të tjerë dhe sipas një plani të përbashkët penal, ka ndaluar në mënyrë të paligjshme civilët shqiptarë të Kosovës, ka marrë pjesë në arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm të civilëve shqiptarë të Kosovës që dyshoheshin se ishin bashkëpunëtorë të serbëve dhe i kanë mbajtur këta civilë në vendin që ndodhet në fshatin Drenovc të Zatriqit, Komuna e Rahovecit, ku ata janë mbajtur në kushte çnjerëzore pa qasje ndaj një procesi të duhur dhe janë rrahur duke i shkaktuar vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre. Mes këtyre civilëve të arrestuar dhe të mbajtur në mënyrë të paligjshme dhe të rrahur ishin: Sh█████ Sh█████ B█████ B█████, H█████ P█████, M█████ R█████, H█████ T█████, A█████ B█████, H█████ K█████ si dhe dëshmitarët “A”, “E”, “U”, “W” dhe “X”.

Duke marrë pjesë në veprimet e lartpërmendura që përbëjnë kryerjen dhe vazhdimësinë e trajtimit çnjerëzor të qytetarëve shqiptarë të Kosovës, Selim Krasniqi mban përgjegjësi

peronave për krimet e luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunim të shëndetit trupor të të ndaluarve civil dhe aplikimin e masave të kanosjes dhe terrorit, në përputhje me Nenin 142 të (KP RSFJ) në lidhje me Nenet 22, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së

Bedri ZYBERAJ, i lindur në 6 Maj 1963 në Gjakovë, emri i babait: ██████████ Zyberaj, emri i nënës: ██████████, shqiptar i Kosovës, banues në Prishtinë, Lagja Lakrishte rruga Nr. 24, hyrja Nr. 3, kati i 6të, i martuar dhe ka katër (4) fëmijë, Oficer Protokolli, Selia Qendrore e TMK-së Prishtinë, Nën-Kolonel, di shkrim dhe lexim, ka kryer një Master të Shkencave Filologjike, me gjendje të varfër financiare, me numër identifikimi në TMK 00010, nuk ka çështje të tjera penale kundër tij, i paraburgosur që prej 16 Shkurtit 2004, është

FAJTOR

Sepse në një datë mes 1 Majit 1998 dhe 31 Gushtit 1998, Bedri Zyberaj, në bashkëpunim me të tjerë dhe sipas një plani të përbashkët penal për të ndaluar në mënyrë të paligjshme shqiptarë civilë të Kosovës, ka marrë pjesë në arrestimin e paligjshëm dhe mbajtjen e civilëve shqiptarë të dyshuar si bashkëpunëtorë të serbëve dhe i kanë mbajtur këto civilë në një vend që ndodhet në fshatin Drenovc të Zatriqit, Komuna e Rahovecit, ku ata janë mbajtur në kushte çnjerëzore pa qasje ndaj një procesi të duhur dhe janë rrahur duke iu shkaktuar atyre vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre. Mes këtyre civilëve të arrestuar dhe të mbajtur në mënyrë të paligjshme dhe që janë rrahur ishin: Sh██████ Sh██████ B██████ B██████, H██████ P██████ M██████ R██████, H██████ T██████, A██████ B██████, H██████ K██████ si dhe Dëshmitarët "A", "E", "U", "Ë" dhe "X".

Duke marrë pjesë në veprimet e lartpërmendura që përbëjnë kryerjen dhe vazhdimësinë e trajtimit çnjerëzor të qytetarëve shqiptarë të Kosovës, Bedri Zyberaj mban përgjegjësi penale për krimet e luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunim të shëndetit trupor të të ndaluarve civil dhe aplikimin e masave të kanosjes dhe terrorit, në përputhje me Nenin 142 të KP RSFJ-së në lidhje me Nenet 22, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së

Agron KRASNIQI, i lindur në 25 Tetor 1977 në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit, emri i babait: ██████████ Krasniqi, emri i nënës: ██████████ shqiptar i Kosovës, banues në CH8180 Zurich, Buelach, Lindenhof Street No. 4A, Zvicër, i martuar dhe ka një (1) fëmijë, vozitës, ka kryer shkollën e mesme dhe ka filluar studimet në Juridik në universitet, me gjendje të mesme financiare, nuk ka ndonjë vepër tjetër penale kundër tij, i paraburgosur që prej 9 Dhjetorit 2005, është

Fajtor

Sepse në një datë mes 1 Majit 1998 dhe 31 Gushtit 1998, Agron Krasniqi, në bashkëpunim me të tjerë dhe sipas një plani të përbashkët penal për të ndaluar në mënyrë të paligjshme shqiptarët civilë të Kosovës, ka marrë pjesë në arrestimin e paligjshëm dhe mbajtjen e civilëve shqiptarë të dyshuar si bashkëpunëtorë të serbëve dhe i kanë mbajtur këto civilë në një vend që ndodhet në fshatin Drenovc të Zatriqit, Komuna e Rahovecit, ku ata janë mbajtur në kushte çnjerëzore pa qasje ndaj një procesi të duhur dhe janë rrahur duke iu shkaktuar atyre vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre. Mes këtyre civilëve të arrestuar dhe të mbajtur në

mënyrë të paligjshme dhe që janë rrahur ishin: Sh [redacted] Sh [redacted] B [redacted] B [redacted], H [redacted] P [redacted], M [redacted] Rr [redacted], H [redacted] T [redacted], A [redacted] B [redacted], H [redacted] K [redacted] si dhe Dëshmitarët "A", "E", "U", "Ë" dhe "X".

Duke marrë pjesë në veprimet e lartpërmendura që përbëjnë kryerjen dhe vazhdimësinë e trajtimit çnjerëzor të qytetarëve shqiptarë të Kosovës, Agron Krasniqi mban përgjegjësi penale për krimet e luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunim të shëndetit trupor të të ndaluarve civil dhe aplikimin e masave të kanosjes dhe terrorit, në përputhje me Nenin 142 të KP RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së

DËNIMET

Për veprën penale të krime lufte kundër popullsisë civile siç u tha më lart:

Selim Krasniqi dënohet me shtatë (7) vjet burgim,

Bedri Zyberaj dënohet me shtatë (7) vjet burgim,

Agron Krasniqi dënohet me shtatë (7) vjet burgim.

Në përputhje me Nenin 50 të KP të RFSJ-së, koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në kohën e kaluar për:

Selim Krasniqi nga 16 Shkurti 2004 deri kur gjykimi të bëhet përfundimtar,

Bedri Zyberaj nga 16 Shkurti 2004 deri kur gjykimi të bëhet përfundimtar,

Agron Krasniqi nga 9 Dhjetori 2005 deri kur gjykimi të bëhet përfundimtar.

Në përputhje me Nenin 390 Paragrafin 3 të KPPPK-së, Agron KRASNIQI,

LIROHET NGA

akuza e krimit të luftë për trajtimin çnjerëzor dhe shkaktimin e vuajtjeve të mëdha apo dhunimit të shëndetit trupor të Dëshmitarit "X" duke aplikuar masa të kanosjes dhe terrorit në kundërshtim me nenin 142 të KP të RFSJ-së e lexuar së bashku me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së, ku në një datë mes 2 Qershorit 1998 dhe 31 Gushtit 1998, Agron Krasniqi, në bashkëpunim dhe i ndihmuar nga të tjerë dhe në sipas një plani të përbashkët penal, ka ndaluar në mënyrë të paligjshme civilë shqiptarë të Kosovës, ka marrë pjesë në arrestimin e paligjshëm dhe ndalimin e Dëshmitarit "X" i dyshuar si bashkëpunëtor i serbëve dhe e ka mbajtur këtë civil në një ven që ndodhet në fshatin Dranovcku Dëshmitari "X" është mbajtur në kushte çnjerëzore pa qasje nga një procesi të duhur dhe është rrahur dhe torturuar duke iu shkaktuar vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tij.

Në përputhje me Nenin 390 Paragrafin 3 në lidhje me Nenin 3 Paragrafin 2 të KPPPK-së,

Islam GASHI, i lindur në 22 Janar 1974 në fshatin Drenovac, Komuna e Rahovecit, emri i babait [REDACTED] Gashi, emri i nënës [REDACTED], shqiptar i Kosovës, banues në fshatin Drenovac, Komuna e Rahovecit, beqar, major në TMK, di shkrim dhe lexim, ka kryer arsimin e lartë për matematikë, me gjendje të varfër financiare, nuk ka ndonjë çështje penale tjetër kundër tij, i paraburgosur që prej 24 Majit 2004,

LIROHET

nga akuza e krimit të luftës për trajtimin çnjerëzor dhe shkaktimin e vuajtjeve të mëdha apo dhunimit të shëndetit trupor të të ndaluarve civilë duke aplikuar masa të kanosjes dhe terrorit në kundërshtim me nenin 142 të KP të RFSJ-së e lexuar së bashku me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së, ku në një datë mes 2 Qershorit 1998 dhe 31 Gushtit 1998, Islam Gashi, në bashkëpunim dhe me ndihmën e të tjerëve sipas një plani të përbashkët penal ka ndaluar në mënyrë të paligjshme shqiptarë civilë të Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me serbët dhe i ka mbajtur këta civilë në një vend që ndodhet në fshatin Dranovc ku janë mbajtur në kushte çnjerëzore pa qasje nga një procesi të duhur dhe janë rrahur dhe torturuar duke i shkaktuar atyre vuajtje të mëdha dhe dhunim të shëndetit të tyre. Mes këtyre civilëve të arrestuar dhe të mbajtur në mënyrë të paligjshme dhe të rrahur ishin: Sh [REDACTED] Sh [REDACTED], B [REDACTED] B [REDACTED], H [REDACTED] P [REDACTED], M [REDACTED] R [REDACTED], H [REDACTED] T [REDACTED], A [REDACTED] B [REDACTED], H [REDACTED] K [REDACTED] si edhe Dëshmitarët "A", "E", "U", "Ë" dhe "X".

Në përputhje me Nenin 389 Paragrafin 1 të KPPPK-së, akuzat e mëposhtme

KUNDËRSHTOHEN NDAJ

Xhavit ELSHANIT, i lindur në 8 Korrik 1968 në fshatin Piran, Komuna Prizren, emri i babait [REDACTED] Elshani, emri i nënës [REDACTED], shqiptar i Kosovës, banues në fshatin Piran, Komuna Prizren, i martuar dhe ka tre (3) fëmijë, shef i zjarrfikësve të Reagimit të Shpejtë I të TMK-së, Pjesë e Zonës 2 të Mbrojtjes, Shiroke, Prizren, Kapiten, di shkrim dhe lexim dhe ka kryer shkollën fillore, numri i identifikimit i TMK-së 00566, Nr. ID. 1002612239, nuk po zhvillohet asnjë çështje tjetër penale kundër tij, i paraburgosur që prej 16 Shkurtit 2004 deri në 9 Qershor 2006,

DHE

Isuf GASHI, i lindur në 20 Prill 1946 në fshatin Dranovc, Komuna e Rahovecit, emri i babait [REDACTED] Gashi, emri i nënës [REDACTED], shqiptar i Kosovës, banues në fshatin Dranovc, Komuna Rahovec, i martuar dhe ka pesë (5) fëmijë, zyrtar i shoqatës së veteranëve të luftës në Komunën e Rahovecit dhe gjyqtar porod në Gjykatën Komunale të Rahovecit, di shkrim dhe lexim, ka kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër financiare, numri i letërnjoftimit 1007989187, nuk po zhvillohet asnjë procedim tjetër penal kundër tij, i paraburgosur që prej 24 Majit 2004 deri në 9 Qershor 2006,

1) Krime Luftë të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm në kundërshtim me Nenin 142 të KP RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së i cili në ditët mes 2 Qershorit 1998 dhe 13 Korrikut 1998, Xhavit Elshani dhe Isuf Gashi, duke vepruar në bashkërendim me

persona të tjerë dhe sipas një plani të përbashkët penal, urdhëruan dhe morën pjesë, drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi në arrestimet dhe ndalimet e paligjshme të civilëve shqiptarë të Kosovës në Qendrën e Paraburgimit në Drenovc. Në mesin e personave civilë të arrestuar ishin:

- i. Sh■■■■ Sh■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 2 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot, ai nuk është parë më kurrë.
- ii. B■■■■ B■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 3 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- iii. H■■■■ K■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 4 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- iv. H■■■■ P■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 7 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- v. M■■■■ R■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 10 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- vi. H■■■■ T■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 2 Korrik 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- vii. A■■■■ B■■■■ në mënyrë të paligjshme është arrestuar dhe ndaluar në 13 Korrik 1998 në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.

2) Krime të Luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha apo dhunimit të shëndetit trupor të të ndaluarve civilë dhe aplikimit të masave të kanosjes dhe terrorit në kundërshtim me Nenin 142 të KP RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RFSJ-së ku në ditët mes 2 Korrikut 1998 dhe 13 Korrik 1998, Xhavit Elshani dhe Isuf Gashi, duke vepruar në bashkërendim me persona të tjerë dhe sipas një ndërmarrjeje të përbashkët penale, në mënyrë të paligjshme kanë ndaluar në Qendrën e Paraburgimit civilë shqiptarë të Kosovës, urdhëruan dhe morën pjesë në kryerjen dhe vazhdimësinë e trajtimit çnjerëzor të civilëve shqiptarë të Kosovës që janë ndaluar në mënyrë të paligjshme të mbajtur në Qendrën e paraburgimit që ndodhej në fshatin Drenovc duke i vendosur këta civilë të ndaluar në kushte çnjerëzore dhe duke i privuar ata nga kushtet e duhura sanitare, ushqimi dhe uji dhe trajtimit të nevojshëm mjekësor. Trajtimi çnjerëzor i të ndaluarve civilë shkaktoi vuajtje të mëdha apo ishte një dhunim i integritetit dhe shëndetit trupor të këtyre të ndaluarve dhe u aplikuan masat e kanosjes dhe terrorit. Në mesin e civilëve që janë trajtuar në mënyrë çnjerëzore ishin shtatë (7) viktima të përmendur në paragrafin 61 të aktakuzës.

3) Krimet e luftës të rrahjes dhe torturimit në kundërshtim me Nenin 142 të KP RFSJ-së në lidhje me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP të RFSJ-së ku në ditët mes 2 Qershorit 1998 dhe 13 Korrikut 1998, Xhavit Elshani dhe Isuf Gashi ndërkohë që ishin anëtarë të UÇK-së, në bashkërendim me persona të tjerë dhe sipas një ndërmarrjeje të përbashkët penale, urdhëruan dhe morën pjesë, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në rrahjen dhe torturimin e civilëve të mbajtur në mënyrë të paligjshme në Qendrën e Paraburgimit në fshatin Drenovc. Në mesin e këtyre civilëve që u rrahën dhe u torturuan ishin shtatë (7) viktimat e përmendur në paragrafin 61 të Aktakuzës.

SHPENZIMET

Në përputhje me Nenin 102 Paragrafin 1 të KPPPK-së, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj dhe

Agron Krasniqi duhet të paguajnë shpenzimet e procedimeve penale. Në përputhje me Nenin 102, paragrafin 4 të KPPPK-së, Bedri Zyberaj lirohet plotësisht nga detyra për të paguar shpenzimet e procedimeve penale.

Në përputhje me Nenin 103 Paragrafin 1 të KPPPK-së, Xhavit Elshani, Isuf Gashi dhe Islam Gashi nuk duhet të paguajnë shpenzimet e procedimeve penale.

KËRKESA PASURORE JURIDIKE E PALËS SË DËMTUAR

Në përputhje me Nenin 109 Paragrafin 2 dhe Nenin 112 Paragrafët 2 dhe 3 të KPPPK-së, në lidhje me Nenin 391 Paragrafin 1 Pika 6 e KPPPK-së, çdo kërkesë pasurore juridike e palës së dëmtuar të ndiqet në shkallën civile.

PUBLIKIMI NË MEDIA

Në përputhje me Nenin 391 Paragrafin 1 pikën 6 të KPPPK-së, ky gjykim mund të raportohet në media.

HISTORIKU

Në të gjitha kohërat deri në rastin në fjalë ka ekzistuar një gjendje e konfliktit të brendshëm të armatosur mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) dhe Republikës së Serbisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, duke përfshirë Ushtrinë Jugosllave (UJ) dhe forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ-së), Ministrisë së Brendshme, forcat e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë dhe ushtarët paramilitarë Serbë në territorin e Kosovës. Të dyja forcat e armatosura ishin nën komandën e përgjegjshme, dhe ushtronin kontroll në pjesë të territorit të Kosovës për t'i mundësuar atyre operacionet ushtarake të bëra dhe të drejtuara.

Rasti në fjalë ka të bëjë me rrethanat e lidhura me konfliktin e brendshëm të armatosur që po ndodhte në Kosovë dhe në veçanti në shtatë muajt e parë të 1998 ku pati një konflikt të gjatë dhe të madh në territorin e Kosovës që u zgjatua dhe ndikoi në vendin e quajtur Drenovc dhe fshatrat e tij përreth.

Mes Majit 1998 dhe Tetorit 1998, anëtarët e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) organizoi dhe drejtonin një qendër paraburgimi në fshatin Drenovc në Zatriq, Rahovec ("Qendër Paraburgimi"). Ekzistonte një politikë e UÇK-së e cila rezultoi në arrestimin, marrjen në pyetje, paraburgimin, rrahjen e paligjshme, torturën dhe në disa raste vrasjen e serbëve të Kosovës që nuk ishin luftëtarë dhe qytetarëve shqiptar të Kosovës që ishin dyshuar për bashkëpunim me autoritet serbe. UÇK-ja themeloi Qendrën e Paraburgimit ku i ka mbajtur këto të dyshuar në "izolim". Një numër viktimash janë marrë kundër dëshirës së tyre nga familjet e tyre dhe janë sjellë në Qendrën e Paraburgimit apo janë paraburgosur më vonë pasi janë shfaqur në Qendrën e Paraburgimit në raste të ndryshme.

NJË SHQYRTIM I PËRGJITHSHËM DHE I SHKURTËR I GJENDJES FAKTIKE

Në 2 Korrik 1998, Sh. SH, së bashku me H. M dhe F. H, shkuan në Shtabin e UÇK-së në Drenovc me automjetin e Sh. Sh. Sh. Sh është ndaluar nga ushtarët e UÇK-së ndërkohë që H. M dhe F. H janë lejuar që të shkonin në shtëpi. Në 3 apo 4 Qershor 1998, babai i Sh. Sh i shoqëruar nga H. M shkoi në Qendrën e Paraburgimit për të kërkuar Sh. Sh. Ata nuk janë lejuar që ta shikonin atë. Në vizitën e tij të dytë, tre ditë pas vizitës së tij të parë, R. Sh përsëri nuk arriti që ta shikonte viktimën. Megjithatë, dikush i tha atij tek shtabi se “Sh. Sh nuk është më këtu, ai është në Drenicë”. R. Sh e pa automjetin e Sh. Sh të parkuar jashtë shtabit. Ai kurrë nuk e pa më Sh. Sh pas 2 Qershorit 1998.

Në 3 Qershor 1998, B. B është arrestuar në mënyrë të paligjshme në shtëpinë e dajës së tij I. H në fshatin Ratkovc (Komuna e Rahovecit) nga ushtarët e UÇK-së M. L, R. Q, K dhe N. K me urdhër të G. P (nofka “ ”, tashmë i vdekur) që në atë kohë ishte komandanti i Policisë Ushtarake në fshatin Drenovc. Arrestimi i paligjshëm është parë nga I. H DHE Dëshmitari Anonim “B”. Dëshmitari anonim “A” e pa B. B në Qendrën e Paraburgimit me faqe të ënitura në 5 apo 6 Qershor 1998. Kjo ishte hera e fundit që Dëshmitari Anonim “A” e pa B. B.

Në 4 Qershor 1998 H. K është marrë nga shtëpia e tij nga ushtarët e UÇK-së Agron Krasniqi, Z. B, Islam Gashi dhe djali i axhës/dajës së Islam Gashit. Të nesërmen, Dëshmitarët Anonim “TT”, dhe “N” shkuan në Qendrën e Paraburgimit për të kërkuar H. K dhe ata mundën që të flisnin me Isuf Gashin, më pas me Selim Krasniqin, i cili i çoi ata tek Bedri Zyberaj. Dëshmitarët e panë viktimën disa javë pas arrestimit të tij të paligjshëm në një dhomë në Qendrën e Paraburgimit ku disa ushtarë të UÇK-së mes tyre edhe Selim Krasniqi dhe Islam Gashi, ishin gjithashtu të pranishëm.

Në 7 Qershor 1998, H. P në mënyrë të paligjshme u arrestua dhe u ndalua në Qendrën e Paraburgimit. Një ditë para arrestimit të tij të paligjshëm, djali i tij, M. P shkoi në Qendrën e Paraburgimit me H. D për të parë nëse emrat e tyre ishin në “listën e zezë”. M. P ishte ndaluar nga ushtarët e UÇK-së. Ushtarët e UÇK-së i thanë H. D që t’i thoshte H. P që të shkonte në Qendrën e Paraburgimit në mënyrë që djali i tij të lirohej. Kështu që H. P shkoi në Qendrën e Paraburgimit ku ai ishte ndaluar në mënyrë të paligjshme ndërkohë që djali i tij u lirua.

Në 10 Qershor 1998, M. RR është marrë jashtë shtëpisë së tij nga tre burra të veshur me uniforma të zeza, dy prej të cilëve janë identifikuar si Agron Krasniqi dhe Z. B. Të nesërmen, Në. RR dhe H. RR shkuan në shkollën e fshatit Drenovc ku ata e panë Z. B. Kur u përballën me Zaim Bajraktarin, ai i tha atyre se M. ishte mbyllur në bodrum dhe nëse donin të dinin më shumë për M. ata duhej të flisnin me Bedri Zyberajn. Bedri Zyberaj e pranoi tek ata se ai ishte personi përgjegjës për marrjen e M. RR dhe se ata do të bënin çka nevojitej për t’u bërë dhe do ta lëshonin.

Në 2 Korrik 1998, H. T dhe Z. T ishin në rrugën e tyre për të marrë nusen. Në rrugën Drenovc Paragan, ata janë ndaluar nga një pikë kontrolli i UÇK-së ku ishin katër ushtarë të armatosur të UÇK-së. Letërnjoftimet e tyre janë marrë dhe sjellë nga një

ushtar nga vreshtat. Më pas, një pres ushtarëve të UÇK-së u kthye dhe pyeti se kush ishte H. T. H. identifikoi veten e tij dhe pas tre orësh, një automjet] “Lada Caravan” mbërriti dhe e morën H. T. Ushtari i UÇK-së i tha Z. T. se ai mund të vinte që ta merrte H. të nesërmen në orën 08:00 të mëngjesit. Z. T. nuk u kthye më për shkak të frikës.

Në 13 Korrik 1998, A. B. është marrë në shtëpinë e tij nga shtatë ushtarë të UÇK-së që i thanë familjes së A. se ata do t’i bënin atij disa pyetje dhe do ta lironin atë më vonë. Meqë A. nuk u kthye kurrë, M. B. më vonë shkoi në Drenovc për ta kërkuar atë. Atje ai u takua me Bedri Zyberajn, për të cilin dëgjoi se ishte “komisari” i policisë i ngarkuar në shtabin e UÇK-së. Bedri Zyberaj i tha atij që të shkonte në policinë e ndodhur në ndërtesën e shkollës dhe të kërkonte “Çelikun”.

DËSHMITARËT E NDJEKJS TË DËGJUAR GJATË GJYKIMIT

Dëshmitarja M. Sh.; Dëshmitari R. Sh. (ish dëshmitari “C”)², Dëshmitarja S. Sh. (ish dëshmitarja “H”)³; Dëshmitari Z. T. (ish dëshmitari “F”)⁴; Dëshmitari i Mbrojtur “X” (kurrë nuk është marrë në pyetje nga Agron Krasniqi)⁵; Drejtuesi i Zyrës së Personave të Zhdukur dhe Kriminalistikës, Jose-Pablo Baraybar, dëshmitar ekspert⁶; Dëshmitari Anonim “U”⁷; Dëshmitari E. R. (ish dëshmitari “S”)⁸; Dëshmitari N. R. (ish dëshmitari “P”)⁹ dhe Dëshmitari H. R. (ish dëshmitari “I”)¹⁰; dëshmitari (M.) B. (ish dëshmitari “K”)¹¹; oficeri i policisë H. M. Y. ËCIS¹²; dëshmitari H. M. (nuk u mor kurrë në pyetje nga Agron Krasniqi)¹³; Dëshmitari anonim “E”¹⁴; Dëshmitari F. H. (nuk u mor kurrë në pyetje nga Agron Krasniqi)¹⁵; Dëshmitari i Mbrojtur “Z”¹⁶; Dëshmitari Anonim “TT”¹⁷; Dëshmitari Anonim “D”¹⁸ dhe

¹ 9 Nëntor 2005 dhe 11 Maj 2006.

² 10 Nëntor 2005 dhe 11 Maj 2006.

³ 16 Nëntor 2005 dhe 11 Maj 2006.

⁴ 23 Nëntor 2005 dhe 23 Maj 2006.

⁵ 30 Nëntor 2005.

⁶ 1 Dhjetor 2005; dhe 9 dhe 15 Shkurt 2006.

⁷ 14 Dhjetor 2005 dhe 10 Maj 2006.

⁸ 14 dhe 15 Dhjetor 2005 dhe 24 Maj 2006.

⁹ 15 Dhjetor 2005 dhe 25 Maj 2006.

¹⁰ 15 Dhjetor 2005 dhe 24 Maj 2006.

¹¹ 8 Shkurt 2006 dhe 10 Maj 2006.

¹² 16 Shkurt 2006.

¹³ 22 Shkurt 2006.

¹⁴ 15 dhe 22 Mars 2006, dhe 10 Maj 2006.

¹⁵ 16 Mars 2006.

¹⁶ 17 Maj 2006.

¹⁷ 17 Maj 2006.

¹⁸ 18 Maj 2006.

Dëshmitari Anonim "E"¹⁹; Dëshmitari Anonim "B"²⁰; Dëshmitari Anonim "N"²¹; Dëshmitari Anonim "A"²²

TË PANDEHURIT TË DËGJUAR GJATË GJYKIMIT

I pandehuri Selim Krasniqi²³; I pandehuri Xhavit Elshani²⁴; I pandehuri Gashi²⁵; I pandehuri Isuf Gashi²⁶ dhe i pandehuri Agron Krasniqi²⁷.

DËSHMITARËT E MBROJTJES TË DËGJUAR GJATË GJYKIMIT

Dëshmitari K■■■■ P■■■■²⁸; Dr. A■■■■ H■■■■²⁹; Dëshmitari F■■■■ B■■■■³⁰; Dëshmitari R■■■■ L■■■■³¹; Dëshmitari N■■■■ M■■■■³²; Dëshmitari R■■■■ R■■■■³³; Dëshmitari H■■■■ Z■■■■³⁴; Dëshmitari F■■■■ B■■■■³⁵; Dëshmitari I■■■■ G■■■■³⁶; Dëshmitari M■■■■ J■■■■³⁷; Dëshmitari I■■■■ D■■■■³⁸; Dëshmitari S■■■■ K■■■■³⁹.

DEKLARATAT E LEXUARA PËR PROCESVERBALIN

Në përputhje me Nenin 156 paragrafin 2, Gjykata vendosi, pas pëlqimit të palëve, që deklaratat e dëshmitarëve të mëposhtëm të dhëna në fazat e mëparshme të përfillen si të lexuara në procesverbal: deklaratat e hetimeve të A■■■■ P■■■■, të datës 28 Shtator 2004; N■■■■ H■■■■, data 6 Dhjetor 2004; dhe H■■■■ K■■■■, data 5 Nëntor 2004 (*asnjëri prej tyre nuk është marrë në pyetje nga Agron Krasniqi*).

Deklaratat e mëposhtme hetimore janë pranuar si prova materiale në lidhje me të gjashtë (6) të akuzuarit që janë Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhavit Elshani, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe

¹⁹ 18 Maj 2006.

²⁰ 23 Maj 2006.

²¹ 24 Maj 2006.

²² 25 dhe 31 Maj 2006.

²³ 21, 22 dhe 28 Qershor 2006.

²⁴ 28 Qershor 2006.

²⁵ 29 Qershor 2006.

²⁶ 29 Qershor 2006.

²⁷ 19 Qershor 2006.

²⁸ 2 Qershor 2006.

²⁹ 7 Qershor 2006.

³⁰ 7 Qershor 2006.

³¹ 7 Qershor 2006.

³² 8 Qershor 2006.

³³ 8 Qershor 2006.

³⁴ 8 Qershor 2006.

³⁵ 8 Qershor 2006.

³⁶ 8 Qershor 2006.

³⁷ 14 Qershor 2006.

³⁸ 14 Qershor 2006.

³⁹ 14 Qershor 2006.

Agron Krasniqi: Dëshmitares M [redacted] Sh [redacted], e datës 7 Korrik 2004, dëshmitarit R [redacted] Sh [redacted] (ish dëshmitari "C"), e datës 10 Mars 2004, Dëshmitares S [redacted] Sh [redacted] (ish dëshmitarja "H"), e datës 10 Mars 2004, Dëshmitarit Z [redacted] T [redacted] (ish dëshmitari "F"), e datës 11 Mars 2004, Dëshmitarit Anonim "U", e datës 6 Gusht 2004, Dëshmitarit E [redacted] R [redacted] (ish dëshmitari "S"), e datës 14 Qershor 2004, Dëshmitarit N [redacted] R [redacted] (ish dëshmitari "P"), e datës 4 Qershor 2004, dëshmitarit H [redacted] R [redacted] (ish dëshmitari "I"), e datës 7 dhe 14 Qershor 2004, Dëshmitari M [redacted] B [redacted] (ish dëshmitari "K"), e datës 11 Mars 2004, Dëshmitari Anonim "E", e datës 2 Gusht 2004, Dëshmitarit të Mbrojtur "Z", e datës 8 Shtator 2004, Dëshmitarit Anonim "TT", e datës 26 Prill 2004, Dëshmitarit Anonim "D", e datës 20 Shtator 2004, Dëshmitarit Anonim "W", e datës 11 Mars 2004, Dëshmitarit Anonim "B", e datës 26 Shkurt dhe 2 Mars 2004, Dëshmitarit Anonim "N", e datës 26 Prill 2004, Dëshmitarit Anonim "A", e datës 26 Shkurt dhe 2 Mars 2004, Dëshmitari K [redacted] P [redacted] e datës 28 Shtator 2004, Dëshmitari A [redacted] H [redacted], e datës 28 Shtator 2004, Dëshmitari F [redacted] B [redacted], e datës 5 Tetor 2004, Dëshmitari R [redacted] L [redacted], e datës 5 Nëntor 2004, Dëshmitari R [redacted] R [redacted], e datës 5 Nëntor 2004, Dëshmitari F [redacted] B [redacted], e datës 6 Dhjetor 2004, Dëshmitari I [redacted] G [redacted], e datës 6 Dhjetor 2004, Dëshmitari M [redacted] J [redacted], e datës 5 Nëntor 2004.

Deklarata e hetimeve e dhënë nga Dëshmitari Anonim "X" në 10 Shtator 2004 është pranuar si provë në lidhje me të akuzuarit Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhavit Elshani, Isuf Gashi dhe Islam Gashi.

Deklaratat e mëposhtme të policisë janë pranuar si provë materiale në lidhje me të gjithë të akuzuarit që janë Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhavit Elshani, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Agron Krasniqi: Dëshmitarja M [redacted] Sh [redacted] e datës 21 Korrik 2003, Dëshmitari R [redacted] Sh [redacted] (ish dëshmitari "C"), e datës 2 Qershor në orën 16:00 (nuk përmendet viti) dhe 26 Qershor 2002, Dëshmitari S [redacted] Sh [redacted] (ish dëshmitari "H"), e datës 21 Korrik 2003, Dëshmitari Z [redacted] T [redacted] (ish dëshmitari "F"), e datës 5 Korrik 2001 dhe 23 Nëntor 2001, Dëshmitari Anonim "U", e datës 16 Korrik 2004 dhe 19 Korrik 2004, Dëshmitari E [redacted] R [redacted] (ish dëshmitari "S"), e datës 16 Prill 2002, Dëshmitari N [redacted] R [redacted] (ish dëshmitari "P"), e datës 16 Prill 2002 në orën 11:40, Dëshmitari H [redacted] R [redacted] (ish dëshmitari "I"), e datës 29 Qershor 2003, Dëshmitari M [redacted] B [redacted] (ish dëshmitari "K"), e datës 1 Mars 2000 dhe 22 Dhjetor 2001, Dëshmitari Anonim "E", e datës 17 Prill 2004 përfshi edhe dy (2) fotografi të Dëshmitarit Anonim "E" të bashkëngjitura në deklaratë, Dëshmitari Anonim "TT", e datës 2 Qershor 2001 dhe 29 Nëntor 2001, Dëshmitari Anonim "E", e datës 23 Prill 2002, Dëshmitari Anonim "B", e datës 23 Nëntor 2001, 10 Janar 2001 dhe 20 Mars 2000, Dëshmitari Anonim "N", e datës 29 Nëntor 2001 dhe 3 Korrik 2000, Dëshmitari Anonim "A", e datës 20 Mars 2000, 27 Qershor 2001 dhe 23 Nëntor 2001.

Deklarata e dhënë nga dëshmitari R [redacted] B [redacted] në polici në 24 Dhjetor 2002 është pranuar si provë materiale në lidhje me të akuzuarit Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhavit Elshani, Isuf Gashi dhe Islam Gashi.

AKTAKUZA

Me aktakuzën e datës 27 Korrik 2004, Prokurori Publik Ndërkombëtar, i akuzoi të pandehurit Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhavit Elshani, Isuf Gashi, Islam Gashi, dhe Xh [redacted] G [redacted] me

një numër veprash që ishin kryer në periudhën mes Majit dhe Tetorit 1998. Akuzat specifike janë paraqitur në katër pika dhe thuhet se lidhen me aktivitetet e të pandehurve në lidhje me të paraburgosurit në një qendër paraburgimi në fshatin Drenovc në Zatriq, Komuna e Rahovecit. Pretendimet në lidhje me arrestimet e paligjshme, ndalimit të paligjshëm, rrahjes dhe torturës dhe vdekjes të shqiptarëve të Kosovës, viktima në këtë rast. Në vendimin e tij të datës 21 Maj 2005, gjyqtari e konfirmoi aktakuzën, por i ashpërsoi procedimet kundër Xh [REDACTED] G [REDACTED] që nuk ishte i pranishëm në seancë.

I pandehuri Agron Krasniqi ishte në Suedi në kohën e fillimit të hetimeve kundër të pandehurve të tjerë. Ai është ekstraduar nga Suedia në 9 Dhjetor 2005 dhe është arrestuar në datën 15 Prill 2004. Hetimi kishte filluar në 20 Shkurt 2004 me anë të vendimit të Gjyqtarit Hetues në vijim të propozimit të datës 17 Shkurt 2004 të Prokurorit Publik kundër të gjithë të pandehurve përfshi edhe Agron Krasniqin, është zgatur në rastin e Agron Krasniqit me anë të një vendimi të datës 11 Dhjetor 2005 dhe ky i pandehur është paraburgosur. Një aktakuzë e datës 28 Shkurt 2006 u ngrit kundër tij e cila përmbante katër pika dhe ato gjithashtu kishin lidhje me qendrën e paraburgimit që u përmend më lart. Pretendimet që kanë lidhje me arrestimet dhe/ose ndalimet e paligjshme, trajtimin çnjerëzor, rrahjen dhe torturën dhe gjithashtu edhe vrasjen e viktimave shqiptarë të Kosovës. Gjyqtari i Konfirmimit e konfirmoi aktakuzën në lidhje me të gjitha akuzat e arrestimit dhe/ose ndalimit të paligjshëm, trajtimin çnjerëzor, rrahjen dhe torturën por ka hedhur poshtë akuzën e arrestimit të paligjshëm në rastin e pesë viktimave. Ai gjithashtu hodhi poshtë akuzën e vrasjeve. Një ankesë nga prokuroria kundër vendimit të gjyqtarit konfirmues është hedhur poshtë nga një koleg prej tre gjyqtarësh. Çështja kundër Agron Krasniqit është bashkuar me gjykimin që po mbahej për të pandehurit e tjerë.

Në seancën e 27 Korrikut 2006 prokurori hodhi poshtë të gjitha akuzat kundër të pandehurve Isuf Gashi dhe Xhavit Elshani. U ngrit një aktakuzë përfundimtare e të njëjtës datë, 27 Korrikut 2006 dhe kjo aktakuzë përfundimtare akuzonte Selim Krasniqin, Bedri Zyberajn, Islam Gashin dhe Agron Krasniqin në katër pika me Krime Luftë të trajtimit çnjerëzor.

Të pandehurit supozohen se janë anëtarë të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) një fakt i pranuar nga të gjithë ata përveç Bedri Zyberajt.

Në vija të trasha, aktakuza pretendon se të katër të pandehurit morën pjesë gjatë periudhës 2 Qershor 1998 dhe 31 Gusht 1998, (përveç se në rastin e të pandehurit Selim Krasniqi data e fillimit është 1 Maji 1998), në një ndërmarrje të përbashkët penale ku civilët shqiptarë të dyshuar për bashkëpunim me serbët janë arrestuar në mënyrë ta paligjshme dhe po në këtë mënyrë janë ndaluar në qendrën e paraburgimit në Drenovc. Supozohet se të pandehurit morën pjesë në arrestimet dhe ndalimet e paligjshme të Sh [REDACTED] Sh [REDACTED], B [REDACTED] B [REDACTED], H [REDACTED] P [REDACTED], M [REDACTED] R [REDACTED], H [REDACTED] T [REDACTED], A [REDACTED] B [REDACTED], H [REDACTED] K [REDACTED] si dhe dëshmitarëve "A", "E", "U", "Ë" dhe "X", dhe se këto të ndaluar civilë i kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe i kanë shkaktuar vuajtje të mëdha apo dhunime të shëndetit trupor duke aplikuar masa të kanosjes dhe terrorit. Të pandehurit promovuan një regjim paraburgimi që ishte arbitrar dhe shtypës ku kujdesi normal dhe proceset e një gjykimi të nevojshëm mungonin plotësisht.

Aktakuza më tej pretendon se gjatë periudhës kur thuhet se kanë ndodhur ngjarjet, të gjitha

kushtet e nevojshme ekzistonin për secilën veprë të provuar që të kualifikohej si një veprë Krim lufte, sepse gjithmonë janë thelbësore për aktakuzën:

- Një gjendje e konfliktit të brendshëm të armatosur ekzistonte në mes Ushtrisë çlirimtare të Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe Republikës së Jugosllavisë, përfshi këtu Ushtrinë Jugosllave, forcat e Ministrisë së Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë, forcave të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë dhe ushtarëve paramilitarë serb në territorin e Kosovës.
- Të dy forcat kundërshtarë kishin një komandë përgjegjëse që ushtronte kontroll në pjesë të territorit të Kosovës dhe i mundësonte atyre që të kryenin dhe drejtonin operacionet ushtarake;
- Të gjithë viktimat ishin padyshim anëtarë të mbrojtur të popullsisë civile;
- Veprimet e të akuzuarve u bënë gjatë periudhës kur ekzistonte një konflikt i brendshëm i armatosur brenda në Kosovë;
- Ekzistonte një lidhje mes veprimeve të kryera nga të akuzuarit dhe konfliktit të brendshëm të armatosur. Prania e konfliktit të armatosur luajti një rol thelbësor në mundësitë e të akuzuarve për të kryer veprat dhe veprimet e të akuzuarve kishin lidhje të drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur;
- Të akuzuarit, si kryes të Krimeve të Luftës, vepruan në emër të dhe ishin lidhur ngushte me forcat e armatosura të UÇK-së që i bënte ata pjesë të konfliktit. UÇK-së e deklaroi veten si një ushtri e ligjshme në 15 apo 16 Maj 1998.
- Secili nga aktet në fjalë shoqërohej nga një qëllim i nevojshëm në mendjen e kryesve.
- Veprimi që pretendohen kundër të pandehurve thuhet se është në kundërshtim me Nenin 142 të KP SFRJ-së, në lidhje me Nenet 22, 24, 26, dhe 30 të KP të RSFJ-së, që janë kryerje, ndihma dhe kryerja me moskryerje, veprimi në bashkëpunim me të tjerët dhe pjesëmarrja në një plan të përbashkët penal dhe për qëllim të kryerjes së Krimeve të Luftës, që të pandehurit ishin personalisht dhe penalisht përgjegjës për arrestimin e paligjshëm, ndalimin e paligjshëm, rrahjen dhe torturimin e viktimave shqiptarë të Kosovës në këtë rast.
- Më tej, vepra e pretenduar u tha se përbënte Krime Lufte pasi secili nga veprimet kyçe përbënin një shkelje të ligjit ndërkombëtar në fuqi, përfshi këtu edhe Nenin e Përbashkët 3 dhe Katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, si i aplikueshëm në konfliktin e brendshëm të armatosur; Konventat e Hagës të vitit 1899 dhe 1907, katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe Protokolli Shtesë II i 1977 ndaj Konventave të Gjenevës të 1949, si të aplikueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur.

ÇËSHTJET LIGJORE

Dëshmitarët që nuk u pyetën nga i pandehuri Agron Krasniqi

Deklaratat e bëra qoftë në polici apo para Gjyqtarit Hetues janë paraqitur në Gjykim. Trupi Gjykues i ka përfillur këto deklarata vetëm deri në shkallën që dhënësit e deklaratës, dëshmitarët që dëshmuuan në gjykim janë marrë në pyetje nga i pandehuri Agron Krasniqi dhe avokati i tij mbrojtës.

Vlerësimi i besueshmërisë së dëshmitarëve

Në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve, Trupi Gjykues nuk i konsideroi provat si një strukturë një-bloqëshe që ose duhet pranuar ose duhet hedhur poshtë *në bllok*. Trupi Gjykues i shqyrtoi provat, vlerësoi peshën e saj dhe u përpoq që të dallonte se çfarë mund të pranohej me siguri dhe çfarë mund të mbetej në mëdyshje.

Trupi Gjykues ishte plotësisht i vetëdijshëm për rrethanat në të cilat dëshmitarët ishin vendosur dhe kompleksitetin dhe natyrën e veçantë të ngjarjeve që ndodhën rreth tyre. Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ruandën ka bërë vërejtjet e mëposhtme për ndikimin e traumave në dëshminë e dëshmitarëve në një prej rasteve të saj kryesore.⁴⁰

“Shumë prej dëshmitarëve okular që dëshmuuan para Trupit Gjykues në këtë rast kishin parë vrasje të kryera kundër familjarëve të tyre apo shokëve të ngushtë, dhe/ose kishin qenë vetë viktimat të këtyre mizorive. Trauma e mundshme e këtyre dëshmitarëve të shkaktuara nga përvoja e dhimbshme e dhunës gjatë konfliktit në Ruandë është një çështje e rëndësishme së veçantë për këtë Gjykatë. Dëshmia për këto përvoja traumatizuese ka shumë mundësi që të zgjojë kujtimet e frikës dhe dhimbjes të shkaktuara më parë ndaj dëshmitarit dhe kështu kjo ndikon në aftësinë e tij apo saj që të përsërisë plotësisht apo në mënyrën e duhur rrjedhën e ngjarjeve në një kontekst juridik. Gjykata i përfilli dëshmitë e këtyre dëshmitarëve nga ky këndvështrim.”⁴¹

“Gjykata nuk është në gjendje që të përjashtojë mundësinë që dikush apo të gjithë këta dëshmitarë në të vërtetë vuanin nga çrregullimet post traumatike apo stresit të skajshëm dhe kështu që ka shqyrtuar me kujdes dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, dëshmitarëve të Ndjekjes dhe të Mbrojtjes gjithashtu, me mundësinë se kjo gjë mund të ishte e vërtetë. Mospërputhjet dhe pasaktësia e dëshmimeve, u vlerësuan nën këndvështrimin e këtij supozimi, historitë personale dhe mizoritë që kishin përjetuar apo që kishin vuajtur.”⁴²

Nga vetë natyra e përvojave të shumë prej dëshmitarëve që dhanë dëshmi në këtë rast ishin traumatike për ata dhe është e natyrshme që të mos presësh nga ata të kujtojnë specifikat e ngjarjeve të veçanta, të tilla si rrjedha e saktë apo datat e sakta dhe kohën e ngjarjeve, që ata kanë përshkruar. Duhet të kujtohet se ngjarjet kanë ndodhur në 1998 dhe shumë prej dëshmitarëve iu desh që të kujtonin ndërkohë që ishin në kërkim për njerëzit e tyre të dashur që ishin zhdukur. Disa prej dëshmitarëve ishin viktimat të rrëmbimeve dhe ndalimeve gjatë së cilës ata ishin keqtrajtuar.

⁴⁰ *Prokurori v Akayesu*, Gjykimi, 2 Shtator 1998, çështja nr. ICTR-96-4-T.

⁴¹ *Ibid*, paragraf 142.

⁴² *Ibid*, paragraf 143.

Sipas Nenit 364 të KPPPK-së [ish Neni 328 i Ligjit të Procedimeve Penale], Gjykata ka për detyrë që të tërheqë vëmendjen për një dëshmitar që del apo kundërshton dëshminë e tij/saj të parë. Kjo qasje është shpjeguar për qëllim të Nenit 347 të LPP-së⁴³ tashmë të zëvendësuar, si më poshtë: “Fakti që Gjykata mund të bazojë gjykimin e saj vetëm në prova dhe fakte të paraqitura në shqyrtimin kryesor, kjo nuk do thotë se nuk mund të vlerësohet dhe madje edhe të merren në konsideratë dëshmitë e dhëna në procedimet paraprake. Nëse dëshmitari në shqyrtimin kryesor e ndryshon plotësisht dëshminë nga ajo e dhënë në hetime dhe nuk jep arsye bindëse për këtë ndryshim të dëshmisë, gjykata mund të marrë parasysh dëshminë e dhënë në hetime (Gjykata Supreme e Kroacisë Kz. 962/72 e datës 26 Dhjetor 1972). Kjo është kështu sepse dëshmia e hetimeve duhet t’i tregohet dëshmitarit dhe ajo duhet t’i lexohet atij (Neni 328 LPP-së, tani Neni 364 i KPPPK-së⁴⁴), pra trupi gjykues është në dijeni të asaj dëshmie gjithashtu”⁴⁵. Meqë Neni 347 i referohet Nenit 328 dhe ky Nen është paraqitur përsëri si Neni 364 i KPPPK-së, Trupi Gjykues mori parasysh komentaret e Nenit 347 të LPP-së si udhëzues të vlefshëm të vlerësimit të provave.

E njëjta vërejtje paraqitet në rastin Akayesu⁴⁶. “Shumica e dëshmitarëve që u paraqitën në Gjykatë ishin dëshmitarë okularë, dëshmitë e të cilëve bazoheshin në ngjarjet që ata kishin parë apo dëgjuar në lidhje me veprat që supozoheshin në Aktakuzë. Gjykata vëren se gjatë gjykimit, një numër i këtyre dëshmitarëve, aty kishte kundërthënie apo pasaktësi mes përmbajtjes së dëshmive të tyre të dhëna nën deklaratën solemne të Gjykatës dhe deklaratave të tyre të mëparshme të dhëna tek Prokurori dhe Mbrojtja. Kjo e vetme nuk është një bazë për të besuar se dëshmitarët dhanë dëshmi të rreme. Në fakt, një kritikë e shpeshtë për këto dëshmi është pasaktësia e tyre. Meqë dëshmia është e bazuar kryesisht në kujtesë dhe pamje, dy karakteristika njerëzore që shpesh e mashtrojnë individin, kjo kritikë pritet. Kështu që, dëshmia është rrallë e saktë për ngjarjet e përjetuara. Për të gjykuar nga cilado kontradiktë apo pasaktësi rezultuese që ato ishin dëshmi të rreme, do të ishte si të penalizonim dobësitë në perceptimin njerëzor. Për më tepër, pasaktësitë dhe kundërthëniet mes deklaratave në fjalë dhe dëshmive të dhëna para Gjykatës janë gjithashtu si rezultat i kalimit të kohës mes tyre. Kujtesa me kalimin e kohës në mënyrë të natyrshme degjeneron; kështu, që do të ishte e gabuar dhe e padrejtë për Gjykatën që të trajtonte harresën si sinonim i dhënies së dëshmisë së rreme. Për më tepër, dëshmia e rreme kërkon *mens rea* e nevojshme dhe jo thjesht të jetë një deklaratë e

⁴³ Neni 347, paragrafi 2 thotë “Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”. Neni zëvendësues për këtë Nen është Neni 387 paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës që ka zëvendësuar Ligjin e Procedurës Penale.

⁴⁴ Neni 328 i Ligjit të Procedurës Penale, thotë: “Nëse në deklaratat e mëparshme, një dëshmitar apo dëshmitar ekspert ka paraqitur fakte të cilat nuk i kujtohen më apo prej të cilave distancohet, ai duhet të informohet për dëshminë e tij të mëparshme ku ndodhen mospërputhjet dhe ai duhet të pyetet se pse tani po dëshmon ndryshe dhe nëse është e nevojshme, dëshmia e mëparshme apo një pjesë e kësaj dëshmie të lexohet”, dhe Neni 364 i KPPPK-së thotë: “Kur dëshmitarit ose ekspertit nuk i kujtohen faktet të cilat i ka prezantuar më parë gjatë marrjes në pyetje, ose kur i shmanget deklarimit të përparshëm, kryetari i trupit gjykues ose palët mund t’ia tërheqin vërejtjen lidhur me deklarimin e mëparshëm dhe kërkojnë shpjegim përse tani dëshmon ndryshe. Sipas nevojës, kryetari i trupit gjykues lexon deklarimin e tij të mëparshëm ose pjesë të atij deklarimi.”

⁴⁵ Komentaret e Procedurës Penale KP të RFSJ-së botimi 3-të 1988, nga Branko Petric.

⁴⁶ *Prokurori v Akayesu*, Gjykimi, 2 Shtator 1998, Rasti nr.. ICTR-96-4-T.

gabuar”⁴⁷.

Një dëshmitar që largohet nga një deklaratë e mëparshme, i jepet mundësia që të shpjegojë arsyet se për një largim apo kundërthënie të tillë në fund të fundit i përket gjykatës që të vlerësojë provën dhe të vendosë nëse ta marrë parasysh atë apo jo.

Trupi Gjykses ishte plotësisht i vetëdijshëm për faktin se priteshin mospërputhje mes provave të dëshmitarëve të ndryshëm apo mes dëshmimeve të një dëshmitari të veçantë dhe një deklaratë të dhënë më herët nga ai dëshmitar. Trupi Gjykses vuri re se një dëshmitar mund të largohet nga një dëshmi e mëparshme për arsye të ndryshme legjitime dhe jo për shkak se ka tendencë për të gënjer. Kjo në vetvete nuk është një bazë për të refuzuar dëshminë e një dëshmitari.

Ngjarjet në këtë rast ndodhën në 1998 dhe do të ishte mohim i drejtësisë që të mos merrej parasysh faktori kyç kur vlerësohen dëshmitë e dëshmitarëve, Trupi Gjykses nuk i trajtoi mospërputhjet e vogla për të zhvlerësuar provat e dhëna nga një apo më shumë dëshmitarë kur dëshmitarët megjithatë kishin thënë thelbin e incidenteve me hollësi të pranueshme. Trupi Gjykses mori parasysh thelbin e këtyre ngjarjeve që kishin ndodhur rreth tetë apo më shumë vjet para se dëshmitarët të jepnin dëshminë për më shumë se një herë. Në këto rrethana, trupi gjykses ishte më i kujdesshëm kur vlerësoi dëshminë e një dëshmitari që ishte në gjendje që të jepte një rrjedhë të saktë të ngjarjeve.

Trupi Gjykses analizoi çdo mospërputhje nga këndvështrimi i shpjegimeve të dhëna dhe rrethanave në të cilat çdo deklaratë është dhënë gjatë procedimeve hetimore në gjykimin e parë. Shumë dëshmitarë dhanë deklarata në polici dhe tek Gjyqtari Hetues. Në të vërtetë në disa raste dëshmitarët janë pyetur se pse nuk i kishin përmendur. Trupi Gjykses i mori parasysh mospërputhjet mes dëshmimeve të dëshmitarëve dhe deklaratave të mëparshme, dhe gjithashtu edhe mospërputhjet me faktet e vërtetuara dhe i janë referuar besueshmërisë të secilit dëshmitar.

Gjykata gjithashtu mori parasysh stresin e madh dhe frikës ndaj së cilës dëshmitarët ishin ekspozuar. Duhet të mbahet mend se shumë prej dëshmitarëve kërkuan masa mbrojtëse dhe dëshmuan nën kushte të anonimitetit. Trupi Gjykses i dha shumë rëndësi kësaj në vlerësimin e dëshmisë, nga këndvështrimi i vërejtjeve të duhura të Gjykatës së Hagës në rastin e Fatmir Limajt⁴⁸ “Gjykata më tej vëren se një numër i madh i dëshmitarëve kërkuan masa mbrojtëse në gjykim dhe shprehën shqetësim për jetët e tyre dhe të familjeve të tyre. Konteksti i frikës në veçanti në lidhje me dëshmitarët që jetojnë ende në Kosovë, ishte shumë i dukshëm gjatë gjithë gjykimit”⁴⁹.

Në disa raste, dëshmitarët deklaruan se ata i qëndronin dëshmimeve të tyre të mëparshme dhe ata dhanë një përmbledhje të dëshmimeve të tyre të mëparshme gjatë seancës. Kjo ishte plotësisht e kuptueshme pasi dëshmitarët jepnin dëshmi për të tretën herë para institucioneve gjyqësore pasi kishin dhënë deklarata në polici dhe organizata të tjera. Trupi Gjykses mendon se mund

⁴⁷ Ibid, paragraf 140.

⁴⁸ ICTY, Salla e Gjykimit, Gjykimi, 30 nëntor 2005, Rasti Nr. IT-03-66-T.

⁴⁹ Ibid, paragrafi 15.

të vepronte pa dyshim bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve. Gjykata gjeti një numër mospërputhjes në dëshmitë e dhëna në gjykim të krahasuara me dëshmitë e mëparshme të dëshmitarëve. Gjykata nuk konsideroi se këto mospërputhje ishin të tilla që të sabotonin thelbin e dëshmisë e dëshmitarëve mbi ngjarjet që ata kishin parë apo të pandehurit dhe personat e tjerë që ata kishin identifikuar.

Përdorimi i dëshmisë së një Dëshmitari Anonim në një çështje vendimtare

Shumica e dëshmive u dha nga Dëshmitarët Anonim. Sipas Ligjit në fuqi të Kosovës duhet të bëhet kujdes në përdorimin e dëshmive të tilla⁵⁰. Me një interpretim të mjeteve ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe rregullave të ligjit ndërkombëtar, një dëshmitar nuk gëzon të drejta specifike si në rastin e një të akuzuari. Megjithatë ka pasur ndryshim në këtë situatë në nivelin ndërkombëtar. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut thotë se është e vërtetë që Neni 6 nuk i kërkon interesat e dëshmitarit në përgjithësi dhe ato të viktimave të ftuar që të dëshmojnë në veçanti, që të merren parasysh. Megjithatë, jeta e tyre, liria apo siguria e personit mund të jetë në rrezik, pasi shumë interesa që vijnë në përgjithësi nga brenda cakut të Konventës. Interesa të tilla të dëshmitarëve dhe viktimave në parim mbrohen nga dispozita të tjera materiale të Konventës, që përfshin që Shtetet Kontraktuese duhet të organizojnë procedimet e tyre penale në atë mënyrë që këto interesa të mos vihen në rrezik në mënyrë të paarsyeshme⁵¹.

Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Autoritetit parasheh se “viktimat të trajtohen me dhembshuri dhe respekt për dinjitetin e tyre”⁵². Nga këndvështrimi i Trupit Gjykoës, ky parim duhet të aplikohet jo vetëm ndaj viktimave që janë dëshmitarë por gjithashtu edhe ndaj atyre që mund të jenë në një formë të rrezikuar seriozisht.

Mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve është gjithashtu një parim që aplikohet në nivelin e gjykatave ndërkombëtare. Të dy statutet relevante të Gjykatave *ad hoc* për ish Jugosllavinë [ICTY] dhe për Ruandën [ICTR] përmbajnë rregulla për një mbrojtje të tillë dhe për dëgjimet e mbyllura⁵³. Në rastin Tadić ICTY i ka përmbushur kërkesat e një gjykimi e drejtë që i akuzuari gëzon, duhet të jenë në përputhje me masat e duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve të cënueshëm⁵⁴.

Statuti i Romës që është themeloi Gjykatën Ndërkombëtare Penale gjithashtu përmban dispozita për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve⁵⁵.

Çdo vendim për të mbajtur seanca në mbyllura dhe për t'i dhënë anonimitet një dëshmitar duhet të barazpeshohet me të drejtën e një të akuzuari që duhet të ketë një gjykim të drejtë. Në

⁵⁰ “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”. (Neni 157, paragrafi 1, KPPPK-së).

⁵¹ *Doorson v Hollandës*, 1996 22 EHRR 330.

⁵² Parimi 4 i Parimeve Themelore.

⁵³ Shikoni Nenet 20, 21 dhe 22 të Statutit të ICTY dhe Nenin 21 Statutin e ICTR.

⁵⁴ Tadić, Vendimi mbi kërkesën e Prokurorit që kërkon Masa Mbrojtëse për viktimat dhe Dëshmitarët Gjykata ICTY, 10 Gusht 1995, Rasti Nr. IT-94-1.

⁵⁵ Neni 68 i Statutit të Romës.

fakt parimet e gjykimit të drejtë gjithashtu kërkojnë që në rastet e duhura, interesi i mbrojtjes barazohet me ato të dëshmitarëve apo viktimave që janë ftuar për të dëshmuar⁵⁶. Kjo është e tillë sipas ligjit vendor, Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe mjeteve të tjera ndërkombëtare të të Drejtave të njeriut dhe në veçanti të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike [ICCPR]. Në lidhje me ICCPR është vërejtur se e drejta për të ftuar, përmban praninë e dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve nën të njëjtat kushte si prokurori, si një element thelbësor i “barazisë së armëve” dhe kështu të një gjykimi të drejtë⁵⁷. Gjykata Europiane vëren se nëse ruhet anonimiteti i dëshmitarëve, mbrojtja do të përballet me vështirësi ku normalisht procedimet penale nuk do të duheshin të përfshiheshin. Kështu që, Gjykata ka njohur se në këto raste Neni 6, paragrafi 1, i marrë së bashku me Nenin 6 Paragrafin 3.d, të Konventës parasheh që pengesat nën të cilat punon mbrojtja të jenë mjaftueshmërisht të barabarta me procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore⁵⁸.

Situata e pafavorshme të cilës iu referuam më lart mund të shmanget nëse i jepet një mundësi viktimave apo dëshmitarëve që të merren në pyetje në kushtet që nuk i vënë ata në rrezik, ndërkohë që respektohet parimi i barazisë së armëve, ku marrja në pyetje e dëshmitarëve është një përbërës. Ajo që ligji i Gjykatës Supreme nuk e miraton është një përjashtim i plotë i një mundësie që mbrojtja të marrë në pyetje dëshmitarët dhe gjetjen e fajësisë bazuar vetëm në dëshmi të tilla të paprovuar⁵⁹. Kjo parashihet gjithashtu në KPPPK⁶⁰. Është e rëndësishme që mbrojtja të mund të sfidojë cilëndo dëshmi të marrë nga ndjekja⁶¹ dhe se ekzistojnë disa dëshmi të tjera për të mbështetur dëshminë e dëshmitarit anonim.

KPPPK-ja nuk flet aspak për natyrën e provave mbështetëse që duhen për të vërtetuar dëshminë e një dëshmitari anonim. Po nëse dëshmia do të jetë plotësisht një dëshmi e pavarur në kuptimin që një dëshmitar anonim nuk mund të mbështet nga një dëshmitar tjetër anonim? Kjo pyetje supozon rëndësinë e saj nga këndvështrimi i parashtrimit të ndjekjes që shprehu mendimin se Neni Paragrafi 3 i KPPPK-së në mënyrë të drejtpërdrejtë sugjeron që, kur ka dy apo më shumë dëshmitarë anonim, atëherë dëshmitë e tyre mund të përdoren për qëllim të një dënimi. Ai shtoi se kjo është edhe në rastin tonë pasi shumica e provave është vërtetuar nga apo më shumë dëshmitarë anonim.

Trupi gjykues ishte i mendimit se qëllimi i Nenit 157 paragrafi 3 është për të ndaluar cilëndo provë të dhënë nga një apo më shumë dëshmitarë anonim që janë të një mënyrë vendimtare për t’u shpallur fajtor. Nëse janë një apo më shumë dëshmitarë anonim, fakti mbetet që identiteti i secilit dhe secili nga këta dëshmitarë do të mbeten të panjohur për avokatët mbrojtës dhe të pandehurin. Kjo është e keqja që duhet të shmanget nga legjislatori në Nenin 157 Paragrafi 3 i KPPPK-së.

⁵⁶ *Doorson v Hollandës*, 1996 22 EHRR.

⁵⁷ Nowak, Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, Komentari i DCPK, 1993.

⁵⁸ *Doorson v Hollandës* 1996 22 EHRR.

⁵⁹ *Shiko Kostovski v Hollandës* 1989, 12 EHRR 434 dhe *Uppertinger v Austrisë* 1986, 13 EHRR 175.

⁶⁰ “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”. (Neni 157, paragrafi 3, KPPPK-së).

⁶¹ *Shiko Birutis v Lituanië*, Gjykimi i Gjykatës Europiane, 28 Mars 2002.

Trupi Gjykues gjeti se rrjedha e ngjarjeve siç u përshkrua nga dëshmitarët anonim, nuk qëndronte e vetme por ishte e mbështetur në një shkallë të lartë nga dëshmitë e dëshmitarëve anonim dhe nga ato që disa të pandehur deklaruan.

Si dëshmia e Prokurorit dhe e Dëshmitarëve të Mbrojtjes, ashtu edhe dëshmia e të Pandehurve, vërteton qartë se gjatë shtatë muajve të parë të 1998 ekzistonte një konflikt i zgjatur dhe i dendur në territorin e Kosovës, që u shtri dhe ndikoi në vendin e Drenovcit dhe fshatrat e tij përreth.

Në lidhje me Qendrën e Paraburgimit, H [REDACTED] Rr [REDACTED] deklaroi në lidhje me fotografitë 13, 15, 18 dhe 19, Prova Materiale D, se qendra e paraburgimit ndodhej aty. Shkolla e vjetër kishte dy bodrume apo qeli poshtë dhe ishte një burg apo një Qendër Paraburgimi. Dëshmitari shtoi se aty ishte hyrja me disa shkallë. Duke parë fotografinë 13, Prova Materiale D, dëshmitari tregoi hyrjen kryesore në qendrën e paraburgimit.

Dëshmitari E [REDACTED] Rr [REDACTED] deklaroi se aty ishin dy shkolla të ngjitura me njëra tjetrën, njëra e re dhe tjetra e vjetër. Bodrumi i shkollës së vjetër përdorej për të shërbyer si një burg dhe këto shkolla ndodheshin në Drenovc. Dëshmitarit i është thënë se bodrumi i shkollës së vjetër shfrytëzohej si një ambient ndalimi.

Muhammet Berishës ia ka thënë Bedri Zyberaj, të cilin ai e pa në Drenovc se ai po merrej me çështjen e rrëmbimit të A [REDACTED] B [REDACTED] dhe se ai duhej të shkonte tek shkolla/burgu dhe të kërkonte Selim Krasniqin (Çelikon).

Dëshmitari N [REDACTED] Rr [REDACTED] tha se kur shkoi për të kërkuar M [REDACTED] Rr [REDACTED], ai po fliste me Z [REDACTED] B [REDACTED] dhe ai dinte se të paraburgosurit po mbaheshin në qendrën e paraburgimit tek shkolla në Drenovc. Ai e dëgjoi këtë nga shumë njerëz sepse të gjithë e dinin se qendra e paraburgimit ishte aty dhe se të paraburgosurit po mbaheshin tek shkolla.

Dëshmitari përshkroi dhe tregoi fotografinë 6, Prova Materiale D. Ai më pas shpjegoi se ai e dinte këtë sepse ai shkoi në atë vend për t'i çuar rrobe Muratit. Atje ai takoi Z [REDACTED] B [REDACTED] për t'i dhënë rrobat atij, hipi tek shkallët dhe dëgjoi që të burgosurit ndodheshin atje. Ai e dëgjoi përmes dritares. Ai u kthye por aty kishte roje që qëndronin tek dera, kjo e bëri atë të kuptonte se të burgosurit ndodheshin aty.

I Pandehuri Selim Krasniqi vetë e pranoi praninë e një Qendre të Paraburgimit në Drenovc.

Dëshmitari E [REDACTED] Rr [REDACTED] e pa të pandehurin Agron Krasniqi dhe një Z [REDACTED] B [REDACTED] që rrëmbyen M [REDACTED] Rr [REDACTED]. Dëshmitari dhe daja/axha i tij N [REDACTED] shkuan për ta kërkuar atë. Atje ata pyetën Z [REDACTED] B [REDACTED] për Muratin dhe ai u përgjigj, "Ai është mirë dhe hetimet janë në proces". I pandehuri Bedri Zyberaj deklaroi se është fakt që dëshmitarët H [REDACTED] dhe N [REDACTED] erdhën vetëm një herë për ta takuar atë në ato ambiente të kooperativës gjatë verës së 1998. Më pas Bedri Zyberaj i tha atyre "M [REDACTED] Rr [REDACTED] është këtu, dhe policia po merret me të dhe tani mund të largoheni. Unë nuk kam asnjë kompetencë, unë jam këtu si roje i magazinës, policia po merret me të."

Dëshmitari Z [REDACTED] T [REDACTED] shpjegoi rrethanat e rrëmbimit të H [REDACTED] T [REDACTED]

Pas rrëmbimit të A [REDACTED] B [REDACTED] dëshmitari M [REDACTED] B [REDACTED] shkoi për ta kërkuar atë dhe u takua me Bedri Zyberajn. Ai e pyeti Bedri Zyberajn “a do të ishte e mundur që të mësonte se pse ishte rrëmbyer Avdi Berisha dhe gjithashtu ku ndodhej ai?”. Në një moment, Bedri Zyberaj i tha dëshmitarit se ai nuk ishte personi që merrej me këtë çështje por e këshilloi atë që të shkonte tek shkolla/burgu dhe të kërkonte Çelikun, Selim Krasniqin. Bedri Zyberaj e dërgoi atë tek Selim Krasniqi sepse ky i fundit “ishte personi i ngarkuar për policinë ushtarake”.

Dëshmitari e pyeti Selim Krasniqin për A [REDACTED] B [REDACTED] Ai u përgjigj: “Këtu në Drenovc nuk ka asnjë njeri, ata janë diku në Drenicë. Ne nuk mund t’i sjellim ata këtu duke pasur parasysh gjendjen e keqe të rrugëve.

Dëshmitari Muhammet Berisha pasi e përshkroi të akuzuarin Selim Krasniqi e identifikoi atë në një paradë fotografish, Prova Materiale C.

Dëshmitari Muhammet Berisha, pas përshkrimit të të akuzuarit Bedri Zyberaj, e identifikoi atë nga një paradë fotografish, Prova Materiale C.

Dëshmitari N [REDACTED] Rr [REDACTED] tha se ai dhe Bedri Zyberaj janë të së njëjtës moshë dhe se ai e njohte atë që nga shkolla fillore. Ai shtoi se Bedri Zyberaj është pak qeros në pjesën e përparme. Ai e identifikoi Bedri Zyberajn nga parada e fotografive, fotografia 16, Prova Materiale C.

H [REDACTED] Rr [REDACTED] identifikoi të pandehurin Bedri Zyberaj të cilin e njohte që kur ishin fëmijë.

Dëshmitari E [REDACTED] Rr [REDACTED] identifikoi të pandehurin Agron Krasniqi nga rreshtimi i fotografive, foto 1, prova C.

Detyra dhe Standarti i të Provuarit

Ndërkohë që është aktive për qasjen që duhet të merret për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve si u diskutua më lart, gjykata, sidoqoftë duhet të vinte në balancë këta faktorë me detyrën e të provuarit për çështjet penale. Në asnjë rrethanë nuk duhet shpikur një rregull që sugjeron zbatimin e shkallëve të ndryshme të të provuarit në një lëndë, sado kompleks që të jetë të provuarit.

Identifikimi i provave

Një nga çështjet kryesore të të provuarit në këtë lëndë ishte identifikimi/apo njohja e të pandehurve. Provat identifikuese përfshijnë pasiguri të qenësishme. Ka shumë vështirësi të qenësishme që vijnë nga kapricot e perceptimit dhe kujtesës njerëzore. Është e pamjaftueshme që prova e identifikimit e dhënë nga dëshmitari është dhënë në mënyrë të ndershme; çështja e vërtetë në provën e identifikimit nuk ka të bëjë me dëshminë e identifikimit nëse ajo është bërë në mënyrë të ndershme, por nëse ajo dëshmi është e besueshme.

Janë shumë të rëndësishme mënyra se si mund të bëhen gabimet lidhur me provat e identifikimit, shqyrtimi që i duhet ti bëhet këtyre provave dhe kujdesi që duhet të tregohet për të siguruar që një identifikim të cojë në një metodë të drejtë dhe të besueshme për parandalimin e dështimit të drejtësisë. Prova që lidhet me identitetin bazuar në përshtypjet personale, megjithëse *bona fide*, është ndoshta nga të gjitha, grupi i e provave mbi të cilat duhet mbështetur më së paku, dhe nëse nuk mbështetet nga fakte të tjera, është një bazë e pasigurtë për një vendim fajësie.

Krime lufte sipas Nenit 142 të KP të RFSJ (ligji i zbatueshëm)

Titulli i Nenit 142 të LP të RFSJ është Krime Luftë Kundër Popullsisë Civile. Neni ndalon urdhërimin apo egzekutimin e akteve drejtuar kundër popullsisë civile gjatë një lufte apo konflikti të armatosur nëse urdhërimi apo egzekutimi i akteve shkel ligjin ndërkombëtar.

Në komentaret e atij Neni, komentatori Ljubisa Lazarevic i referohet Konventave të Hagës të 1899 dhe 1907; Konventave të Gjenevës së 1949 për Mbrojtien e Civilëve gjatë Luftës; Protokollit të I Shtesë të Konventave të Gjenevës. Këto Konventa janë ratifikuar nga Ish Republika Jugosllavisë sic provohet dhe nga “Gazeta Zyrtare e Presidiumit të Asamblesë Kombëtare të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë”, nr. 6/50 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë – Marrëveshjet Ndërkombëtare”, nr. 16/78.

Autori më pas diskuton veprat e ndryshme penale përshkruar nga Neni 142.

Autori fillon duke thënë se krimet e luftës kundër popullsisë civile mund të kryhen vetëm gjatë luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit. Krimet e luftës kundër popullsisë civile mund të kryhen po ashtu në kushtet e luftës civile, pra, kur nuk ka një konflikt të armatosur jo ndërkombëtar.

Sipas autorit, krimet e luftës janë format e kësaj vepre penale që janë drejtuar kundër të drejtave bazë të qytetarëve: jetës së tyre apo integritetit fizik, lirisë, pronës, të drejtës së gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, etj. Këto aktivitete janë shkelje të rënda të rregulloreve dhe ligjit ndërkombëtar kundër popullsisë civile gjatë luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit nga lufta. Autori është i kujdesshëm të vërë në pah se krimet e luftës kundër popullsisë civile nuk mund të kryhen me aktivitetet që nuk janë përfshirë në këtë Nen. Megjithatë, aktivitetet e përmendura në ligj që formojnë veprën penale të Krimeve të Luftës kualifikohen si krime lufte vetëm nëse ato shkelin rregulloret e së ligjit penal ndërkombëtar.

Autori vë në dukje mbrojtien e kufizuar të civilëve në një konflikt të brëndshëm: sipas Konventës së Gjenevës së 1949 dhe protokollit Shtesë me Konventat e Gjenevës për Mbrojtien e Viktimave të Forcave të Armatosura Jo-Ndërkombëtare (Protocolli II), rregulloret e ligjit ndërkombëtar janë zbatuar në një fushë të kufizuar, që do të thotë se është përcaktuar ndalimi i vetëm disa aktiviteteve të shkruajtura në këtë Nen. Ndalimi përfshin sulmet ndaj jetës dhe integritetit fizik, në vecanti vrasjet në të gjitha format, plagosjet, torturën dhe shkaktimi i vuajtieve, trajtimi jo njerëzor, poshtërimi dhe trajtimi përulës, mbajtja pengjeve, mohimi i të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përdhunimi, detyrimi i prostitucionit, e të tjerë.

Shkurtimisht, Neni 142 i LP të RFSJ parashikon se një person kryen një veprë penale nëse ai/ajo urdhëron apo kryen një nga veprat e përshkruara dhe një akt apo urdhër i tillë përbën po ashtu një shkelje të ligjit ndërkombëtar që është në fuqi në kohën e dhënies së urdhërit apo kryerjes së veprës. Pra, urdhëri apo veprimi duhet të kalojë testin e dyfishtë; të dy, edhe ligji shtetëror i zbatueshëm edhe ligji ndërkombëtar duhet të ndëshkojnë ngjarjen për të patur një zbatim të përgjegjësive penale.

Përgjegjësia penale për krime lufte

Për të gjetur përgjegjësinë penale sipas ligjit ndërkombëtar për ndonjë të akuzuar për veprën penale të krimeve të luftës, duhet që të provohen çështjet në vijim:

- Egzistenca e konfliktit të armatosur, i brëndshëm ose ndërkombëtar, dhe pjesmarrja e të akuzuarit në konfliktin e armatosur;
- Një lidhje midis krimin të supozuar dhe konfliktit të armatosur;
- Civili (mbrojtur) ka statusin e viktimës;
- Urdhëri apo veprimi në fjalë është në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar në fuqi në kohën e veprës;
- Urdhëri apo vepra në fjalë bie nën ato vepra penale të identifikuar si krime lufte brënda Nenit 142 të LP RFSJ;
- Pjesmarrja e të akuzuarit në veprën penale.

Egzistenca e një konflikti të armatosur

Dhoma e Ankesave të ICTY⁶² në çështjen Tadić thotë se një konflikt i armatosur egziston kudo ka drejtime të forcave të armatosura midis shteteve apo dhunë e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara apo midis grupeve të tilla brënda një shteti.

Ligji Humanitar Ndërkombëtar (LHN) zbatohet nga fillimit i konflikteve të tilla dhe zgjat përtej shurjes së veprimeve ushtarake deri në përfundimin e përgjithshëm dhe deri sa paqja është arritur⁶³.

Konventat e plotësuara nga Protokollin Shtesë II (Neni i përbashkët 3 dhe PSHII).

⁶² Tadić, Gjykata e Apelit të ICTY, *Vendimi mbi mocionin e Mbrojtjes për Ankesën e Mocionit Paragjyqsor për Juridiksionin*, 2 Tetor 1995, Lënda Nr. IT-96-1-AR72.

⁶³ Tadić, Gjykata e Apelit të ICTY, *Vendimi mbi mocionin e Mbrojtjes për Ankesën e Mocionit Paragjyqsor për Juridiksionin*, 2 Tetor 1995, Lënda Nr. IT-96-1-AR72, paragrafi 70.

Për të përcaktuar nëse egziston një konflikt i armatosur apo jo, edhe gjykatat vendore edhe tribunalet ndërkombëtare kanë zbatuar në mënyrë konsistente provën përmendur në vendimin Tadić për juridiksionin në të cilën u vendos se intesiteti i një konflikti dhe organizimi i palëve janë çështje themelore faktike për të cilat duhet të vendoset në kënvështrimin e provës së vecantë, në bazë rast-pas-rasti⁶⁴. Statuti i ri i GJNK që pretendon çështjen e juridiksionit për krime të ngjashme ndërkombëtare që nga 2002 adopton po ashtu të njëjtën provë⁶⁵.

Prova e zbatuar për egzistencën e konfliktit të armatosur për qëllimet të rregullave që përmban Neni i përbëshkët 3 fokusohet në dy aspekte të konfliktit; intesiteti i konfliktit dhe organizimi i palëve në konflikt. Në një konflikt të armatosur të brendshëm apo të karakterit të përzier, këto kritere të lidhura ngushtësisht janë përdorur vetëm për qëllim, si minimum, për dallimin e konfliktit të armatosur nga banditizmi, rebelim i shkurtër dhe të paorganizuar, apo aktivitete terroriste, të cilat nuk janë subjekt i ligjit humanitar ndërkombëtar⁶⁶.

Në konfliktin e brendshëm të armatosur, karakteristikat thelbësore të termit “konflikt i armatosur” janë (1) që dhuna e zgjatur e armatosur zhvillohet midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara apo midis grupeve të tilla brënda një shteti, (2) se këto grupe nën komandë të përgjegjshme ushtrojnë kontrolle të tilla kundrejt një pjese të territorit të shtetit që bën të mundur që të kryejnë operacione ushtarake të përbashkëta e të vazhdueshme dhe të zbatojnë Protokollin II të Konventave të Gjenevës së Gushtit 1949, dhe (3) që veprimet ushtarake ndodhin në një nivel që tejkalon atë që mund të karakterizohet si thjesht trazira të brendshme dhe tensione, të tilla si trazira, akte të izoluar dhe sporadike të dhunës dhe vepra të tjera të natyrës së ngjashme⁶⁷.

Intensiteti i Konfliktit

Në vlerësimin e intesitetit të një konflikti, gjykatat kanë konsideruar vazhdimisht faktorë të tillë si serioziteti i sulmeve dhe nëse ka patur një rritje në përplasjet me armë⁶⁸, shpërdarja territoriale e përplasjeve në një periudhë kohe⁶⁹, cdo rritje në numër të forcave qeveritare dhe

⁶⁴ “Përkufizimi i një konflikti të armatosur *per se* është emërtuar në abstrakt, dhe nëse një situatë është përshkruar si “konflikt i armatosur”, duke përmbushur kriterin e Nenit të përbashkët 3, duhet të vendoset në bazë të rast-pas-rasti.” Rutaganda, Gjykata e ICTR, Aktgjykim, 6 Dhjetor 1999, paragrafi 93.

⁶⁵ Neni 8, paragrafi 2(f) i Statutit të ri të GjNP adopton një provë të ngjashme me atë të formuluar në Vendimin e Tadicit për juridiksionin. Ajo përkufizon një konflikt të brendshëm të armatosur nga të njëjtat dy karakteristika,

“konflikt i armatosur i zgjatur” dhe “grupe të armatosura të organizuara”, pa përfshirë kushte të tjera.

⁶⁶ Tadić, gjykimit ICTY, Aktgjykim, 7 Maj 1997, Lënda No. IT-94-1, paragrafi 562.

⁶⁷ Shih Protokollin II të Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949; Tadić, ICTY Ankesa për vendimin për juridiksionin, Gjykata e Apelit, 2 Tetor 1995, Lënda No. IT-94-1-A73.1, paragrafi 70; Akayesu, ICTR Aktgjykimi i Gjykatës, 2 Shtator 1998, Lënda nr. ICTR-96-4-T, paragrafët 620 dhe 625, dhe shih Komentarin e ICRC për Protokollin II.

⁶⁸ Tadić, Aktgjykimi i Gjykatës së ICTY, 7 Maj 1997, lënda nr. IT-94-1, paragrafi 565; Delalic dhe të tjerë, Aktgjykimi I Gjykatës së ICTY, 16 Nëntor 1998, lënda nr. IT-96-21-T, paragrafi 189; Milošević, Gjykata e ICTY, Vendimi mbi kërkesën për aktgjykimin lirues, 16 Qershor 2004, lënda nr. IT-02-54-T, paragrafi 28.

⁶⁹ Tadić, aktgjykimi i gjykatës së ICTY, 7 Maj 1997, lënda nr. IT-94-1, paragrafi 566; Milošević, gjykata e ICTY, Vendimi mbi kërkesën për aktgjykimin lirues, 16 Qershor 2004, lënda nr. IT-02-54-T, paragrafi 29.

mobilizimi dhe shpërndarja e armëve ndërmjet të dy palëve në konflikt⁷⁰, si dhe nëse konflikti ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe, nëse ka kaluar cdo rezolutë për këtë çështje⁷¹.

Organizimi

Kur vendos nëse palët janë të organizuara, tribunalet ndërkombëtare dhe vendore kanë marrë vazhdimisht parasysh egzistencën e shtabeve, zonat e caktuara të operacioneve, dhe aftësinë për të blerë, transportuar dhe shpërndarë armë⁷².

Jurisprudenca ndërkombëtare ka vendosur se disa shkallë të organizimit nga palët do të mjaftonin për të vendosur për egzistencën e konfliktit të armatosur por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se është i nevojshëm sistemi hierarkik i organizimit ushtarak të ngjashëm me forcat e rregullta të armatosura⁷³.

Gjykata e Qarkut të Kosovës⁷⁴ vendosi në lidhje me vërtetimin e konfliktit të armatosur në Kosovë në 1998 se “është e rëndësishme të vërehet se nuk është e rëndësishme për prokurorinë as që të provojë se UCK ishte një forcë tërësisht e unifikuar dhe as që ajo të kishte arritur të njëjtin nivel zhvillimi në të gjithë Kosovën”.

Kontrolli

Çështja e kontrollit është relevante në përcaktimin e zbatueshmërinë e Protokollit Shtesë II.

Aspekti gjeografik i konfliktit të armatosur

Kufiri gjeografik nuk ka ndikim në ndjekjen penale të këtyre krimeve. Jurisprudenca ndërkombëtare ka vendosur prej kohe se shkeljet e ligjit apo zakoneve të luftës mund të ndodhin në një vend ku në fakt nuk po zhvillohen luftime. Tribunalet e ICTY kanë arritur në konkluzionin se

(a) *“Ligji Humanitar Ndërkombëtar vazhdon të zbatohet deri sa të jetë arritur një marrëveshje paqenë të gjithë territorin në kontrollin e një pale, **pavarësisht nëse në fakt atje po zhvillohen apo nuk po zhvillohen luftime**”⁷⁵.*

⁷⁰ Milošević, gjykata e ICTY, Vendimi mbi kërkesën për aktgjykim lirues, 16 Qershor 2004, lënda nr. IT-02-54-T, paragrafët 30-31. Shih po ashtu gjykimin e Čelebici, Delalic e tjerë, aktgjykim i gjykatës ICTY, 16 Nëntor 1998, lënda nr. IT-96-21-T, paragrafi 188.

⁷¹ Tadić, aktgjykimi i gjykatës së ICTY, lënda nr. IT-94-1, paragrafi 567; Delalic e tjerë, aktgjykimi i gjykatës së ICTY, 16 Nëntor 1998, lënda nr. IT-96-21, paragrafi 190.

⁷² Milošević, gjykata e ICTY, Vendimi mbi kërkesën për aktgjykim lirues, 16 Qershor 2004, lënda nr. IT-02-54-T, paragrafët 23-24; Fatmir Limaj e tjerë, aktgjykimi i ICTY, 30 Nëntor 2005, Lënda. IT-03-66-T, paragrafi 90.

⁷³ Musema, Aktgjykimi i gjykatës së ICTR, 27 Janar 2000, lënda nr. ICTR-96-13-T, paragrafi 257.

⁷⁴ Prokurori kundër Latif Gashi e të tjerë, Gjykata e Qarkut Prishtinë, Aktgjykimi i datës 16 Korrik 2003.

⁷⁵ Tadić, gjykata apelit të ICTY, Vendimi mbi mocionin e mbrojtjes për ankesën e procedurës paraprake mbi juridiksionin, 2 Tetor 1995, lënda nr. IT-96-1-AR72, paragrafi 70. Shih po ashtu Aktgjykimin e ICTY Delalic dhe të tjerë, Aktgjykimi i ICTY, 16 Nëntor 1998, lënda nr. IT-96-21, paragrafi 194, ku është vendosur se nuk kërkohet

- (b) *Nuk është e nevojshme që të vërtetohet egzistenca e një konflikti të armatosur brënda secilës komunë në fjalë. Është e mjaftueshme që të vërtetohet egzistenca e konfliktit të armatosur në të gjithë rajonin ku bëjnë pjesë këto komuna*.⁷⁶
- (c) *“...kërkesa që veprimet e të akuzuarit të jenë ngushtësisht të lidhura me konfliktin e armatosur nuk do të shfuqizoheshin nëse krimet ishin përkohësisht dhe gjeografikisht larg nga vendi i luftimeve. Do të ishte e mjaftueshme për shembull për qëllime të kësaj kërkesë, që krimet e supozuara të ishin pranë veprimeve ushtarake që ndodhnin në pjesë të tjera të territorit të kontrolluar nga palët në konflikt*”.⁷⁷
- (d) *“Kërkesa se aktet e të akuzuarve që janë të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur nuk kërkon që vepra penale të kryhet ndërkohë që zhvillohen luftimet, apo tek vendi i luftimit*”⁷⁸.

Prova që provojnë konfliktin e armatosur

Sa për sa i përket Dranovcit, trupi gjykues dëgjoi prova lidhur me krijimin e njësisve të fshatit të UCK në Dranovc dhe fshatrat rreth tij, shumica e të cilave dukej të kishte shtabet e tyre. Ushtarët vëzhgonin forcat Serbe. Ka patur incidente që përfshinin përplasje sporadike midis njësisve të UCK dhe forcave Serbe. Dëshmia e Gjeneral Musa Jasharit tregon se detyrat e tij përfshinin vizitimi i pikave të vrojtimit dhe rregullimi i transportimit të armëve brënda në Kosovë.

Më tej është treguar nëpërmjet dëshmive të R. [REDACTED] L. [REDACTED], R. [REDACTED] R. [REDACTED], Selim Krasniqit dhe të tjerë se UCK kishte mundësinë të blinte dhe transportonte armë për ti shpërndarë ato midis luftëtarëve. Madje ka patur edhe një spital lëvizës që funksiononte në “zonën e lirë”, ku trajtoheshin luftëtarët e plagosur të UCK dhe civilë Shqiptarë⁷⁹. Njësia në Dranovc kishte po ashtu kontigjentin e tij të Policisë Ushtarake.

Më tej UCK në Dranovc kishte mundësinë të drejtonte së paku çështjet e sigurisë të Dranovcit dhe fshatrat përreth dhe madje të shpërngulnin të burgosurit me që ka prova që disa nga të burgosurit ishin dërguar në Drenicë⁸⁰.

Nga shqyrtimi i shumë komunikatave të lëshuara nga UCK⁸¹ është e qartë pavarësisht nga dëshmia e Gjeneral Musa Jashari, se UCK kishte një Komandë të Përgjithshme në fillim të 1998. Komunikata Nr.47 lëshuar në 13/05/98, përmend se me urdhër të stafit të përgjithshëm të UCK, ishin kryer në Mars, Prill dhe Maj në nën zonat të Drenicë/Patrik, dhe 16 pjestarë të UCK ishin vrarë. Duhet përmendur po ashtu Shërbimin e Zbulimit të UCK dhe operacionet që vazhdonin të kryheshin. Komunikata e 19/06/98 përsëri lëshuar nga apo në emër të Stafit të

për aty të kishte veprime luftarake faktike në një lokacion të vecantë apo që luftimet të zhvillohen pikërisht në kohën kur kanë ndodhur veprat e supozuara.

⁷⁶ Blaskic, Gjykata I e ICTY, Aktgjykim, 3 Mars 2000, lënda nr. IT-95-14-T, paragrafi 64.

⁷⁷ Kunarac, Kovac dhe Vokovic, gjykata e apelit të ICTY, 12 Qershor 2002, lënda nr. IT-96-23, paragraf 57.

⁷⁸ Vasiljevic, gjykata e ICTY, Aktgjykim, 29 Nëntor 2002, lënda nr. No. IT-98-32-T, paragraf 25.

⁷⁹ Shih deklaratën e dëshmitarit Dr. A. [REDACTED] H. [REDACTED], proceverbali i gjykimit kryesor, 7 Qershor 2006, faqet 6, 8, dhe 9.

⁸⁰ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor të dëshmitarit Muhamet Berisha, 8 Shkurt 2006, faqe 9.

⁸¹ Prova 15.

Përgjithshëm të UCK thoshte se do të bëhej një mobilizim i përgjithshëm dhe përgatitje për një konfrontim vendimtar me Serbinë.

Gjatë 1998 UCK publikoi Rregulloret Ushtarake dhe Disiplinore (ku duket qartë se ishin bazuar në rregulloret e ushtrisë Shqiptarë). Gjykata mendon se kjo mund të ishte bërë vetëm për rregullimin dhe organizimin e brendshëm të punëve të brendshme të UCK⁸².

Në provat e paraqitura, UCK përbente kërcënim të rëndë dhe të organizuar për rregjimin Serb nëpërmjet aftësive të tyre të treguara për të kryer sulme ushtarake të zgjata në kohë, por më e rëndësishme është se UCK, në periudhën Maj dhe Shtator 1998, përbën një “grup të armatosur të organizuar” që përmbushi kriterin Tadić.

Lidhur me çështjen e kontrollimit është provuar konkretisht kur i referohemi dëshmirë së dëshmitarëve se UCK ishte në kontroll faktik të një pjesë të konsiderueshme të zonës midis qyteteve të Rahovecit dhe Malishevës gjatë periudhës kritike. Një zonë e vecantë e quajtur “Zonë e lirë”, që mbulonte fshatrat e Potoçani i Ultë, Potoçani i Epërm, Sopniq, Drenovc, Ratkovc dhe një numër fshatrash të tjerë deri në qytetin e Malishevës. Autoritet Serbe (civilë, ushtria apo policia) nuk mund të kalonin nëpërmjet kësaj zone. Popullsia civile Shqiptare po ashtu kërkonte leje të largohej apo kthehej në “Zonën e Lirë”⁸³. Gjatë kohës kritike UCK ishte i vetmi autoritet në Drenovc dhe në shumë fshatra Shqiptare rreth tij⁸⁴.

Nga një perspektivë në tërë Kosovën, Human Rights Watch⁸⁵ shkoj deri aty sa të raportonte se “Nga Prilli deri në mes të Korrikut 1998, UCK mbante rreth 40 përqind të territorit të Kosovës, megjithëse pjesa më e madhe e territorit u rimor nga forcat qeveritare në Gusht 1998. Megjithatë, deri në atë kohë, UCK kishte mbajtur një numër qytetesh e fshatrash strategjike, dhe drejtonte pika kontrolli gjatë disa rrugëve kryesore të Kosovës; nga Shtatori 1998 zona e tyre e kontrollit ishte zvogëluar në disa pjesë në Drenicë dhe disa xhepa të shpërndarë në perëndim, vecanërisht gjatë natës”.

Përveç kësaj një numër dëshmitarësh dhanë dëshmi për konfliktin e armatosur.

Dëshmitari E [REDACTED] Rr [REDACTED] deklaroi se kur filloi bombardimi në fillim të Gushtit të gjithë fshatarët u larguan nga Dranovci⁸⁶. Ai u kthye në fshatin e tij në Shtator dhe gjatë kthimit të tij ai pa të gjithë shtëpitë që ishin djegur dhe ai tha se këtë e kishin bërë Serbët⁸⁷. UCK u shfaq në Dranovc në Mars apo Prill dhe dëshmitari kujtoi se i akuzuari i thërriti fshatarët dhe ata po hapnin transhet⁸⁸. Ushtria e UCK përbëhej nga të rinj e të vjetër⁸⁹. Ai kishte dëgjuar se

⁸² Prova 15.

⁸³ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor të dëshmitarit "D" 18 Maj 2006, faqe 28; procesverbali i gjykimit kryesor të dëshmitarit F [REDACTED] B [REDACTED] 8 Qershor 2006, procesverbali i gjykimit kryesor të dëshmitarit N [REDACTED] M [REDACTED] 8 Qershor 2006.

⁸⁴ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor të dëshmitarit F [REDACTED] H [REDACTED] 16 Mars 2006, faqe 8/9.

⁸⁵ Raporti i Human Rights Watch 1999 - Prova 15.

⁸⁶ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor të dëshmitarit E [REDACTED] Rr [REDACTED] 14 Dhjetor 2005, faqe 34.

⁸⁷ Po aty, faqe 35.

⁸⁸ Po aty, faqe 28.

⁸⁹ Po aty, faqe 29.

pjestarët e UCK ishin plagosur dhe vrarë në Maj 1998 në Dranovc por ai nuk mund të jepte emrat e tyre⁹⁰.

Në pyetjen drejtuar atij nga i akuzuari Isuf Gashi dëshmitari deklaroi se UCK u shfaq në Dranovc në muajin Mars apo Prill. Dëshmitari e kujtonte këtë fakt sepse Isuf Gashi e thërriti dëshmitarin dhe të tjerët dhe se ata të gjithë shkuan për të hapur transhetë⁹¹. Pyetjes vijuese të Isuf Gashit, “i kujtohej nëse ushtria ishte e përbërë nga ushtarë të rinj apo të vjetër?” dëshmitari ju përgjigj se kishte ushtatë të rinj dhe të vjetër⁹².

Dëshmitari F. H. dëshmoi se lufta kishte filluar më parë në Dranovc dhe më pas në Ratkovc⁹³. Në kohën kur Sh. Sh. shkoi ta takonte atë ishte kohë lufte por bombardimi nuk kishte filluar⁹⁴. Në kohën kur Sh. Sh. ta takonte atë UCK kontrollonte fshatin e Ratkovcit që është rreth gjashtë deri shtatë kilometra larg nga Dranovc, ku ishte një njësi e UCK dhe ku ndodhej shtabi i UCK⁹⁵. Ai nuk e dinte vendodhjen e shtabit⁹⁶. Dëshmitari F. H. shtoi se “cdo ushtri kishte shtabe jo vetëm Dranovci⁹⁷. Ratkovci dhe fshatra të tjerë përreth kontrolloheshin nga UCK⁹⁸.

Duke komentuar për dëshminë e F. H. Isuf Gashi bëri deklaratën e mëposhtme:

“Unë e kuptoj fjalën konflikt, që ajo përcjell konflikt midis etniciteteve brënda një vendi. Ka patur një luftë në Kosovë; ishte luftë e ashpër dhe e rëndë dhe nuk kishte ndodhur në Balkan që trupat e NATO-s të ndërhyjnë për 78 ditë. Beogradi u bombardua, por në lidhje me atë çfarë po pyet prokurori publik, njësitë e para të UCK u krijuan në Kosovë në 1998. Egziston një ndryshim ndërmjet një formacioni dhe një njësie. Një njësi përmban deri 15 ushtarë. Në 1998 ne kishim njësi në Kosovë, të parat.

Kur pushtuesit hynë në Kosovë në mënyrë barbare në 18 Shkurt 1998, ata masakruan dhe vranë pleq, gra dhe fëmijë në Likoshan Qirez, dhe në 5, 6, dhe 7 Mars në Prekaz u vranë fëmijë dhe gra, dhe në atë rezistencë komandanti i asaj njësie humbi jetën. E njëjta gjë ndodhi në 25 Mars në Dukagjin Glogjan ku u vranë fëmijët dhe gratë. E njëjta gjë ndodhi edhe ditën në të cilën dëshmitari përmendi në 12 Maj, kur armiku erdhi me helikopterë, tanke dhe armë. Ata vranë, rrëmbyen dhe plagosën civilë të pafajshëm. Ata morën dyzina njerëz në Serbi ku ata kanë qenë atje për 4 deri 5 vjet. Njerëzit e zonës vendosën vetë të mbroheshin kundër këtyre përpjekieve barbare dhe secili fshat bëri përpjekje të mbronte veten kundër pushtimi barbar, për të mbrojtur veten nga të gjithë të këqijat që ata sillnin.

⁹⁰ Po aty, faqe 26.

⁹¹ Po aty, faqe 28.

⁹² Po aty, faqe 29.

⁹³ Shih procesverbalin e gjyqimit kryesor Dëshmitari Fadil Hoti, 16 Mars 2006, faqe 8.

⁹⁴ Po aty, faqe 6.

⁹⁵ Po aty, faqe 7.

⁹⁶ Po aty, faqe 11.

⁹⁷ Po aty, faqe 8.

⁹⁸ Po aty, faqe 8.

Nga fundi i vitit 1998 u themelua shtabi qëndror dhe ata ndanë zonat. Ata vendosën apo themeluan brigadat dhe filluan të luftonin dhe në atë kohë UCK u bë aleat i NATO-s. Dhe rezultat i kësaj ishte se nuk kishte më invadime barbare këtu.

Lidhur me personat që u zhdukën apo u vranë, unë jam nga Komuna e Rahovecit dhe mëse një mijë persona u zhdukën apo u raportuan të vrarë. Unë e them këtë me përgjegjësi të madhe sepse unë isha personi që referonte këtë informacion rreth personave të zhdukur dhe të vrarëve. Në komunën time u raportuan mbi 2000 të plagosur. Në 18, 19, 20, dhe 21 Korrik 1998 këto janë ditët ku i gjithë qyteti u zbraz. Si rezultat i këtij terrori edhe besimtarët Muslimanë ishin vrarë në faltore. U vra Sh[REDACTED]. Mbi 300 deri 400 njerëz ishin masakruar, vrarë dhe plagosur. Ka patur tetë masakra masive në komunën tonë. Nëse doni unë mund të përmend emrat e personave për cdo masakër. Ishin mbi njëqind individë. Në Krushë të Madhe kishte mëse 300 persona të vrarë. UCK kreu luftën vetëm kundër barabrëve Serbë, jo kundër popullsisë civile Serbe, e jo më pastaj kundër Shqiptarëve, nuk kishte nevojë për këtë”⁹⁹.

Dëshmitari H[REDACTED] Rr[REDACTED] deklaroi se kur filluan bombardimet të gjithë fshatarët e lagjes së Dranovacit ku jetonte dëshmitari, u larguan. Fëmijët dhe dëshmitari bashkë me vëllain e tij E[REDACTED] Rr[REDACTED] shkuan në një fshat të vogël të quajtur Dejne dhe nga aty ata shkuan në Babobc që ishte diku në male dhe aty ata qëndruan për 2 apo 3 net bashkë me njerëz të tjerë që ishin aty. Të gjithë ishin mbledhur në fshatin Dejne¹⁰⁰.

Sipas dëshmitarit M[REDACTED] B[REDACTED] në Korrik 1998 paramilitarët Serbë kishin filluar ofensivën e tyre¹⁰¹. Para kthimit të tij në Kosovë dëshmitari kishte parë apo dëgjuar lajme për sulmet nga Serbët në Rahovec dhe rrethinat e tij dhe se kishte patur shumë nga këto sulme. Ai nuk mund të jepte datat e sakta të këtyre sulmeve¹⁰². Fshati i tij Brestovc ishte sulmuar në 25 Mars 1998 dhe ky ishte sulmi i dytë¹⁰³. Një muaj para se ai të vinte në Kosovë, Rahoveci dhe rrethinat e tij ishin sulmuar, por ai nuk mund të thoshte nëse Rahoveci ishte sulmuar përpara se të rrëmbehej babai i tij në 13 Korrik 1998.

Që kur filloi bombardimi i NATO, kur ushtria Serbe sulmoi Rahovecin, fshatin e dëshmitarit, dëshmitari qëndroi në shtëpi për një javë pasi forcat Serbe ishin vendosur në fshatin e tij. Ata i cuan fëmijët jashtë fshatit. Ai më pas qëndroi në fshatin Nagavc sepse shtëpia e tij ishte djegur deri në themel dhe pas kësaj ai shkoi në Shqipëri¹⁰⁴. Kur M[REDACTED] B[REDACTED] shkoi në Dranovc, ai nuk pa ndonjë shtëpi apo pasuri të fshatarve të asaj zonë që ishte djegur¹⁰⁵. Kur po hynte në fshat, ai u ndesh me disa ushtarë dhe në disa raste kur ishte në fshat ai pa ushtarë.¹⁰⁶

⁹⁹ Shih dëshminë në gjykimin kryesor të Isuf Gashit, 16 Mars 2006, faqet 18, 19 dhe 20.

¹⁰⁰ Shih dëshminë e H[REDACTED] Rr[REDACTED] në gjykimin kryesor, 15 Dhjetor 2005, faqe 40.

¹⁰¹ Shih dëshminë e M[REDACTED] B[REDACTED] në gjykimin kryesor, 8 Shkurt 2006, faqe 9.

¹⁰² Po aty, faqe 14.

¹⁰³ Po aty, faqe 14.

¹⁰⁴ Po aty, faqe 15.

¹⁰⁵ Po aty, faqe 16.

¹⁰⁶ Po aty, faqe 16.

Në 13 Korrik 1998 ka patur luftime në Rahovec por jo në Brestovc. Megjithëse në fshatrat Brestovc, Krushe, Celinë dhe Bellacerkë nuk ka patur luftime në 12 apo 13 Korrik, por përpara dhe pas kësaj ka patur periudha luftimi që zgjatnin dy deri tre ditë¹⁰⁷. Policia ka qenë e pranishme në Rahovec por ishte i mbushur me forca Serbe. Madje edhe civilët Serbë ishin të armatosur në atë kohë. Megjithatë në fshatin Brestovc, forcat policore apo ushtarake Serbe nuk arritën të futen për një vit, deri në ditën e ofensivës kur ata dogjën të gjithë fshatin. Rruga kryesore në Rahovec ishte rethuar nga ushtria dhe policia Serbe¹⁰⁸.

Komanda e UCK për të gjithë fshatin e Brestovcit ishte e vendosur në Drenas¹⁰⁹. Dëshmitari kishte dëgjuar se Bedri Zyberaj ishte zyrtar i lartë. Ai e kishte parë Xh[REDACTED] G[REDACTED], ndryshe "Gjermani" në fshat por ai nuk kishte folur me të dhe kur ai shkoi në fshat ai takoi Selim Krasniqin por nuk e kishte njohur atë përpara kësaj dite¹¹⁰. M[REDACTED] B[REDACTED] erdhi nga Shqipëria. Ai udhëtoi nga Kukësi dhe ai kishte transportuar armë për UCK. Ai i pruri armët në Hoc të Vogël.

Duke komentuar dëshminë e Muhammet Berishës i pandehuri Selim Krasniqi deklaroi se UCK nuk ishte angazhuar vetëm në Dranovc, por operonte po ashtu në të gjithë Kosovën. Qëllimi kryesor i UCK ishte çlirimi i Kosovës nga pushtuesit Serbë dhe nuk ishte interesi i UCK të merrej me A[REDACTED] B[REDACTED]¹¹¹.

Dëshmitari N[REDACTED] Rr[REDACTED] deklaroi se kur ai dhe H[REDACTED] shkuan për të kërkuar për M[REDACTED] Rr[REDACTED] ata shkuan në një vend që na ishte thënë si shtabi – kooperativa bujqësore. Vendi ishte shtabi i UCK¹¹². Ai kishte qenë te shkolla vetëm dhe kishte marrë disa tessa për M[REDACTED] vetëm një herë. Z[REDACTED] i mori teshat nga ai¹¹³. Kur ishte atje ai dëgjoji një zë, dikë që po bërtiste, por Z[REDACTED] i tha atij, "Largohu tani, shko në shtëpi"¹¹⁴.

Dëshmitari tha se bombardimi filloi në 19 Korrik 1998¹¹⁵. Dëshmitari dhe familja e tij u larguan nga fshati Dranovc bashkë me fshatarë të tjerë kur filloi sulmi¹¹⁶.

Gjatë Majit dhe Qershorit 1998 nuk ka patur luftime dhe sulme nga forcat Serbe apo përlëshje me UCK apo forcat Serbe në atë zonë ku jetonte dëshmitari. Ai nuk mund të thoshte nëse kishte ndonjë përlëshje në fshatra të tjerë me që ai nuk ishte larguar nga fshati i tij¹¹⁷, por ai besonte se të gjithë fshatrat në Dranovc ishin sulmuar gjatë luftës në 1998¹¹⁸. Kur fshati i tij u bombardua në 1998 dhe më pas kur filloi lufta, pothuajse të gjithë fshatrat ishin bombarduar.

¹⁰⁷ Shih procesverbali gjykimit kryesor dëshmitari M[REDACTED] B[REDACTED], 10 Maj 2006, faqe 6.

¹⁰⁸ Po aty, faqe 7.

¹⁰⁹ Po aty, faqe 7.

¹¹⁰ Po aty, faqe 7.

¹¹¹ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor për të pandehurin Selim Krasniqi, 8 Shkurt 2006, faqe 21.

¹¹² Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari N[REDACTED] Rr[REDACTED], 15 Dhjetor 2005, faqe 6.

¹¹³ Po aty, faqet 11 dhe 12.

¹¹⁴ Po aty, faqe 12.

¹¹⁵ Po aty, faqe 18.

¹¹⁶ Po aty, faqe 18.

¹¹⁷ Shih gjykimin kryesor dëshmitari N[REDACTED] Rr[REDACTED], 25 Maj 2006, faqe 7.

¹¹⁸ Po aty, faqet 7 dhe 8.

Ai tha se kjo ishte dicka që të gjithë e dinin, se të gjithë fshatrat ishin bombarduar dhe djegur¹¹⁹.

Dëshmitari po ashtu shpjegoi se nëse dikush donte të dilte dhe të hynte në Rahovec apo të shkonte në drejtim tjetër drejt Xërxës, ai/ajo do të binte viktimë sepse atje ishte ushtria dhe policia Serbe. Nuk ishte e sigurtë për një person që të shkonte në atë drejtim. Shqiptarët apo luftëtarët e UCK ranë viktimë të policisë apo ushtrisë Serbe¹²⁰. Sipas dëshmitarit, Dranovc dhe fshatrat përreth ushin nën kontrollin e UCK. Kur UCK ishte brënda në fshat kishte pika kontrolli Serbe të policisë, paramilitarëve apo militarëve në zonat ku ishte në kontroll UCK¹²¹.

Dëshmitari anonim "B" deklaroi se, në atë kohë, shtabi i UCK ne Dranovc ishte vendosur në një shtëpi përdorur si ndërtesa e komunës dhe që ishte pranë shkollës¹²². Ratkovcit u dogj në 17 dhe 18 Korrik¹²³. Më vonë u dogjën Bellacerka dhe Rahoveci dhe dëshmitari nuk mund të shkonte më në Dranovc¹²⁴. Kur kishte udhëtuar nga Dranovci për në Ratkovc dhe më pas në Brestovc dëshmitari nuk kishte parë kontrole të policisë Serbe apo ndonjë lloj kontrolli në rrugët apo ndonjë betejë ndërmjet UCK dhe forcave Serbe në atë kohë¹²⁵. Fshatrat Brestovc, Ratkovc, Xerxe, dhe Pirana ju vu zjarri në 17 dhe 18 Korrik. Kur Shqiptarët e Kosovës u përzunë për në Shqipëri, këto fshatra u dogjën për herë të dytë dhe këtë herë u dogj edhe fshatrat e tjerë si Krusha¹²⁶.

Sipas dëshmitarit anonim "D" kur dëshmitari po përpiquej të shkonte tek Hidaj Popaj ai/ajo nuk ishte lejuar të hynte në zonën e lirë. Me zonë të lirë ai/ajo donte të thonte zonën e kontrolluar nga UCK. Ky kontroll mbulonte të gjithë fshatrat si Potoqani i Epërm, Potoqani i Ulët, Sukaniq, Dranovc, Ratkovc dhe të gjithë fshatrat e tjerë deri në Malishevë. Zona e lirë ishte deri tek ura e Krmavik. Ai/ajo shtoi se çfarë nënkuptonte me "të lirë" ishte zona e lirë nga Serbët me që ishte e kontrolluar nga UCK¹²⁷. Ai/ajo nuk e dinte datën e saktë se kur ishte bërë zonë e lirë por besonte në fillim të të Korrikut¹²⁸. Kur ai/ajo u pyet nga S ■ K ■ nëse "për kohën që po flasim apo për kohën për të cilën po flisim ishte koha kur UCK sapo ishte filluar ta organozonte veten dhe kishte vetëm një njësi në Dranovc" dëshmitari/ja u pëgjigj "Unë di vetëm që ushtria ishte formuar. Unë nuk di ndonjë gjë tjetër"¹²⁹.

Kur u pyet nëse në u zhvillua një betejë midis UCK dhe Serbëve në muajt Maj, Qershor apo Gusht 1998 për të marrë zonën e lirë, ai/ajo tha se në Korrik ka patur një betejë në fshatrat Bellacerkë dhe Rahovec, dhe ishin vrarë Shqiptarë, po ai/ajo nuk mund të thonte nëse ishin vrarë Serbë¹³⁰. Pas spjegimit se një betejë është një luftë midis dy palëve ai/ajo shtoi se lufta

¹¹⁹ Po aty, faqe 8.

¹²⁰ Po aty, faqe 7.

¹²¹ Po aty, faqe 6.

¹²² Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari anonim "B", 23 Maj 2006, faqe 8.

¹²³ Po aty, faqe 6.

¹²⁴ Po aty, faqe 7.

¹²⁵ Po aty, faqe 19.

¹²⁶ Po aty, faqe 19.

¹²⁷ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari anonim "D", 18 Maj 2006, faqe 28.

¹²⁸ Po aty, faqe 31.

¹²⁹ Po aty, faqe 35.

¹³⁰ Po aty, faqe 28.

ishite midis UCK dhe ushtrisë Serbe¹³¹. Midis këtyre palëve u zhvillua betejë në Prill, Maj apo Qershor 1998 në fshatrat Bellacerkë, Rahovec dhe Dranovc¹³². Forcat Serbe kishin tanke dhe automjete të blinduara dhe ata dogjën të gjithë fshatin duke filluar me Rahovecin dhe Dranovcin. Ai/ajo nuk kishte ndonjë ide për pjesmarrësit e UCK”¹³³. Gjatë pesë gjashtë muajve të parë të vitit 1998, forcat Serbe, policia dhe ushtria kishin kapacitetin të sulmonin dhe të merrnin cilin do fshat që donin¹³⁴. Policia Serbe vrau shumë civilë brënda dy apo tre ditëve¹³⁵. Pati 70 të vrarë në Bellacerkë; 80 në Celin; 150 në Krushë të Madhe; 100 në Krushe të Vogel; 50 deri në 60 në Nagaviciki, dhe i njëjti numër në Hocë të Vogel¹³⁶.

Dëshmitari anonim “TT” dëshmoi se ka patur sulme në zonën e tij/saj në verë të 1998 nga forcat Serbe dhe fshati Drenovac u sulmua po ashtu¹³⁷. Ka patur luftime apo përleshje gjatë Majit, Qershorit dhe Korrikut 1998 midis UCK dhe forcave Serbe në Bellacerkve, Celinë, Bratotinë dhe Dranovc. Serbët dhe Shqiptarët luftonin me njëri tjetrin dhe një person vdiq¹³⁸. Dëshmitari/rja nuk kujtoj nëse në Maj, Qershor apo Korrik 1998 forcat Serbe qarkulluan në zonën e Rahovecit, Prizren dhe Xërxë. Kur zona u mor nga Serbët kishte një ushtri dhe forcat Serbe dhe zona u mor nga Serbët. Ka qenë 18 Korrik 1998 kur ata morën Bellacerkën¹³⁹.

Si ushtar/e i/e UCK ka marrë pjesë personalisht në luftimet në Bellacerkë në 18 Korrik 1998. Ishin 10 ushtarë të UCK të përfshirë në luftime dhe në një pikë kontrolli në Bellacerkë, u vra T█████K█████. Nga Muhadri, një fshat në zonën e Hasit branda kufirit të Shqipërisë më tej gjatë lumit drin, ushtarët e ushtrisë Jugosllave bombarduan ata dhe më pas dhe erdhën e morën cdo gjë nga ata. Armët e përdorura nga Serbët ishin katjusha Ruse¹⁴⁰. Gjatë muajve Maj, Qershor dhe Korrik 1998, UCK ishte në kontroll të fshatit Dranovc dhe fshatrat përreth¹⁴¹. Lidhur me këtë, i pandehuri Isuf Gashi bëri komentin vijues “Unë nuk besoj që UCK të ketë arrestuar popullsi civile Shqiptare. Mendimi im është se UCK ndihmoi me sa mundej”¹⁴².

Ka patur shtabe të UCK në Radoste dhe Ratkoc¹⁴³. I akuzuari Isuf Gashi deklaroi gjatë pyetjes nga ai të dëshmitarit se njësitë u ngritën për ti mbrojtuar ata nga forcat Serbe¹⁴⁴. Sipas dëshmitarit UCK në Dranovc e ngriti Isuf Gashi¹⁴⁵.

Dëshmitari anonim “U” deklaroi se Agron Krasniqi dhe Z█████B█████, erdhën në shtëpinë e tij në 16 Korrik 1998 dhe e cuan në shtabin ushtarak në Dranovc¹⁴⁶. Në kohën që ai/ajo u

¹³¹ Po aty, faqet 33 dhe 34.

¹³² Po aty, faqe 34.

¹³³ Po aty, faqe 34.

¹³⁴ Po aty, faqe 34.

¹³⁵ Po aty, faqe 35.

¹³⁶ Po aty, faqe 35.

¹³⁷ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari anonym “TT”, 17 Maj 2006, faqet 38 dhe 39.

¹³⁸ Po aty, faqe 39.

¹³⁹ Po aty, faqe 44.

¹⁴⁰ Po aty, faqe 45.

¹⁴¹ Po aty, faqe 39.

¹⁴² Po aty, faqe 50.

¹⁴³ Po aty, faqet 49 dhe 50.

¹⁴⁴ Po aty, faqe 50.

¹⁴⁵ Po aty, faqe 48.

¹⁴⁶ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari anonim “U”, 10 Maj 2006, faqe 11.

arrestua dhe dhe u cua në zyrën e të akuzuarit Selim Krasniqi, kishte një njësi të UCK në atë vend dhe megjithëse ai/ajo nuk e kishte parë atë, kishte dëgjuar rreth tij¹⁴⁷. Ai/ajo u pyet tek shtabi i UCK¹⁴⁸.

Duke komentuar dëshminë e dëshmitarit “U” i pandehuri Selim Krasniqi deklaroi “Unë dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast të informoj gjykatën se UCK bëri një luftë të drejtë¹⁴⁹. Disa herë UCK ishte përfshirë në shumë gjëra të tjera. Ne përballeshim me një luftë të pabarabartë me një armik kështu që ajo për të cilën ne ishim të interesuar në atë kohë ishte të cilin vendin tonë”¹⁵⁰.

Sipas dëshmitarit anonim “X” UCK kishte shtabin e saj në Reti dhe ne po ashtu kishin zënë ndërtesën e shkollës në Dranovc¹⁵¹.

Kur dëshmitari anonim “Z” u pyet për emrat e fshatrave dhe qyteteve që përbënin zonën e kontrolluar nga UCK në zonën e tij/saj, ai/ajo përmendi vetëm Dranovc dhe Ratkovc por tha se asnjë nuk e kontrollonte fshatin e tij Bellacerkën¹⁵².

Dëshmitari deklaroi se duke vizituar H■■■■ P■■■■ për herë të parë, ai/ajo nuk e pa atë përsëri sepse rreth 18 Korrikut 1998 filloi ofensiva Serbe në fshatin e tij në Bellacerkë, duke i detyruar ata të largoheshin nga fshati dhe kështu ata shkuan në Ratkovc. Ai/ajo u kthye në fshatin e tij/saj një muaj më vonë dhe shkoi në Dranovc për të kërkuar përsëri për H■■■■ P■■■■¹⁵³.

Dëshmitari kishte dëgjuar se rreth fundit të Majit 1998, midis fshatrave Bellacerkë dhe Xërxë, u vranë dy apo tre persona dhe një person i plagosur u arratis. Për atë ngjarje në atë vend është ngritur një monument¹⁵⁴. Dëshmitarit përmendi emrat e dy prej atyre personave që ishin S■■■■ B■■■■ dhe F■■■■ G■■■■¹⁵⁵.

Në përgjigje të një pyetje drejtuar nga avokati mbrojtës F■■■■ B■■■■ dëshmitari sqaroi se në 17 dhe 18 Korrik 1998 rruga ishte bllokuar nga UCK në Bellacerkë. Policia Serbe sulmoi barrikatat dhe gjatë sulmit ishin vranë disa persona nga Dranovc, tre gra nga Bellacerka, dhe një burrë nga Dranovc. G■■■■ P■■■■ u vra në kryqëzimin e rrugës së Bellacerkës nga një Serb¹⁵⁶. Dëshmitari shtoi se në Bellacerkë u vranë pjestarë të popullsisë civilëve, me përjashtim të G■■■■ P■■■■ dhe një ushtari¹⁵⁷.

¹⁴⁷ Po aty, faqe 13.

¹⁴⁸ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor të dëshmitarit anonim “U”, 14 Dhjetor 2005, faqe 8.

¹⁴⁹ Po aty, faqe 14.

¹⁵⁰ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor i pandehuri Selim Krasniqi, 10 Qershor 2006, faqe 15.

¹⁵¹ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari anonim “X”, 30 Nëntor 2005, faqet 6 dhe 7.

¹⁵² Shih procesverbalin e gjykimit kryesor dëshmitari anonim “Z”, 17 Maj 2006, faqet 28 dhe 29.

¹⁵³ Po aty, faqe 13.

¹⁵⁴ Po aty, faqet 22 dhe 23.

¹⁵⁵ Po aty, faqe 23.

¹⁵⁶ Po aty, faqe 24.

¹⁵⁷ Po aty, faqe 24.

Dëshmitari nuk ishte në dijeni nëse ishte vrarë ndonjë civil nga Serbët në fshatrat e Xërxës, Dranovc, Krushë dhe fshatra të tjerë në Komunën e Rahovec apo nëse kishte luftime, apo nëse forcat Serbe hynë në fshatra, i dogjën ato dhe vranë njerëz, në Gusht dhe Shtator 1998¹⁵⁸.

Dëshmitari ishte në dijeni se për një periudhë kohe gjatë Majit, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator apo Tetor 1998 ka patur luftime midis dy yshtrive në rajonin e Rahovecit, por nuk ishte njësoj sic ishte në Mars 1999¹⁵⁹.

Ai/ajo nuk e dinte nëse kishte patur luftime në Maj, Qershor apo Korrik 1998 në fshatin e tij/saj apo në fshatrat përreth sepse ai/ajo nuk mori pjesë në ndonjë luftë¹⁶⁰. Ai/ajo ishte vetëm në zonën ku ka qenë ushtria clirimtare, zonën e Dranovc dhe Ratkovc¹⁶¹.

Ai/ajo konfirmoi të kishte thënë si më poshtë përpara gjyqtarit hetues, “Disa ditë më vonë, unë dhe të tjerë që ishim aty, u larguam nga fshati Ratkovc sepse policia Serbe po hynte në zonën e kontrolluar nga UCK. Ne u larguam dhe shkuam në fshatin Rogovë. Ne ishim midis disa familjeve në Ratkovc dhe ne të gjithë shkuam në fshatin Rogovë. Unë qëndrova në Rogovë gjatë natës. Të nesërmen unë shkova në Prizren nëpërmjet një zonë fshati gjatë Drinit. Unë qëndrova në Prizren për dy javë. Pas dy javësh unë u ktheva përsëri në fshatin tim nga Prizreni nëpërmjet të njëjtës rrugë gjatë zonës së Drinit sepse disa familje të tjera po ashtu ishin kthyer në fshat”¹⁶².

I pandehuri Selim Krasniqi dha dëshminë e mëposhtme se si ai ju bashkua luftimeve: “Fakti që unë shkova në vendet ku kishte luftime pavarësisht nga vendodhja në rajon në Kosovës tregon se unë duhet të luftoja me ta dhe të mbroja popullsinë civile. Nuk ishte zgjedhja ime të luftoja, por kjo luftë ishte e imponuar nga sundimi Serb dhe unë doja të isha në vendet ku zhvilloheshin luftimet. Ky ishte preokupimi im kryesor atë kohë, asgjë tjetër”¹⁶³.

Ai shtoi se në Maj dhe Qershor, nuk ka patur luftime pikërisht në Dranovc. Ka patur luftime në fshatrat përreth Dranovecit. Ai përmendi betejën e Ratish dhe betejën e Kramovik. Ai theksoi me forcë se në Dranovc, nuk ka patur luftime, por ka patur luftime në fshatrat përreth ku Serbët po përpiqeshin të hynin në zonat civile dhe të fillonin vrasjet¹⁶⁴.

Kur u pyet se në cilat fshatra kishte kontroll UCK dhe sulmet dhe luftimet erdhën si rezultat i përpjekies së Serbëve për të rifituar kontrollin e fshatrave, i pandehuri tha “unë nuk do ta quaj atë një përpjekie për të rifituar territorin por unë do ta quaj përpjekie për të vrarë civilët. Sepse në atë kohë numri anëtarëve të njësive nuk ishte shumë i madh. Nuk kishte ushtarë të mjaftueshmë për ta patur të gjithë atë zonë nën kontroll. Kjo është aryeja kryesore përse unë ndihmova bashkë me disa ushtarë në disa raste. Nëse numri i ushtarëve do të ishte i

¹⁵⁸ Po aty, faqe 24.

¹⁵⁹ Po aty, faqe 25.

¹⁶⁰ Po aty, faqe 25.

¹⁶¹ Po aty, page 25.

¹⁶² Po aty, faqet 25 dhe 26.

¹⁶³ Shih procesverbalin e gjykimit kryesor i pandehuri Selim Krasniqi, 21 Qershor 2006, faqe 11.

¹⁶⁴ Po aty, faqe 11.

mjaftueshmë për të mbajtur zonën nën kontroll nuk do të ishte e nevojshme për ne të shkonim dhe të ndihmonim njësitë e tyre”¹⁶⁵.

Atij ju paraqit një përmbledhje të një dokumenti të publikuar nga Human Rights Watch të titulluar “Një fshat i shkatërruar” përgatitur në 1999, që thotë se: “Nga Prilli deri në Korrik 1998, UCK mbante 40% të territorit të Kosovës dhe pjesa më e madhe e territorit ishte marrë në Gusht 1998”. Në të po ashtu thuhet se “UCK mbante një numër qytetesh dhe fshatrash dhe drejtonte shumë pika kontrolli gjatë disa nga rrugët e Kosovës dhe se nga Shtatori 1998 zona e tyre e kontrollit ishte zvogëluar”. Kjo përmbledhje u paraqit në provat (Prova 15d).

Ai u pyet nëse ai ishte një mendimi apo jo me atë se çfarë shkruhej në atë artikull, dhe përgjigja e tij ishte “Besoj se shifra e 40% është e egzagjeruar. Ky është mendimi im. Unë besoj, dhe jam në dijeni, se në atë kohë egzistonte një zonë e lirë. Unë përmenda më herët se organizimi ishte bërë më herët në disa zona. Unë mund të përmend zonën e Drenicës që kishte një organizim të konsoliduar dhe konfliktet filluan atje më herët. Megjithatë unë deklaroj se shifra e 40% është shumë”¹⁶⁶.

Kur u pyet nëse UCK në Dranovc dhe zonat përreth, dhe në Kosovë dhe rreth Kosovës, mobilizoi forcat e saj për betejën, i pandehuri u përgjigj “Unë nuk e di saktësisht se ku luftuan njësitë e Dranovcit. Por unë besoj se betejat që ndodhën në atë kohë, pjesëtarë prej njësisë së Dranovcit morën po ashtu pjesë sepse unë besoj se edhe në vendet ku u zhvilluan luftime kishte njësi të vogla. Disa nga ata mund të kenë shkuar në Ratish për të luftuar apo në Kramovik. Por unë nuk mund të them se Dranovc i organizoi ata. Unë konsideroj se në atë kohë, kjo ishte një luftë spontane.

Ushtarët më me vullnet në atë kohë ndiqnin në radio për betejat që zhvilloheshin. Disa nga ata shkonin dhe ndihmonin aty ku zhvilloheshin betejat. Kjo është mënyra se si unë konsideroj në mënyrë llogjike të rridhnin ngjarjet në atë kohë, apo luftimet sic e thotë prokurori, dhe jo ndryshe”¹⁶⁷.

Kjo është mënyra se si rrodhën ngjarjet në atë kohë, apo luftimi si e thotë prokurori dhe jo ndryshe”¹⁶⁸.

Ai dëgjoi se po bëhej një betejë në Ratkovac, por nuk e dinte se edhe në Malishevë po bëhej një betejë, duke thënë “Nuk e di në Korrik, nuk e di”¹⁶⁹.

Ai kishte qëndruar 5 ditë në Dranovc për të ndihmuar dhe kur e pyetën nëse mund të arrinte në ndonjë përfundim lidhur me ekzistimin e policisë ushtarake në Rahovec dhe kush i drejtonte ata, i pandehuri u përgjigj “Absolutisht jo”. Ai pa ushtarë atë ditë, si dhe civilë, dhe të gjithë ishin aktivë me kuptimin që kishin detyra të caktuara. Civilët po përgatiteshin për tu larguar dhe ushtarët e pranishëm po merreshin me popullatën civile ndërkohë që ata po largoheshin

¹⁶⁵ Po aty, faqe 11.

¹⁶⁶ Po aty, faqe 11.

¹⁶⁷ Po aty, faqe 12.

¹⁶⁸ Ibid, faqe 12

¹⁶⁹ Ibid, faqe 13

nga vendi. Shumë prej tyre po përgatiteshin të konfrontoheshin me forcat Serbe. Ai shtoi se përshkrimi i tij ishte i përafërt me situatën në Dranovc¹⁷⁰.

Sa i përket faktit nëse UCK-ja ishte ende në veprim në Dranovc kur ai u kthye nga Shqipëria në Gusht 1998, i pandehuri dha këtë përgjigje “Kur u ktheva në Gusht, një pjesë e UCK-së ishte atje në Dranovc. Shumica e popullatës civile ishte larguar, por kishin mbetur disa civilë. Arsyeja pse unë shkova në Dranovc ishte thjesht të gjykoja rrethanat dhe të shikoja se çfarë po ndodhte, dhe të shprehja ngushëllimet e mia familjeve që kishin humbur anëtarët e tyre, nënave që kishin humbur djemtë e tyre. Kishte dhe një tjetër arsye pse unë shkova atje, dhe kjo kishte lidhje me shenjat për një tjetër sulm që do të fillonte dhe e vërteta është se vetëm pak ditë pasi shkova unë në Dranovc filloi sulmi, nga fillimi i Shtatorit nëse më kujtohet saktësisht. Unë morra pjesë në atë ofensivë dhe isha atje derisa ajo mbaroi. E vetmja gjë që bëmë për civilët ishte t’i mbronim ata nga masakrat e forcave Serbe dhe normalisht ne i lëvizëm ata në zona të sigurta. Meqë UCK-ja nuk kishte më municione ata ishin të detyruar të tërhiqeshin dhe fatkeqësisht, unë nuk e dija që në atë kohë shumica ikën në Shqipëri. Ne u ndamë nga ofensiva dhe dy apo tri ditë më vonë shkua në male me disa ushtarë dhe kolegë të mi dhe u munduam të lidheshim me ushtarë të tjetër. Në veçanti u takova me Bedri Zyberaj i cili më çoi me veturën e tij në fshatin tim. Ky ishte momenti i fundit kur unë isha në Dranovc të Zatriq”¹⁷¹.

Pyetjes së avokatit mbrojtës Mexhit Sylja mbi rrethanat që mbizotëronin në kohën materiale, i pandehuri theksoi se “rrethanat në fillim ishin të vështira, duke filluar nga ushqimi, veshjet, municionet, etj. Një aspekt tjetër i vështirë ishte futja nga ana jonë e armëve në Kosovë dhe rreziku konstant që na kanosej nga forcat Serbe që ishin pozicionuar në vende të ndryshme, përfshi këtu normalisht edhe kufirin e Kosovës. Pavarësisht nga rrethanat e vështira në atëkohë, masakra që ndodhi në Prekaz dhe disa pjesë të tjera të Drenicës në atë kohë, situata i shtyu të gjithë që donin të jetonin mirë të mobilizoheshin pavarësisht nëse ishin në Kosovë apo jashtë. Pa marrë parasysh sasinë apo cilësinë e municioneve që kishin, u ngrit një rezistencë vetëm për të shmangur masakra të tjera dhe për t’i treguar njerëzve se ekzistonte një forcë që i donte të gjithë dhe se kjo forcë po rritej. Rrethanat ishin shumë të vështira por motivimi ishte i lartë sepse lufta ishte imponuar mbi njerëzit e Kosovës”¹⁷².

I pandehuri Islam Gashi ka deklaruar se është bashkuar me UCK-në në 26 Prill 1998¹⁷³. Detyrat e tij ishin kryesisht detyra vrojtuese¹⁷⁴. Ai ka shërbyer si një ushtar i thjeshtë deri më 27 Maj 1998, ditën kur pësoi lëndime¹⁷⁵. Në 26 Prill 1998, në fshatin Dranovc mbërriti një njësi policore Serbe dhe kur po hynin në fshat rrëmbyen një person dhe filluan ta rrihnin atë. Në Qerez, Likoshan dhe Prekaz kishin ndodhur masakra. Të rinjtë po arrestoheshin sepse disa prej tyre nuk donin të hynin në shërbimin ushtarak dhe të tjerë sepse dyshoheshin se ishin anëtarë të UCK-së. Njerëzit nuk ndiheshin të sigurt në shtëpitë e tyre. Si rrjedhojë e kësaj, i pandehuri në mënyrë të hapur u bashku me UCK-në. Pasi UCK-ja u bë e njohur publikisht i pandehuri mbeti në fshatin e tij¹⁷⁶.

¹⁷⁰ Ibid, faqe 13 dhe 14

¹⁷¹ Ibid, faqe 21

¹⁷² Ibid, faqe 26 dhe 27

¹⁷³ Shiko Procesverbalin e të pandehurit Islam Gashi, 29 Qershor 2006, faqe 24

¹⁷⁴ Ibid, faqe 16

¹⁷⁵ Ibid, faqe 17

¹⁷⁶ Ibid, faqe 24

Kur u bashkua me UCK-në nuk ka patur armë të mjaftueshme për të gjithë ushtarët. Disa ushtarë kishin vetëm dy granata. Ata duhej të mbronin veten dhe familjet e tyre nga masakra¹⁷⁷. I pandehuri dhe tre miq të tij ishin caktuar nga M [REDACTED] Z [REDACTED] të shkonin te kufiri dhe të merrnin armët. Rrugës për atje atyre ju ishte vënë një pritë. Tre shokët e tij u vranë. Ai arriti të mbijetonte¹⁷⁸.

I pandehuri Agron Krasniqi ka qenë në UCK që prej 21 Qershorit deri në fund të luftës në Qershor 1999, me disa ndërprerje. Gjatë periudhës 21 Qershor deri në fund të Shtatorit, ai ka shërbyer gjithë kohës në njësitin në fshatin e tij. Për shkak të mungesës së armëve njësitit nuk mund të rriste numrin e vet dhe ai me shokët dhe bashkëfshatarët e tij u desh të shkonin në Shqipëri për të marrë armë në fund të Qershorit. Shtatë apo tetë persona shkuan për të marrë armët¹⁷⁹.

Në fillim kishte disa persona në njësitin e fshatit të tij, rreth 10 apo 15, por më vonë u bashkuan edhe të tjerë dhe u bë 20 apo 30 vetë. Për shkak të mungesës së armëve, ky numër nuk mund të rritej më. Ata po operonin në fshat për të përgatitur dhe mbrojtur veten. Ata nuk kishin ndonjë vend të posaçëm nga ku operonin sepse nuk ishin një armatë moderne. Ata nuk bashkëpunonin apo kishin lidhje ndonjë njësit tjetër nga ndonjë fshat tjetër sepse nuk kishin kohë të mjaftueshme për të bashkëpunuar¹⁸⁰.

Ai kishte dëgjuar se në Dranovc funksiononte një njësit i UCK-së, fshat ky që është rreth 10-15 kilometra nga fshati i tij, Denje, ashtu siç kishte dhe njësite të UCK-së që operonin në fshatra të tjerë. Ai nuk shkoi asnjëherë në njësitin e Dranovcit dhe rrethinën e tij sepse nuk kishte asnjë arsye për ta bërë këtë¹⁸¹.

Gjatë kohës që ishte me UCK-në, sa i përket detyrave të tij, i pandehuri ka deklaruar se nuk kishte detyra të përcaktuara për asnjërin. Ata të gjithë u munduan shumë që organizoheshin me armët e tyre personale, për të vrojtuar dhe informuar popullatën që ata të mund të largoheshin nga vendi në kohë. Askush nga njësitit i tij nuk kishte detyra të veçanta, si logjistikë, sigurim, apo kujdes shëndetësor. Ata nuk kishin burime për të gjetur furnizime dhe bënë gjithçka me iniciativën e tyre¹⁸².

I pandehuri Xhavit Elshani u bë anëtar i UCK-së në fund të muajit Korrik 1998 deri në fund të luftës në Qershor 1999. Ai shkoi në fshatin një kilometër larg fshatit të tij dhe u paraqit si vullnetar. Ai shkoi te shtëpia e njëfarë A [REDACTED] H [REDACTED]. Ai u pranua menjëherë në UCK.

¹⁷⁷ Ibid, faqe 25

¹⁷⁸ Ibid, faqe 17

¹⁷⁹ Shiko Procesverbalin e të pandehurit Agron Krasniqi, 19 Korrik 2006, faqe 6

¹⁸⁰ Ibid, faqe 5

¹⁸¹ Ibid, faqe 5

¹⁸² Ibid, faqe 10

Ai ishte ushtar nga Korriku deri në Tetor 1998 në fshatin Randobrave në Komunën e Prizrenit. Ai fshat është rreth 25-30 kilometra larg Dranovcit dhe Zatriqit dhe një kilometër nga fshati i tij Piran¹⁸³.

Gjatë periudhës Korrik deri Tetor 1998, ai nuk kishte lidhje apo marrdhënie me njësinë e UCK-së në Dranovc të Zatriqit. Ai nuk shkoi asnjëherë të vizitonte qytetin e Dranovcit gjatë asaj periudhe. Ai as nuk njihte njeri që ishte me UCK-në në Dranovc¹⁸⁴.

Detyra e tij ishte të mbronte njerëzit e tij nga forcat serbe. Ai dhe shokët e tij mbikëqyrnin territorin dhe ruanin njerëzit me qëllim që t'i mbronin ata nga Serbët dhe policia Serbe, sepse masakra të mëhershme kishin ndodhur në Rahovec në atë rajon¹⁸⁵.

I pandehuri Isuf Gashi u bashkua me UCK-në në 1996¹⁸⁶ dhe ishte ende anëtar i UCK-së gjatë periudhës Qershor-Tetor 1998¹⁸⁷. Si ushtar në UCK ai nuk i raportonte përditë UCK-së sepse nuk kishte "piramidë komanduese" në njësitin e tij¹⁸⁸. Në Prill 1998 kishte një njësit prej 20 burrash të armatosur dhe personi përgjegjës për atë njësit ishte M█████ Z█████. Ky njësit ndërmerre vetëm veprime kundër Serbëve për t'i parandaluar ata të hynin në fshatra dhe të bënin masakra siç kishin filluar të bënin. Detyra kryesore e njësitit ishte të mbronte fshatrat dhe fshatarët, por nuk arriti ta bënte këtë sepse nuk kishte fuqi¹⁸⁹.

Si ushtar, ai dhe shokët e tij mbronin qytetarët. Ata e bënin këtë duke ruajtur fshatrat dhe mbikëqyrur hyrjet dhe daljet e fshatrave. Pesë burra të armatosur bënin roje çdo ditë, ditë e natë. Ky proces filloi në 1989 dhe përfundoi në Qershor 1999. Kryetari i këshillit të fshatit i thoshte njerëzve, në grupe prej pesë vetash, që të ruanin gjatë natës me qëllim të parandalonin paraushtarakët të hynin në fshat¹⁹⁰.

Kur u pyet nëse gjatë periudhës Maj deri Korrik 1998 UCK-ja kishte uzurpuar godina në fshatin Dranovc, ai theksoi se nuk kishte parë ndonjë¹⁹¹.

Shtëpia e tij nuk është përdorur asnjëherë, as përkohësisht, për aktivitete të UCK-së¹⁹². Nuk ka pasur ndonjë shtab në shtëpinë e tij dhe ai hodhi poshtë dëshminë e dëshmitarit E█████ Rr█████ se shtëpia e tij shërbente si shtab i përgjithshëm për UCK-në¹⁹³. Ai gjithashtu shtoi se "Kuptimi im për termin "shtab i përgjithshëm" ka të bëjë me një ushtri të rregullt me uniforma me një komandant dhe kështu me radhë" dhe ai përfundoi duke përsëritur se nuk kishte ndonjë shtab të këtyllë¹⁹⁴.

¹⁸³ Shiko Procesverbalin e te pandehurit Xhavit Elshani, 28 Qershor 2006, faqe 11 dhe 12

¹⁸⁴ Ibid, faqe 12

¹⁸⁵ Ibid, faqe 12

¹⁸⁶ Shiko Procesverbalin e te pandehurit Isuf Gashi, 29 Qershor 2006, faqe 4

¹⁸⁷ Ibid, faqe 5

¹⁸⁸ Ibid, faqe 11

¹⁸⁹ Ibid, faqe 5

¹⁹⁰ Ibid, faqe 11

¹⁹¹ Ibid, faqe 9

¹⁹² Ibid faqe 9 dhe 10

¹⁹³ Ibid faqe 9 dhe 10

¹⁹⁴ Ibid faqe 11

Atij iu tregua se dëshmitarë që nuk ishin anëtarë të UCK-së kanë dhënë prova se UCK-ja kishte zaptuar dy godina në fshatin Dranovc në periudhën Maj-Tetor 1998; se anëtarët e UCK-së kanë dëshmuar se ka patur zyra të zëna nga UCK-ja në atë fshat, përmes të cilave UCK-ja kryente disa punë dhe se i pandehuri Selim Krasniqi ka deklaruar se Z. G. P. kishte një zyrë në atë fshat. Ai më pas u pyet nëse vazhdonte të ishte i mendimit se nuk dinte gjë për këto godina të zaptuara nga UCK-ja në Dranovc¹⁹⁵.

I pandehuri shpjegoi se “kishte përafërsisht tre ndërtesa publike apo sociale në fshatin tonë – më e vjetra ishte shkollë fillore e ngritur në 1935. Gjithashtu ishte edhe një hapësirë që quhej Zyra e Vendit, klinika për pacientë të jashtëm, dhe kooperativa bujqësore. Detyra ime kishte të bënte me furnizimet nga Prizreni, Gjakova ose Rahoveci¹⁹⁶”.

Ai shtoi se personat që do të bënin roje në fshat më vonë, u zhvendosën te kooperativa bujqësore në fshat dhe atje ata të gjithë kalonin ca kohë¹⁹⁷.

Kur u pyet nëse shkolla e vjetër e fshatit ishte okupuar nga UCK-ja ai dha këtë përgjigje: “Mendoj se për aq kohë sa kam qenë në paraburgim nuk kam qenë fort i informuar për këtë. Por pasi u lirova mësova se ka dokumentacion në shkollë. Ajo shkollë vazhdoi deri më 15 Qershor 1998 dhe këshilli i mësuesve ka vazhduar punën deri më 25 Qershor 1998. Kjo është gjithçka që mund të them sa i përket shkollës¹⁹⁸”. UCK-ja nuk e ka okupuar ndonjëherë shkollën¹⁹⁹.

Sipas dëshmitarit të mbrojtjes Dr. A. H., ai ka parë disa raste përditë, si njerëz të sëmurë, si dhe ushtarë të lënduar të UCK-së të cilët kishin marrë lëndime nga shpërthime apo armë zjarri²⁰⁰. Dëshmitari në fillim i ka përqendruar aktivitetet e tij në Gajrak dhe kryesisht ka mbuluar trekëndëshin Rahovec, Suharekë dhe Malishevë. Ata më vonë kanë lëvizur në fshatrat e tjerë si: Kervasari, Semetish, Breshanc, Pagarushë, Gurvar, Guncat, Klec, Divjakë, Krojmir, Shall, Petrovo Mallopolc, etj²⁰¹.

Ata gjithmonë ishin në lëvizje për të gjetur vende të qeta për pacientët sepse po mundoheshin të shmangnin sulmet Serbe dhe kishin dijeni të fuqive në disproporcion mes forcave. Kishte raste kur kishin mbi 100 pacientë që nuk kishin mundësi të ecnin. Ata ishin të detyruar në disa raste t'i lëviznin ata pacientë dhe t'i bartnin ata, dhe gjithë kjo bëhej brenda 24 orëve²⁰².

Ata lëviznin nga fshati në fshat për arsye sigurie. Ata qëndruan në Gajrak për gati dy muaj dhe kur menduan se ishin në rrezik lëvizën në fshatra të tjerë sepse rreziku ishte “i madh”. Fshati

¹⁹⁵ Ibid faqe 11 dhe 12

¹⁹⁶ Ibid faqe 12

¹⁹⁷ Ibid faqe 12

¹⁹⁸ Ibid faqe 12

¹⁹⁹ Ibid faqe 12

²⁰⁰ Shiko Procesverbalin e Dëshmitarit Dr A. H., 7 Qershor 2006, faqe 4

²⁰¹ Ibid faqe 6

²⁰² Shiko Procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes, Dr. A. H., 14 Qershor 2006, faqe 6

Gajrak është rreth një kilometër larg Malishevës në vijë ajrore. Forcat Serbe hynë në Malishevë kur dëshmitari ishte në Gajrak dhe ata vendosën të lëviznin në drejtim të kundërt²⁰³.

Dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtjes dhe akuzës, si dhe disa nga të pandehurit vetë, kanë përcaktuar qartë se gjatë shtatë muajve të parë të vitit 1998 ka patur një konflikt të gjatë dhe të fortë në territorin e Kosovës, që ka ndikuar lokalitetin e Dranovcit dhe fshatrat përreth. Gjatë hetimi, dëshmitarët U, D dhe P, i referohen ofensivës/bombardimeve të kryera nga forcat Serbe në fshatin Dranovc dhe zonën e Rahovecit mes Korrikut dhe Shtatorit 1998, duke e detyruar UCK-në që të tërhiqet pjesërisht prej andej. A H ka ishte doktor në spitalin e UCK-së për rajonin e Rahovecit dhe Malishevës, ka deklaruar para Gjykatësit Hetues se ka patur luftime në rajonin e Dranovcit në kohën relevante për aktakuzën. Islam Gashi pretendohet se është lënduar nga forcat Serbe në Maj 1998, ndërsa babai i tij Isuf Gashi, është lënduar prej tyre në mes të Korrikut 1998. Selim Krasniqi, Isuf Gashi dhe Islam Gashi, shprehimisht kanë pranuar në deklaratat e tyre gjatë fazës hetimore, se ka patur një konflikt të armatosur mes UCK-së dhe forcave Serbe në kohën kritike. Në 24 Maj 2004, Isuf Gashi ka deklaruar para Gjykatësit Hetimor se lufta ka filluar në 12 Maj 1998 në zonën e Rahovecit përmes një sulmi të nisur nga forcat Serbe. Ai specifikisht ka deklaruar se ka marrë pjesë, si ushtar i UCK-së, në luftimet kundër forcave Serbe që kanë ndodhur në 12,13 dhe 14 Maj dhe 18 Korrik 1998 në rajonin e tij. Në 16 Mars 2006 gjatë marrjes në pyetje të F H, Isuf Gashi sërish konfirmoi ekzistencën e një konflikti të armatosur në periudhën 18 Shkurt 1998 deri në fund të vitit 1998 (faqe 19-20). Në 8 Shkurt 2006 dhe gjatë Majit 2006, dëshmitari Muhamet Berisha ka folur për sulme (nga Serbët) në Rahovec dhe zonat përreth përpara se të vinte në Kosovë, dhe për luftime periodike para dhe pas periudhës kritike. Në 17 Maj 2006, gjatë marrjes në pyetje, dëshmitarët Z dhe TT kanë folur për sulme nga forcat Serbe në fshatrat e zonës, gjatë Qershorit – Korrikut 1998. Në 18 Maj 2006, dëshmitari D ka folur për beteja në Bellerka – Rahovec në Korrik 1998 mes Serbëve dhe UCK-së.

Dëshmitari i mbrojtjes K P deklaroi se në Maj 1998 situata ishte tepër e vështirë, jo vetëm në fshatin ku jetonte ai, por gjatë rrugës kryesore që lidhte dy qytetet e Xerxes dhe Rahovecit, por në të gjithë Kosovën. Në atë kohë, bashkë me shokë të tij nga ai fshat, për shkak të ngjarjeve që po ndodhnin në atë kohë në të gjithë Kosovën, ata organizonin mbledhje në shkollën e tyre për të vlerësuar situatën²⁰⁴.

Çdo mbrëmje grupi i tij i përbërë prej shtatë vetësh mblidhej në atë vend dhe diskutonin për situatën në atë kohë. Ata ndiqnin lëvizjet e trupave Serbe që atë kohë po rriteshin dita ditës, përfshi edhe trupat dhe veturat ushtarake²⁰⁵.

Njësitë policore serbe lëviznin lart e poshtë dhe shumë shpesh hynin në fshat për të kryer kontrole dhe verifikime. Njësitë policore serbe po rrisnin numrin e vizitave ditore në fshatin e tij dhe ata po furnizoheshin përditë me pajisje të sofistikuar ushtarake. Në 27 maj 1998, rreth orës 22:10 ose 22:20, dëshmitari dëgjoi të shtëna të larta dhe forta²⁰⁶. Vendi ku po ndodhnin të

²⁰³ Shiko Procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes, Dr. A H, 7 Qershor 2006, faqe 8 dhe 9

²⁰⁴ Shiko Procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes, K P, 2 Qershor 2006, faqe 3.

²⁰⁵ Ibid faqe 3 dhe 4

²⁰⁶ Ibid faqe 4

shtënat ishte mes fshatrave Bellacerkve dhe Xerxe, 500 apo 700 metra larg nga shtëpia e tij²⁰⁷. Tre veta u vranë atë natë dhe në kujtim të tyre është ngritur një përmendore²⁰⁸. Ai tha emrat e P██████ Th██████ dhe S██████ B██████²⁰⁹. Të shtënat zgjatën për rreth pesë minuta. Zhurma ishte e madhe dhe dëshmitari mundi të dallonte se disa armë po qëllonin në të njëjtin moment²¹⁰.

Popullata është keqtrajtuar dhe rrahur nga trupat serbe. Popullata nuk është lejuar të lëvizë lirshëm. Zakonisht pas orës 19:00 njerëzit kishin frikë të lëviznin rrugëve, edhe brenda përbrenda fshatit²¹¹.

Dëshmitari dhe bashkëfshatarët e tij morrin “masa mbrojtëse” për të ruajtur fshatin. Ata u munduan të evakuonin popullatën civile nga fshati në momentin që trupat serbe do të sulmonin fshatin. Ata gjithashtu caktuan disa vrojtues rreth fshatit. Ata vrojtonin trupat Serbe dhe lëvizjet e tyre rreth fshatit. Ata donin të ishin vigjilentë dhe të shmangnin t’i kapnin në befasi²¹².

Ata nuk kishin armë dhe trupat serbe mund të hynin dhe dilnin nga fshati kryesisht gjatë ditë, dhe nganjëherë natën²¹³.

Shumë njerëz nga fshati i dëshmitarit dhe fshatra përreth u zhdukën dhe u vranë gjatë luftës. Rreth 70 persona nga fshati i tij janë vranë, përfshi edhe fëmijë dhe gra²¹⁴.

Mbi 80 veta janë vranë në fshatin Celinë; mbi 200 veta janë vranë dhe mbi 100 veta janë zhdukur nga fshati Krushë e Madhe; mbi 100 veta janë vranë nga fshati Pastasel; rreth 100 apo 200 nga Rahoveci; rreth 40 nga fshati Reti; mbi 50 nga fshati Brestovc dhe nga Hoqe e Vogël dhe Nagevc²¹⁵. Trupat serbe hynë në këto fshatra në periudhën Maj-Korrik 1998²¹⁶. Fshati i dëshmitarit ishte i vetmi që u sulmua²¹⁷. Të gjithë fshatrat që ai përmendi janë pranë njëri tjetrit. Në fshatin e tij më 18 Korrik 1998 u vranë gjashtë veta. Më pas në Rahovec të nesërmen u vranë rreth 100 veta. Ai nuk kishte ndonjë kujtim të veçantë lidhur me vrasjet që ndodhën në këtë kohë. Nganjëherë një, dy apo tre persona vriteshin²¹⁸.

Me sa mbante mend ai vrasjet e para ndodhën në 12 Maj 1998 në Gradisht. Mes trupave serbe dhe UCK-së po bëheshin luftime. Ai kishte dëgjuar se njerëzit ishin vranë atje. Ai mendon se

²⁰⁷ Ibid faqe 6

²⁰⁸ Ibid faqe 6

²⁰⁹ Ibid faqe 9

²¹⁰ Ibid faqe 9

²¹¹ Ibid faqe 5

²¹² Ibid faqe 5

²¹³ Ibid faqe 5

²¹⁴ Ibid faqe 6

²¹⁵ Ibid faqe 7

²¹⁶ Ibid faqe 7

²¹⁷

²¹⁸

njerëzit nga zonat përreth mund të ishin vrarë gjithashtu²¹⁹. Situata u përkeqësua me 27 majit dhe 18 korrikut 1998²²⁰.

Nuk ka patur incidente sporadike apo incidente në shkallë të gjerë ku përfshiheshin serbët dhe UCK-ja apo vetëm serbët nëpër fshatra²²¹.

Përpara se dëshmitari t'i përgjigjej një pyetje nëse ka patur rezistencë të organizuar, avokati mbrojtës lexoi çfarë dëshmitari i kishte thënë Gjykatësit Hetues "Deri në 18 Korrik kur ndodhi ofensiva serbe dhe ne duhej të iknim nga fshati, të gjithë duhet të mendonim për çështje serioze"²²².

Mes fillimit të Marsit dhe 18 Korrikut 1998 kur fshati i tij u sulmua, nuk kishte ndonjë njësit të UCK-së të stacionuar atje, por kishte një farë bashkëpunimi me UCK-në. Në 18 korrik kur ndodhi sulmi, njësitet e UCK-së erdhën për t'i ndihmuar ata bashkë me fshatarët²²³.

Në 27 maj 1998, njësitë më afër të UCK-së ishte i stacionuar në Dranovc. Dëshmitari shtoi se ai nuk e kishte idenë nëse kishte ndonjë njësit tjetër më afër se ai i Dranovcit²²⁴.

Pas incidentit të 27 Majit 1998, gjatë të cilit u lëndua Islam Gashi, pati një ofensivë serbe që rezultoi me shumë të plagosur në fshat. Popullata reagoi ndaj kësaj duke u bashkuar me UCK-në atë ditë me qëllim që të mbronin qytetin e Rahovecit sepse trupat serbe po afroheshin në Prizren. Më pas Serbët e thyen mbrojtjen e fshatit dhe fshatarët u larguan. Ata që u kanë nga serbët u ekzekutuan. Shtëpitë u dogjën. Fshatarët u larguan për të fshatrat përreth, nëpër lugina dhe male²²⁵.

Shumë prej atyre që u bashkuan me UCK-në ndihmuar në hapjen e traseve dhe gjetjen e furnizimeve. Sipas dëshmitarit disa mund të kenë marrë pjesë "në mënyrë më të drejtpërdrejtë" në UCK, por fshatarët vetëm kanë ofruar ndihmë²²⁶. Në 18 Korrik ka patur luftime dhe fshatarët ndihmuar UCK-në me qëllim që të ndalonin serbët të mos shkonin në Rahovec, por serbët arritën të thyenin mbrojtjen e fshatarëve²²⁷.

Dëshmitari i mbrojtjes M. J. dëshmoi se luftëtarët e UCK-së që po ktheheshin në Kosovë nga Shqipëria bartnin me vete të paktën 45 armë ose municion. Kjo ishte mënyra kryesore e sjelljes së armëve dhe municioneve për luftëtarët në Kosovë²²⁸. Në 7 Korrik 1998, pati një ofensivë të madhe të forcave serbe rreth fshatit Vrrë dhe kur përfundoi ofensiva,

²¹⁹ Ibid faqe 8

²²⁰ Ibid faqe 8

²²¹ Ibid faqe 8

²²² Ibid faqe 7

²²³ Ibid faqe 8

²²⁴ Ibid faqe 8 dhe 9

²²⁵ Ibid faqe 14

²²⁶ Ibid faqe 15

²²⁷ Ibid faqe 16

²²⁸ Shiko procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes M. J. 14 Qershor 2006, faqe 33

dëshmitari shkoi në atë fshat. Ai gjithashtu shkoi tek pikat e vrojtimit të ngritura në UCK-ja në atë vend²²⁹.

Dëshmitari qëndroi dy ditë të tjera te kufiri sepse forcat serbe po e vrojtonin rëndshëm kufirin. Ai donte të hynte në mënyrë të sigurt në Kosovë dhe nuk ishte e mundur për të dhe shokët e tij të kalonte përmes pikave ku ishin serbët²³⁰.

Atij iu tha se prej Marsit deri në Gusht 1998, ka patur një sërë sulmesh në fshatrat shqiptare dhe iu bë pyetja nëse e dinte nëse konflikti u zgjerua apo zvogëlua gjatë asaj kohe. Dëshmitari u përgjigj se ai nuk mund ta quante atë një konflikt dhe kur iu bë pyetja në të njëjtin kontekst nëse lufta u intensifikua, ai u përgjigj pozitivisht²³¹.

Nga Maji deri në gusht 1998, UCK-ja nuk ishte “saktësisht e organizuar”. Ishte një organizim i vogël, një grup për secilin fshat. UCK-ja filloi të ishte më specifikisht e organizuar nga muaji Shtator 1998²³². Kur dëshmitari u pyet të që ishte më i qartë me termin “specifikisht e organizuar”, ai shpjegoi se “pas organizimit të grupeve të vogla në bazat e fshatrave, ne filluam t’i organizonim ato me qëllim që të ishim nën të njëjtën komandë si të unifikuar dhe përgjegjës për atë komandë. Ky ishte dhe interesi i UCK-së – të ishte e mirë-organizuar. Ky organizim nuk ndodhi shpejt, duke marrë parasysh rrethanat në atë kohë për shkak të presionit të shkaktuar nga ofensiva e ushtrisë serbe mbi ne. Shpirti i organizimit përfundoi nga mesi i Shtatorit 1998, por nuk jam i sigurt për datën e saktë kur përfundoi”²³³. UCK-ja nuk ishte e organizuar në mënyrë hierarkike. Njësitë ishin të atilla që komandanti i secilit njësit i perkiste atij në nivel fshati²³⁴. Dëshmitari nuk mbante mend nëse Jakup Krasniqi ishte caktuar zëdhënës i UCK-së gjatë verës 1998²³⁵.

Ai nuk kishte dijeni nëse UCK-ja kishte lëshuar komunikata në emër të shtabit të përgjithshëm të UCK-së gjatë periudhës Maj-Gusht 1998, dhe shpjegoi padijen e tij duke thënë “Unë nuk kisha ndonjë pozitë në UCK gjatë kësaj periudhe që përmendni ju dhe nuk kam informata të mjaftueshme sa i përket këtij fakti”²³⁶”. Kur iu tha se ai kishte deklaruar se në Shtator 1998 ishte vendosur një farë hierarkie, por se në fakt kjo kishte ekzistuar që më herët, me komunikatat e lëshuara në Maj dhe Gusht 1998, dëshmitari tha se ai nuk mund të komentonte këtë²³⁷”.

Ai vizitoi disa pika të vendosura në fshatin Vrri, në komunën e Prizrenit, dhe atje kishte grupe të vogla të organizuara ku edhe vetë ushtarët e UCK-së nuk kishin dijeni për njëri-tjetrin. Nuk kishte ndonjë zonë që ishte nën kontrollin e UCK-së²³⁸. Njësitet e mbrojtjes së UCK-së ishin të

²²⁹ Ibid faqe 35

²³⁰ Ibid faqe 34

²³¹ Ibid faqe 40

²³² Ibid faqe 35

²³³ Ibid faqe 35 dhe 36

²³⁴ Ibid faqe 36

²³⁵ Ibid faqe 38

²³⁶ Ibid faqe 39

²³⁷ Ibid faqe 39

²³⁸ Ibid faqe 39

organizuara në nivel fshati dhe nuk kishte ndonjë seli qendrore në atë kohë për ato njësite. Secili njësit ishte përgjegjës për gjetjen e armëve të veta²³⁹.

Dëshmitari mbrojtës N [REDACTED] M [REDACTED] deklaroi se ai ishte bashkuar me UCK-në pas Shtatorit 1998 dhe ka shërbyer si ushtar në fshatin Reti²⁴⁰. Ai u bashkua me UCK-në pasi u zhduk mamaja e tij²⁴¹. Gjatë ofensivës së Rahovecit kur u deportuan fshatarët prej atje, ai me familjen e tij u vendos në Krushë të Madhe. Kjo ndodhi pasi forcat serbe dogjën 30 shtëpi të lagjes së tij. Ata vranë njëzetepesë veta²⁴². Ai nuk njihte njeri që ishte në UCK në zonën e Dranovcit në periudhën Qershor-Korrik 1998²⁴³. Kur ai shkoi të regjistrohej në UCK, iu tha që të priste një muaj dhe pastaj u regjistrua në Shtator²⁴⁴.

Ai e dinte se kishte një zonë të lirë në Malishevë në Qershor/Korrik 1998²⁴⁵.

Pyetjes së avokatit mbrojtës Fatmir Celina “A mund të na thoni cilat ishin grupet paramilitare serbe që operonin në Rahovec gjatë kohës që ndodhi ajo masakër?”, dëshmitari dha këtë pyetje “Kam dëgjuar për një grup të quajtur ‘dora e zezë’, grupin e Luanëve, dhe një grup tjetër të përbërë nga fshatarët serbë, policia ushtarake dhe forcat paramilitare të serbëve të quajtur Hoca e Madhe. Ne ishim shumë të frikësuar nga këto grupe. Këto grupe mbështeteshin nga njësitet policore serbe që vinin nga Nishi, Vranje, si dhe një njësit i përbërë nga 12 ushtarë paramilitarë rusë²⁴⁶”.

Dëshmitari i mbrojtjes R [REDACTED] L [REDACTED] deklaroi se në Gjermani ai dhe Selim Krasniqi “kanë punuar për të asistuar dhe ndihmuar organizimin e luftës në Kosovë”²⁴⁷. Në Kosovë ka patur shumë vullnetarë për të luftuar por nuk kishte municione të mjaftueshme²⁴⁸. Gjatë kohës që ishte në Shqipëri ai kishte takuar shumicën e njerëzve që vinin në Tiranë dhe shkonin në grupe në Kosovë me armë për të luftuar²⁴⁹. Në Mars 1998 në Shqipëri, si përfaqësues të UCK-së, dëshmitari dhe shokë të tij u munduar të mbledhnin armë nga qytetarët dhe i blinin ato me qëllim që t’i çonin në Kosovë. Ata arritën të merrnin shumë armë për t’i sjellë në Kosovë²⁵⁰. Në Maj, Qershor, dhe Korrik, rreth 10,000 vullnetarë erdhën në Kosovë nga Evropa Perëndimore përmes Shqipërisë me armë²⁵¹. Në një farë mënyre, kishte një furnizim të rregull me armë që hynte në Kosovë nga Shqipëria dhe UCK-ja po organizonte shpërndarjen²⁵².

²³⁹ Ibid faqe 40

²⁴⁰ Shiko procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes N [REDACTED] M [REDACTED] 8 qershor 2006, faqe 3

²⁴¹ Ibid faqe 6

²⁴² Ibid faqe 7

²⁴³ Ibid faqe 6

²⁴⁴ Ibid faqe 7

²⁴⁵ Ibid faqe 6

²⁴⁶ Ibid faqe 8

²⁴⁷ Shiko procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes R [REDACTED] L [REDACTED], 7 qershor 2006, faqe 29

²⁴⁸ Ibid faqe 29

²⁴⁹ Ibid faqe 30 dhe 31

²⁵⁰ Ibid faqe 31

²⁵¹ Ibid faqe 31

²⁵² Ibid faqe 31

Dëshmitari tha se kura i takohet me Selim Krasniqin “ne flisnim për familjet tona, luftën në Kosovë, organizimin e luftës dhe gjëra të këtilla. Dhe gjithashtu flisnim shumë se si të bindnim dhe mbushnim mendjen faktorit ndërkombëtar që të na ndihmonte në luftën tonë të pastër. Selim Krasniqi shpesh përmendte se megjithëse kishte shumë njerëz që dolën vullnetarë për të ardhur nga vendet perëndimore për të luftuar, kishte probleme me çështje të organizimit dhe shumë faktorë të rëndësishëm që duhen mbuluar gjatë luftës²⁵³.

Dëshmitari i mbrojtjes D [REDACTED] K [REDACTED] ka dëshmuar se në Qershor 1998, para dhe pas ditës kur Agron Krasniqi u kthye në Denje, ai vuri re njësitë të UCK-së në fshatin e tij. Kishte një njësitë prej 30 apo 40 personash në fshatin e tij që ishin organizuar për të mbrojtur fshatin²⁵⁴. Kur u pyet të shpjegonte se çfarë donte të thoshte me “organizim” dëshmitari theksoi “është e thjeshtë të kuptosh kuptimin e fjalës “mobilizim” kur bëhet fjalë për organizimin e njerëzve gjatë luftës, por ne ishim të okupuar, kështu që unë përdor fjalën që organizimi ynë i brendshëm, ishte i mobilizuar, për të luftuar në luftë²⁵⁵”. Ky ishte ai lloj organizimi i formuar me qëllim vrojtimin nëse forcat serbe vinin drejt fshatit. Ishte për vetëmbrojtje të brendshme²⁵⁶. Vetëm tre persona që ishin mobilizuar kishin armë sepse ishte e vështirë të gjeje armë. Ata mbanin një armë të tipit Kallashnikov AK47, një armë me tytë të gjatë, M48, dhe një pushkë gjuetie. Asnjë nuk kishte uniformë²⁵⁷.

UCK-ja u shfaq për herë të parë në fshatin Dranovc në 26 Prill 1998. Meqë Dranovci ishte rreth 10-12 kilometra prej fshatit të tij, në 12 Maj 1998 ata ngritën një njësitë për të mbrojtur fshatin e tyre dhe dëshmitari u bashkua me atë njësitë që atë ditë²⁵⁸. Kur u pyet nëse ai njësitë ishte pjesë e UCK-së dëshmitari theksoi “ishte një farë bashkimi, jo një njësitë i kompletuar, ne nuk kishim armë” dhe shtoi kur pyet sërish se “për të formuar një njësitë ekzistojnë disa kërkesa specifike, dy apo tre armë nuk mund të formojnë një njësitë²⁵⁹”. Ai vazhdoi duke thënë se “ekzistonte dëshira, vullneti, për të çliruar kombin dhe ne na u duk e nevojshme për atë kohë²⁶⁰”. Dëshmitari shpjegoi se njësitë i UCK-së në Dranovc nuk kishte lidhje me njësitin në fshatin e tij, Drenjë²⁶¹. Njësitë i tij kishte kontakt me njësitin e Ratkovcit. Ai nuk mund të mbante mend nëse ndonjë anëtar i UCK-së nga Dranovci kishte shkuar ndonjëherë në fshatin e tij²⁶².

Në 1998 Agron Krasniqi dhe dëshmitari ishin ushtarë të thjeshtë dhe nuk ju ishte caktuar ndonjë detyrë e veçantë. Ata ishin njerëz të thjeshtë nga fshati që ishin mobilizuar, dhe ata nuk kishin ndonjë instruktor që tu jepte detyra. Ata ruanin fshatin me turne. Kjo ishte detyra e tyre

²⁵³ Ibid faqe 32

²⁵⁴ Shiko procesverbalin e dëshmitarit të mbrojtjes D [REDACTED] K [REDACTED], 14 qershor 2006, faqe 8

²⁵⁵ Ibid faqe 8

²⁵⁶ Ibid faqe 8

²⁵⁷ Ibid faqe 8

²⁵⁸ Ibid faqe 16

²⁵⁹ Ibid faqe 17

²⁶⁰ Ibid faqe 17

²⁶¹ Ibid faqe 19

²⁶² Ibid faqe 20

kryesore²⁶³. Ata nuk kishin një hierarki ushtarake dhe ruanin kontakte me fshatin Dranovc dhe me një Smajl Latifi²⁶⁴.

Në Maj 1998, serbët nisën sulme duke përdorur trupa, helikopterë dhe tanke. Represioni ushtarak këmbësor po rritej përditë dhe një civil u vra në Ratkovc²⁶⁵.

Në fund të qershorit 1998 pati ca luftime të lehta dhe përleshje mes forcave dhe UCK-së në fshatin Dejne²⁶⁶. Fshati i tij u bombardua dy herë, në qershor dhe korrik 1998, dhe në 4 korrik 1998 është bombarduar rëndshëm²⁶⁷. Agron Krasniqi ishte pjesë e njësitit në Denje dhe si dëshmitari ashtu edhe Agron Krasniqi u bashkuan “me luftën, me UCK-në”²⁶⁸.

Në 4 shtator 1998, fshati i tij u sulmua nga serbët dhe u vranë tetë veta dhe rreth 57 apo 60 të tjerë u plagosën. Ata ishin të gjithë civilë. Që të 200 shtëpitë në fshat u dogjën, me përjashtim të gati 10 shtëpive²⁶⁹. Dëshmitari pa tanket serbe të bombardonin fshatin²⁷⁰. Fshatarët u fshehën nëpër pyje dhe male, dhe dëshmitari që bashkë me të tjerët ishte i armatosur, po mendohej të kontrollonte popullatën civile²⁷¹. Pas 5 Shtatorit 1998, ata të gjithë u kthyen, por fshati ishte djegur tërësisht²⁷². Shumë fshatarë ishin rrëmbyer dhe burgosur²⁷³.

Gjithashtu, ekzistojnë një sërë burimesh të hapura dhe materiale të tjera, përfshi edhe Rezolutat e KS OKB, dokumentet, Ligjet Vendore dhe Ndërkombëtare dhe raporte që përdoren si referencë dhe janë pranuar në prova në gjykime vendore dhe ndërkombëtare për krime lufte, gjë që paraqet në mënyrë të qartë natyrën e zgjatur dhe të thellë të konfliktit të armatosur në territorin e Kosovës, përfshi edhe Dranovcin.

Dokumentet dhe raportet e shumta që janë parashtruar gjykatës, tregojnë qartë se UCK-ja po rritej dhe zhvillohej vazhdimisht ne nivel territorial.

Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1998) e datës 23 Shtator 1998, përfshin këtë deklaratë:

“Duhet vënë në dukje më tej komunikata që Prokurori i Gjykatës Ndërkombëtare për Ish-Jugosllavi i ka drejtuar Grupit të Kontaktit më 7 Korrik 1998 duke u shprehur se situatë në Kosovë pasqyron një konflikt të armatosur në kuadër të kushteve të mandatit të gjykatës.”

²⁶³ Ibid faqe 26

²⁶⁴ Ibid faqe 26

²⁶⁵ Ibid faqe 30

²⁶⁶ Ibid faqe 8

²⁶⁷ Ibid faqe 9

²⁶⁸ Ibid faqe 15

²⁶⁹ Ibid faqe 11

²⁷⁰ Ibid faqe 13

²⁷¹ Ibid faqe 12

²⁷² Ibid faqe 13

²⁷³ Ibid faqe 13

Është tejet shqetësuar luftimi intensiv i kohëve të fundit në Kosovë dhe në veçanti përdorimi i forcës së tepruar dhe pa dallim nga forcat e sigurimit serb dhe ushtria jugosllave, që kanë rezultuar në viktima të shumta në civilë dhe, sipas përlllogaritjeve të Sekretarit të Përgjithshëm, në zhvendosjen e mbi 230,000 personave nga shtëpitë e tyre”.

Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm, i përgatitur në bazë të Rezolutës 1160 (1998), e datës 4 Shtator 1998.

“III. Situata në Kosovë.

6. Përpjekje të vazhdueshme ndërkombëtare për të ndihmuar në zgjidhjen politike n ndaj krizës në Kosovë kanë patur rezultate të kufizuara. Sipas njohurive të Këshillit të Sigurimit, situata në Kosovë mbetet e paqëndrueshme. Ne mes të Korrikut dhe fillim të Gushtit ka patur luftime të shumta në qytetet e Rahovecit dhe Malishevës, si dhe zonat e Suharekës dhe Shtimes. Në mes të Gushtit, luftime të egra kishin nisur me furi në pjesën perëndimore të Gjakovës, Deçanit dhe Pejës. Nga fundi i Gushtit, luftimet vazhduan në disa zona: përdim të Pejës në zonën e Rugovës, përgjatë rrugës Shtimje-Suharekë, në pjesën Komorane-Kijevo të rrugës Prishtinë-Pejë, dhe afër aeroportit të Prishtinës. Megjithëse shkalla e luftimeve mes forcave të mbrojtjes së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UCK) është zvogëluar, dhe Qeveria ka deklaruar se jeta po kthehet në normalitet, është e dukshme se konflikti vazhdon dhe çdo parashikim i përfundimit të tij do të ishte i parakohshëm. Procesi i negociatave nuk është përtërirë dhe tensionuar përgjatë kufirit mes Republikës Federale Jugosllave dhe Shqipërisë janë të dukshme.

Shqetësimi humanitar

7. Rreth 600 deri 700 civilë janë vrarë në luftimet në Kosovë që prej Marsit. Konflikti ka rezultuar në rreth 230,000 persona të zhvendosur sipas llogaritjeve kumulative”.

Raporti i OSBE-së²⁷⁴ thekson “Në fillim të vitit 1998, natyra e situatës në Kosovë ka ndryshuar. Një element i ri ka hyrë në ekuacion në formën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UCK) dhe autoritetet serbe po kundërpërgjigjen me rritje të thellë të forcave ushtarake.” I njëjti pasazh vazhdon kështu më tutje “Autoritetet serbe kanë sjellë forca special të mbrojtjes në Janar 1998. Ata i janë kundërpërgjigjur konfliktit me UCK-në me sulme ndëshkuese nëpër fshatra, duke shfrytëzuar helikopterë ushtarakë dhe vetura të blinduara, së bashku me bastisje brutale në çdo shtëpi dhe arrestime pa dallim. Dy sulme të këtilla në fshatra në fund të Shkurtit u pasuan nga një sulm mbi fshatin Prekaz i Poshtëm (Komuna e Skenderajt) në fillim të Marsit, ku të paktën 54 veta janë vrarë, përfshi edhe një lider lokal i UCK-së, shumë nga familja e tij, dhe gra, fëmijë dhe burra të moshuar. Reprezaljet vazhduan me sulme të tjera në fshatra në rajonin e Drenicës, duke i detyruar shumë nga fshatarët të arratisen nga shtëpitë e tyre. Në këtë spirale në tatëpjetë dhune, shumë nga shqiptarët e Kosovës, përfshi edhe mbështetësit e flaktë të LDK-së me qëndrim kundra dhunës, u bënë anëtarë të UCK-së ose simpatizantë aktivë”. I njëjti paragraf thekson më tej se “të tjera përforcime ushtarake serbe në numër të konsiderueshëm u dërguan në Kosovë në Maj 1998” dhe se “një paralajmërim i fortë i fundit”

²⁷⁴ “Kosova e perjetuar, e treguar”, pjesa 1, kapitulli 1, faqe 30

nga qeveritë Evropiane në Qershor është injoruar ndërkohë që forcat serbe u përqendruan në rajonin e Drenicës dhe përgjatë kufirit jugperëndimor, duke përdorur artileri për të detyruar fshatarët të largohen nga shtëpitë e tyre dhe më pas për t'i bastisur dhe djegur ato.

Raporti i Vrojtuesit të të Drejtave të Njeriut në 1999 “Një fshat i shkatërruar” i referohet ekzistencës së UÇK-së që në fillim të 1998 – “**që nga prilli deri në mes të korrikut 1998** UÇK-ja pothuajse ka patur rreth 40% të territorit të Kosovës, megjithëse pjesa më e madhe e këtij territori është rimarrë nga forcat qeveritare në Gusht 1998. Deri atëherë, gjithsesi, UÇK-ja ka patur një numër të caktuar të qyteteve dhe fshatrave strategjike, dhe ka plotësuar me ekuipazh pikat e kontrollit përgjatë disa nga rrugëve kryesore të Kosovës; në Shtator 1998 zona e tyre e kontrollit ishte zvogëluar në disa pjesë të Drenicës dhe disa xhepa të shpërndarë në perëndim, sidomos natën”.

Raporti i përgatitur për Prokurorin e GjNPJ²⁷⁵ ofron të dhëna të detajuara për UÇK-në, si një grup i armatosur i organizuar e i angazhuar në zgjatjen e dhunës së armatosur. Raporti deklaroi se “Nga fundi i 1997, megjithatë, ajo (UÇK-ja) po demonstronte aftësitë e saja për të bërë operacione të organizuara në një zonë të gjërë, që tregonte lindjen e një strukture organizative të shkallës së lartë, ...”, dhe tregonte se numuri i UÇK ishte rritur në mijra për kah vera e 1998-tës. Më pas ky raport deklaroi se “Para ofensivës Serbe/RFJ në fund të Korrikut 1998, UÇK-ja kontrollonte rajone të rëndësishme të Kosovës, prej zonës së Drenicës në jug të Malishevës.” Ndërsa raporti e bën të qartë se UÇK nuk ishte plotësisht e bashkuar dhe kohë pas kohe e ardhmja e saj luhatej, u theksua me të drejtë se niveli dhe zgjatja e dhunës së përshkruar “e tejkalonte shumë sulmet sporadike karakteristike të një trazire civile.”

GjNPJ pasi shqyrtoj në gjerësi çështjet e Organizimit të UÇK-së, Intensitetin e Konfliktit, Duke vepruar nën Drejtimin e Autoriteteve të Njohura Civile, dhe Kontrollin mbi Territorin mbriti në përfundimin se para 24 Marsit 1999 “ka patur prova të mjaftueshme të një konflikti të armatosur në Kosovë...²⁷⁶”.

Në çështjen ndaj Fatmir Limajt, GjNPJ pas shqyrtimit në gjerësi të çështjeve të organizimit të UÇK-së, Intensitetin e konfliktit, mbriti në përfundimin se “...**para fundit të Majit 1998** ekzistonte një konflikt i armatosur në Kosovë midis Forcave Serbe dhe UÇK-së...Komandantët e njësisive jipnin Urdhëra luftime dhe njësitë nën varësi si dhe ushtaratë në përgjithësi vepronin në përputhje me këto urdhëra. Hapa ishin ndërmarë për të futur rregulla disiplinore dhe Policinë Ushtarake.... Prej Korrikut 1998, UÇK-ja e kishte fituar pranimin si një pjestarës i pranushëm dhe i vlefshëm në bisedimet me qeveritë e huaja dhe organizmat e huaja... Më tej, nga fundi i Majit 1998, njësitë e UÇK-së ishin të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme në përplasje të armatosura me forcat kryesore Serbe... Aftësija e UÇK-së për tu angazhuar në këto operacione të variueshme ishte një indikator i mëtëjshëm i nivelit të saj të organizimit. Nisur nga sa më sipër, Dhoma bindet dhe është e mendimit se një konflikt i brëndshëm i armatosur

²⁷⁵ Raport mbi Shkeljet e Rënda të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar në Kosovë më 1998, Shkurt 1999, faqe 15-19.

²⁷⁶ Milosevic, Dhoma Gjyqësore e GjNPJ, Vendimi mbi Mocionin për Gjykimin e Lirimit nga akuzat, Aktvendim, 16 Qershor 2004, Çështja no. IT-02-54-T, paragrafet 14-40.

ekzistonte në Kosovë para fundit të Majit 1998. Kjo ka vazhduar shumë gjatë pas 26 Korrikut 1998.²⁷⁷”

Ekzistenca e një konflikti të armatosur në Kosovë para bombardimeve të NATO-s është njohur gjithashtu në disa raste nga Gjykatat në Kosovë²⁷⁸.

Rregullorja Ushtarake e UÇK-së e titulluar “Rregullorja e Përkohëshme mbi Organizimin e Jetës Ushtarake” i datës 1998 përmban dispozita eksplicite, që kanë për qëllim të garantojnë atë se urdhërat duhet që të zbatohen sipas rendit hierarkik²⁷⁹.

Raporti i lëshuar prej Zyrës së Prokurorit të GjNPJ titullohet “Konflikti i Armatosur në Kosovë 1998” i datës 2 Gusht 2004, i cili përforcon raportet prej burimeve Sërbe. Burimeve të UÇK-së, Raportet e Monitorëve të Misionit të Komunitetit Europjan si dhe burimeve të Përziera, për të ofruar dhe analizuar natyrën e Konfliktit të Armatosur në Kosovë **midis Janarit 1998 dhe Shtatorit 1998**. Në këtë raport është deklaruar se “Konfrontimi i armatosur në Kosovë më 1998 ndodhi midis UÇK dhe forcave Sërbe...Konfrontimi i armatosur u zgjerua pas mesit të Majit 1998. Nga të dy palët janë përfshirë armë të rënda sikundër mortajet dhe artilerija (Përmbledhja ekzekutive P1)...Konflikti i armatosur tashmë i zgjeruar nga fillimi i Korrikut u intensifikua... Komunikatat e UÇK-së dhe proces-verbalet e Komandës së Bashkuar tregojnë dy anët e kundërta të vëna përballë njëra tjetrës në operacione luftarake të vazhdueshme (Paragrafi 47)...Bazuar në informacionet vlersohet se operacionet luftarake u zhvilluan në një bazë të gjërë në Kosovë. (Para 48)²⁸⁰.

Fragment nga Komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të lëshuara gjatë periudhës që evidentojnë intensitetin e konfliktit dhe natyrën e organizuar të UÇK-së, duke përfshirë si në vijim²⁸¹:

| Data | Burimi – Shtabi Qëndror i UÇK | Përmbledhje |
|----------|-------------------------------|---|
| 28/02/98 | Komunikata No. 42 | <i>Thekson se UÇK ka bërë sulme kundër forcave Sërbe dhe ka “likuiduar” bashkëpunorët në Janar/Shkurt 1998.</i> |

²⁷⁷ Fatmir Limaj e të tjerë, Aktgjykimi i Gjykitit të GjNPJ, 30 Nëntor 2005, Çështja no. IT-03-66-T, paragrafet 171-173.

²⁷⁸ Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në rastin kundër Miroslav Vuckovic, i datës 25 Tetor 2002 (faqe 38 deri 44), dhe vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në këtë çështje të datës 15 Korrik 2004 (faqe 20 dhe 21); Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës në Prokurorin ndaj Veselin Besovic ta datës 26 Qershor 2003; Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në çështjen e Prokurorit ndaj Latif Gashit e të tjerë, i datës 16 Korrik 2003 (faqe 10 deri në 13), dhe vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në këtë çështje të datës 21 Korrik 2005 (faqe 9 deri në 11).

²⁷⁹ Dokumenti 00000445-00000461 sikurse është ofruar ai nga Zyra e Prokurorit të GjNPJ.

²⁸⁰ Dokumenti 00083185-00083219 sikurse është ofruar ai nga Zyra e Prokurorit të GjNPJ.

²⁸¹ Dokumenti U0038560, U0038566, U0038573, U0038593, U0038577 dhe U0079688 sikurse ato janë ofruar prej Zyrës së Prokurorit të GjNPJ – Këtyre komunikatave u është referuar Raporti i lëshuar prej Zyrës së Prokurorit të GjNPJ të titulluar “Konflikti i Armatosur në Kosovë 1998” i datës 2 Gusht.

| | | |
|----------|---|---|
| 11/03/98 | Komunikata No. 45 | <i>Përshkruan përplasjet e armatosura me forcat Sërbe në zonat e Drenicës dhe të Llapit në një front të gjërë.</i> |
| 13/05/98 | Komunikata No. 47 | <i>Përmënd që në bazë të urdhërave të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, janë zhvilluar operacione në nënzonat e Drenicës...Pashtrikut...16 anëtarë të UÇK-së janë vrarë...Po ashtu i referohet Shërbimit të Inteligjencës së UÇK-së dhe zhvillimit të operacioneve në vijim e sipër.</i> |
| 19/06/98 | Komunikata 19/06/98 | <i>UÇK-ja deklaroi se do të organizojë një mobilizim të përgjithshëm dhe do të përgatitet për një përballje vendimtare me Sërbinë.</i> |
| 13/07/98 | Komunikata No. 49 | <i>Përshkruan zgjerimin e Operacioneve gjithandej Kosovës kundër forcave Sërbe.</i> |
| 29/08/98 | Komunikatë prej Shtabit të Përgjithshëm | <i>Pretendon se UÇK-ja po zhvillon operacione "njëri pas tjetrit" kundër trupave pushtuese Sërbe në Kosovë.</i> |

Përfundim mbi çështjen e konfliktit të armatosur

Dëshmitë prej të dyve, prokurorit dhe të pandehurve, po ashtu edhe prej vetë disa dëshmitarëve të mbrojtjes tregojnë se ka patur një konflikt të armatosur që zhvillohej. Gjatë hetimeve, Dëshmitarët U, D dhe P u referohen ofensivave/bombardimeve të bëra prej forcave Sërbe në fshatin Drenovc dhe në zonën e Rahovecit dhe rajonin e Malishevës, duke i deklaruar Gjykatësit hetues se ka patur luftime në rajonin e Drenovcit në kohën relevante për Aktakuzën. Islam Gashi supozohet që të jetë plagosur nga forcat Sërbe në Maj 1998, ndërsa babai i tij Isuf Gashi është plagosur gjithashtu prej tyre në mesin e Qarshorit 1998. Selim Krasniqi, Isuf Gashi

dhe Islam Gashi pranuan në mënyrë eksplicite në deklaratat e tyre gjatë hetimit, ekzistencën e një konflikti të armatosur midis UÇK-së dhe forcave Sërbe në kohën kritike. Më 24 Maj 2004, Isuf Gashi i deklaroi Gjykatësit hetues se lufta filloi më 12 Maj 1998 në zonën e Rahovecit prej një sulmi të bërë nga forcat Sërbe. Ai specifikisht deklaroi se ka marrë pjesë si një ushtar i UÇK-së në luftimet kundër forcave Sërbe që kanë ndodhur më 12, 13 dhe 14 Maj dhe 18 Korrik 1998 në këtë rajon. Më 16 Mars 2006 gjatë marrjes në pyetje të F. H. Isuf Gashi përsëri e konfirmoi ekzistencën e një konflikti të armatosur midis 18 Shkurtit 1998 dhe fundit të 1998. Më 8 Shkurt 2006 dhe përsëri gjatë Majit 2006, dëshmitari M. B. foli për sulmet (nga Sërbët) mbi Rahovec dhe rrethinat e tija para se të vinte në Kosovë dhe për luftime periodike para dhe pas periudhës kritike. Më 17 Maj 2006 gjatë marrjes në pyetje, dëshmitarët "Z" dhe "TT" folën për sulmet e forcave Sërbe mbi fshatrat në zonë gjatë Qershorit/Korrikut 1998. Më 18 Maj 2006, dëshmitari D foli për betejën në Bellcerka/Rahovec në Korrik 1998 midis Sërbëve/UÇK-së.

Provat tregojnë që ka pasur një përplasje të armatosur me Sërbët, çka rezultoi në plagosjen e Islam Gashit dhe vrasjen e shokëve të tij. A ndodhi kjo apo jo? Ka disa deklaratat që sugjerojnë se kjo gjë ndodhi. Deklarata e Isuf Gashit, një prej krijuesve të UÇK-së në Drenovc, përse i përket ngjarjeve në fillim të 1998, kur ai bëles përmendi përdorimin nga agresorët Sërbë të tankeve dhe helikopterëve, kjo është shumë demaskuese. Shumë dëshmitarë dhanë deklaratat për luftime në muajt Qershor dhe Korrik 1998 dhe për faktin se civilat u detyruan nga veprimet ushtarake, që të largohen nga shtëpitë e tyre, fshatrat dhe se shumë viktima u shkaktuan gjatë këtyre incidenteve. Gjeneral Musa Jashari qartazi dhe pa asnjë mëdyshje deklaroi se prej Marsit 1998 e më tej "Lufta" në Kosovë u rrit në intensitet. Vetë i pandehuri Selim Krasniqi i tha Gjykatës se ai erdhi që të ndihmojë UÇK-në e Drenovcit, për shkak të luftimeve dhe se ai ishte shumë i zënë me këtë për të vërejtur çështje të tjera. Përveç kësaj është deklarata e Betejës së rrethinës së Rahovecit, e cila ndodhi në Korrik 1998, kur UÇK-ja e mbajti qytetin për dy ditë.

Gjykata mbriti në përfundimin se provat që vërtetojnë konfliktin e armatosur janë dërmuese. Në bazë të sa më sipër, Gjykata mbriti në përfundimin se konflikti ishte (1) mjaft i zgjatur dhe intensiv dhe që UÇK-ja e kishte mbritur (2) nivelin e kërkuar organizativ, si në rang territorial po ashtu edhe rajonal, të domozdoshme gjatë periudhës kritike, dhe ishte (3) në kontroll të mjaftueshëm për ti dhënë konfliktit aspektin e një konflikti të armatosur, për të cilin aplikohen obligimet si të Nenit 3 të Përbashkët po ashtu edhe të Protokollit Shtesë II. Ka ekzistuar gjatë shtatë muajve të parë të 1998 një konflikt i zgjatur dhe intensiv në teritorin e Kosovës, i cili u zgjerua dhe preku lokalitetin e Drenovcit si dhe fshatrat rreth tij.

Natyra detyruese e aplikimit të ligjit ndërkombëtar mbi palët

Neni 3 i Përbashkët ofron që "në rastin e konfliktit të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar, i cili ndodh në teritorin e një prej Palëve Kontraktuese, secila Palë në konflikt duhet që të detyrohet të aplikojë minimumin e dispozitave të mëposhtëme..."

Protokolli Shtesë II nuk është i qartë, përderisa ai nuk i referohet "palëve në konflikt", por përmend vetëm Palët Kontraktuese në Protokoll, të cilat janë Shtetet.

Pamvarësisht prej këtij fakti, komuniteti ndërkombëtar e ka konsideruar në mënyrë të përgjithëshme ratifikimin e normave relevante të një traktati nga një shtet për të qënë baza të mjaftueshme, për detyrimet e grupeve të armatosura kundërshtare për tu pajtuar me dispozitat e këtyre traktateve. Kjo është bazuar në në principet e jurisprudencës legjislative. Me fjalë të tjera një traktat ose një konventë e ratifikuar nga një shtet (në këtë rast RSFJ²⁸²) është e detyrueshme mbi të gjithë qytetarët e këtij shteti, përderisa qeveria e krijuar në mënyrë të ligjshme e ka kapacitetin për të qeverisur për të gjithë shtetasit.

Për më tepër, në rastin e pranishëm dispozitat relevante janë të aplikueshme nën mbrotjen si të ligjit të traktatit ndërkombëtar, po ashtu edhe nën atë të ligjit vëndor dhe pala kryengritëse kishte rënë dakord dhe e deklaroi veten e saj të lidhur me këto dispozita. Për këtë arsye vijon që ligji i aplikueshëm duhet të jetë detyrues për të gjitha palët. Neni 34-36 i Konventës së Vjenës në Ligjin mbi Traktatet, në të cilat RSFJ ishte nënshkruese e tyre, ofron atë që traktatet mundet të imponojnë të drejta dhe detyrime ndaj palëve të treta duke paraparë që (a) se ishte qëllimi i palëve të traktatit për të vepruar kështu dhe (b) pala e tretë i aprovon këto të drejta dhe detyrime.

Mendimi i gjykatës është se nuk ka dyhim nga leximi si Nenit të Përbashkët 3 dhe Protokollit Shtesë II, se ishte qëllimi i nënshkruesve të traktatit për të detyruar të të gjitha palët, përfshirë edhe palët e treta. Në kontekstin e Kosovës dhe të konfliktit të armatosur, Komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, të sjella si provë²⁸³, e tregojnë atë qartazi që nga stadet e herëshme të këtij konflikti midis UÇK-së dhe regjimit Sërb, UÇK-ja e pranoi që tu bindet dispozitave të Traktateve dhe të Ligjeve Ndërkombëtar Humanitare dhe tu bazohej atyre përgjatë gjithë konfliktit.

Pjesmarja e të pandehurve në konfliktin e armatosur

Të gjithë të pandehurit ose në deklaratat e dhëna në polici, te Gjykatësi hetues ose në deklaratat e dhëna Kolegjit gjykues e konfirmuan, se ata ishin anëtarë të UÇK-së gjatë periudhës kritike gjatë periudhës kritike. Selim Krasniqi, Islam Gashi dhe Bedri Zyberaj ishin anëtarë aktivë të saj para 1 Qershorit 1998.

Agron Krasniqi pretendon se ai nuk u rreshtua në të deri pas kthimit të tij nga Universiteti në ose rreth 21 Qershorit 1998. Por pamvarësisht prej deklaratave të të akuzuarit Agron Krasniqi dhe kushëririt të tij dhe mikut të tij të mirë Sinan Krasniqi, deklarata nga një të tjerë dëshmitarë, të cilët e panë atë të mirrte pjesë edhe para kësaj date, sugjerojnë që ai i ishte bashkuar asaj më herët. Në lidhje me incidentin që përfshinte Murat Rustemin, i cili u arrestua dhe mbajti më 10 Qershor 1998, të dy dëshmitarët N [redacted] R [redacted] dhe H [redacted] R [redacted] e identifikuan atë qartazi, si një prej rrëmbyesve dhe N [redacted] R [redacted] i tha Kolegjit Gjykues se ai e njihte të pandehurin. Dëshmitari anonym "N" e identifikoi atë si një prej rrëmbyesve dhe dëshmitari anonim "TT" deklaroi se kur ajo/ai vajti në qendrën e paraburgimit në Drenovc, ajo/ai e takoi të pandehurin disa ditë më pas, në fillim të Qershorit 1998, në atë kohë i pandehuri tha se ishte në Prishtinë. Dëshmitari anonim "Z" dha deklaratë në lidhje me H [redacted]

²⁸² Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ratifikoi më 1949 Konventën dhe Protokollin Shtesë II më 1978.

²⁸³ Prova 16

P██. Kur dëshmitari vajti në qëndrën e paraburgimit në Drenovc afërsisht një javë më pas, ajo/ai e takoj të pandehurin, i cili i tha dëshmitarit anonim “Z”, që të priste.

Nga provat e paraqitura, gjykata është e mendimit se është provuar përtej dyshimit të mirëbesuar, se secili prej të akuzuarve mori pjesë në konfliktin e armatosur, veçanërisht gjatë periudhës kritike.

Lidhja midis konfliktit të armatosur dhe akteve të kryera

Ligji

Për të plotësuar parakushtet jurisprudenciale të Nenit 142, Kp i RSFJ, përveç ekzistencës së një konflikti të armatosur, duhet që të provohet se ka patur një lidhje të mjaftueshme midis akteve të supozuara të të pandehurve dhe konfliktit të armatosur²⁸⁴. Konflikti i armatosur nuk duhet që të ketë qënë i rastësishëm për kryerjen e krimit që vihet në ngarkim, por ai duhet që të ketë luajtur një rol thelbësor në aftësitë e kryerësit për ta kryer atë krim²⁸⁵. Në përcaktimin e asaj nëse një lidhje e tillë ekziston, jurisprudenca ndërkombëtare ka vendosur tashmë se një gjykatë mundet që të marrë parasysh, *inter alia*, (1) nëse kryerësi është një luftëtar; (2) nëse viktima nuk është një luftëtar; (3) nëse viktima është një anëtar i palës kundërshtarë; (4) nëse akti mundet që të thuhet të ketë shërbyer si qëllimi i fundit i një fushatë ushtarake, ose (5) nëse krimi është kryer si pjesë e ose në kontekst të detyrave zyrtare të kryerësit²⁸⁶.

Provat që përcaktojnë lidhjen

Konflikti i armatosur luajti një rol thelbësor në aftësinë e të pandehurve për të kryer krimet që u vihen në barrë.

Mjedisi i konfliktit të armatosur në zonën, ku të gjithë veprat inkriminuese janë kryer, krijojnë një mundësi objektive për disa njësi dhe /ose individë të UÇK-së, që të sigurojnë forcën e autoritetit rregullator për të kryer arrestime, paraburgime dhe marrje në pyetje të popullsisë civile të dyshuar për mosbesnikëri. Sjellja dhe metoda të cilën ata ndoqën, u ngjit deri në nivelin e Krimeve të Luftës. Mundësija objektive për kryerjen e këtyre krimeve nga UÇK-ja është përcaktuar prej fakteve që UÇK-ja kishte kontrollin faktik të pjesëve të rëndësishme të zonave që janë përmëndur tashmë²⁸⁷.

Një numër dëshmitarësh konfirmojnë që ndërsa kërkonin prej relativëve se kush u “arrestua” nga UÇK-ja, ato u referuan nga popullata vetëm te komandanti i UÇK-së në Drenovc, si organizimi që ishte në gjëndje të mbante ose të lironte të arrestuarit në këto rrethana. Asnjë prej

²⁸⁴ Tadic, Dhoma e gjykimit të GjNPJ, Opinion dhe Akgjykim, 7 Maj 1997, Çështja no. IT-94-1-T, paragrafet 572-575.

²⁸⁵ Kunarac, Kovac dhe Vokovic, Dhoma e apelit t GjNPJ, Aktgjykim, 12 Qershor 2002, Çështja no. IT-96-23, paragrafi 58.

²⁸⁶ Kunarac, Kovac dhe Vokovic, Dhoma e apelit t GjNPJ, Aktgjykim, 12 Qershor 2002, Çështja no. IT-96-23, paragrafi 59.

²⁸⁷ Kunarac, Kovac dhe Vokovic, Dhoma e apelit t GjNPJ, Aktgjykim, 12 Qershor 2002, Çështja no. IT-96-23, paragrafi 9.

dëshmitarve nuk deklaroi se ajo/ai u ankua te forcat e rregullta policore rreth atyre arrestimeve të paligjëshme.

Situata e konfliktit të armatosur krijoi një atmosferë frike mes njërëzve për sigurinë personale të tyre, por përveç kësaj kishte një shkallë të theksuar të pasigurisë dhe dyshimit jo vetëm midis komuniteteve etnike Shqiptare dhe Sërbe, por po ashtu edhe brënda vetë komunitetit Shqiptar. Popullata Sërbe po u raportonte informacione autoriteteve të rregullta rreth aktivitetit të UÇK-së. Në të njëjtën kohë një numër i madh i popullatës Shqiptare ishte duke bashkëpunuar me UÇK-në, për të mbrojtur veten e tyre prej veprimeve armiqësore të policëve Sërb dhe paraushtarakëve.

Identifikimi i “bashkëpunëtorve të Sërbëve” midis Shqiptarëve ishte një detyrë e UÇK-së dhe Policisë së saj Ushtarake. Ekzistenca e situatës objektive të përshkruar krijoi mundësinë, për plotësimin pa vështirësi të kësaj detyre brënda teritorit që kishin nën kontroll.

Gjatë hetimit dhe shqyrtimit kryesor, u bë e qartë se arësyeja bazë për mbajtjen e viktimave ishte bashkëpunimi i tyre i supozuar me Sërbët, ose për shkak të shoqërimit me Sërbët, ose për shkak se u besua që ata ishin tradhëtarë. U konfirmua direkt ose indirekt prej deklaratave të mara gjatë hetimit dhe Shqyrtimit kryesor.

- Selim Krasniqi në deklaratën e tij të dhënë te Gjykatësi hetues pranoi se ai dinte rreth personave që ishin mbajtur në disa zyra në Zatic nën dyshimin e të qenurit bashkëpunues të Sërbëve²⁸⁸. Në deklaratën e tij dhënë policisë²⁸⁹, ai përmendi gjithashtu se bashkëpunorët janë marë në pyetje. Gjatë gjyqimit ai deklaroi se Gani Paqarizi pati bisedime me bashkëpunorët dhe konfirmoi atë që politika e UÇK-së ishte që çdo person i cili ishte duke u sjellur në rrugë të gabuar ti jipej një shans nga UÇK-ja për të kontribuar për popullin e tyre dhe jo për armikun²⁹⁰.
- Dëshmitari anonim “W” deklaroi se Selim Krasniqi dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së e thirrën atë: “Hajde këtu ju tradhëtar”; dhe më pas ajo/ai u akuzua që kishte lidhje me autoritetet Sërbe, e rrahën dhe më pas e ndaluan²⁹¹.
- Dëshmitari anonim “X” deklaroi se ajo/ai ishte arrestuar dhe ndaluar nga UÇK-ja, dhe më pas marrë në pyetje si në fshatin Retimlje po ashtu edhe në fshatin Drenovc për çështjen e gjoja bashkëpunimit të saj/tij të fshehtë me autoritetet Sërbe²⁹².
- Dëshmitari anonim “D” deklaroi se ajo/aid he H [redacted] P [redacted] u ndaluan dhe morën në pyetje nga UÇK-ja rreth personit me emrin H [redacted] Rr [redacted], të cilin ata të dy e njihnin se punonte për policinë Sërbe (DPB) në Rahovec. H [redacted] P [redacted] u arrestua njëkohësisht prej UÇK-së²⁹³.

²⁸⁸ Shih deklaratën e Selim Krasniqit te Gjykatësi hetues, 18 Shkurt 2004.

²⁸⁹ Deklarata në Polici e datës 17 Shkurt 2004.

²⁹⁰ Shih proces-verbalin e gjyqimit të të pandehurit Selim Krasniqi, 21 Qershor 2006, faqe 16 dhe 18.

²⁹¹ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “W”, 18 Maj 2006, faqe 4 dhe 7.

²⁹² Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “X”, 30 Nëntor 2006, faqe 6 dhe 7.

²⁹³ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “D”, 18 Maj 2006, faqe 22.

- Dëshmitari anonim “E” deklaroi se kur ajo/ai u arrestua prej UÇK-së, ajo/ai u mor në pyetje prej Bedri Zyberajt, i cili e akuzoi atë se punonte për Sërbët, duke qëndruar me ta dhe duke spiunuar për ta kundër UÇK-së. Dëshmitari deklaroi se ajo/ai i kishte të gjitha rësyet për të qënë i friksuar që të “zhdukej”, përderisa “shumë njerëz ishin vrarë”²⁹⁴.
- Dëshmitari anonim “E” deklaroi se disa prej ushtarëve të UÇK-së “ishin duke luftuar kundër vetë popullit të tyre” (që do të thotë – kundër popullatës Kosovare Shqiptare)²⁹⁵.
- Dëshmitari anonim “Z” duke folur rreth ndalimit të H■■■■ P■■■■ flet për mbajtjen e një “Liste të Zezë” nga UÇK-ja²⁹⁶.

Megjithatë pas disa instancave të akuzimit zyrtar të bashkëpunimit me Sërbët, ishte thjesht një larje llogarish me viktimat.

- Një prej dëshmitarëve u rrah sipas urdhërit të Selim Krasniqit pasi ai u mor në pyetje mbi atë nëse kishte marrëdhënie të këqija me një ushtar të UÇK-së. Selim Krasniqi e pyeti atë “pse nuk jeni ju në marrëdhënie të mira me të”, dhe më pas ai urdhëroi dy ushtarë të UÇK-së që ta rrihnin dëshmitarin²⁹⁷.
- I akuzuari Bedri Zyberaj i tha një tjetër dëshmitari se i afërmi i këtij të fundit ishte i ndaluar për shkak të asaj se nuk e la Bedriun që të kalonte nga fusha e tij me traktor, dhe djali i tij i shqetsonte fëmijët e Bedriut. Bedriu shtoi gjithashtu se “ai po priste që të vinte kjo ditë”²⁹⁸.

Ka një sqarim në jurisprudencën ndërkombëtare të Krimeve të Luftës në këtë çështje, që thotë se “krimi [luftës] nuk duhet që të kryhet nga kryerësi për motive thjesht personale”²⁹⁹.

Në këto dy çështjet e fundit, veprime të pa ligjëshme kundër civilëve të cilat janë të shtyra nga motivet personale në një shkallë më të ulët apo më të lartë, u bënë të mundshme vetëm në lidhje me një nivel të caktuar të pushtetit të fituar prej disa prej të pandehurve për kontrolluar zonën me kufizimet e saja. Ky pushtet ishte i lidhur drejtpërdrejtazi me pozicionin influencues në strukturat e UÇK-së, si dhe mbi të gjitha me kontrollin e zonës së fituar prej UÇK-së prej dhe përgjatë periudhës së kohës relevante me aktakuzën.

Ka një lidhje shumë të qartë midis akteve të supozuara kriminale të Krimeve të Luftës kundër të akuzuarve, si dhe situatës së një konflikti të armatosur në Kosovë, sikundër ajo ekzistonte gjatë periudhës të përfshirë në Aktakuzë.

²⁹⁴ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “E”, 15 Mars 2006, faqe 19.

²⁹⁵ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “E”, 22 Mars 2006, faqe 28.

²⁹⁶ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “Z”, 17 Maj 2006, faqe 5, dhe Proces-verbali i hetimit 8 Shtator 2005.

²⁹⁷ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit anonim “U”, 14 Dhjetor 2005, faqe 8.

²⁹⁸ Shih proces-verbalin e Dëshmitarit N■■■■ R■■■■ 25 Maj 2006, faqe 8.

²⁹⁹ Akayescu, GNPR, Aktgjykimi i shqyrtimit, 7 Maj 1997, Çështja no. ICTR-96-4-T, 2 Shtator 1998, paragrafi 636.

Statusi i Viktimave

Neni 142 i KP të RSFJ kërkon qartazi që viktimat e ndonjë krimi themelor të jenë pjesë të popullatës civile.

Ligji Ndërkombëtar Humanitar (LNH) bën një dallim midis civilëve dhe luftëtarëve dhe në një konflikt të armatosur personi shenjë, *duhet që të jetë e një natyre civile predominuese. Pranija e disa jo civilëve në mesin e tyre nuk e ndryshon karakterin e popullatës*³⁰⁰. *Duke folur në mënyrë të përgjithëshme popullata civile përfshin të gjithë personat, të cilët nuk marin pjesë aktive në veprimet luftarake*³⁰¹.

Në rastin e konflikteve të armatosuar ndërkombëtare, civilët, personat e nxjerrë “jashtë luftimit” (me fjalë të tjera jashtë veprimit) dhe jo luftëtarët janë të mbrojtur prej principeve bazike të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar në veçanti nga Koneventa e Katërt e Gjenevës të 1949, dhe veçanërisht Protokollet e tyre Shtesë të 1977. Në rastin e konflikteve të brëndëshme të armatosura, të njejtët persona kanë të drejtën e mbrojtjes nën Nenin 3 të Përbashkët për të gjitha Katër Konventat e Gjenevës. Prandaj është e qartë se në rastin e konfliktit të brëndshëm, Ligji Humanitar Ndërkombëtar përmes dispozitave të Nenit të Përbashkët 3 dhe Protokolleve Shtesë II mbron të gjithë personat që nuk janë luftëtarë dhe që nuk marin as “pjesë aktive” as “pjesë direkte” në veprimet luftarake. Këto dispozita në një minimum të tyre duan që të mbrojnë civilët.

Nën dritën e provave të paraqitura, Gjykata mbreti në përfundimin se viktimat ishin civilë. Nuk ka prova që të shpijen në përfundimin se ndonjë prej viktimave ka marë ose “pjesë aktive” ose “pjesë direkte” në veprimet luftarake në kundërshtim me qëllimin e UÇK-së ose të Nacionalistëve Shqiptarë, në kohën që ata u rrëmbyen.

Në të kundërt, dëshmia e dhënë prej anëtarve të familjes së viktimave kryesore si dhe të dëshmitarve të tjerë çon në përcaktimin e asaj që të burgosurit ishin civilë ku përfshiheshin avokatë, mësues, fermerë, punonjës bujqësie, barinj dhe shofer autobusi dhe që nuk po merrnin pjesë në veprimet luftarake kur krimet u kryen.

Shkelja e Ligjit Vëndor dhe Ndërkombëtar në fuqi në kohën e administruar (testi i dualitetit).

Nën Nenin 142 të CP të RSFJ përcaktimi i sjlljes së ndaluar duhet që të gjindet ndën veprat penale të nënvizuara e të cituara në këtë Nen 142 të CP të RSFJ³⁰². Së dyti një vepër e tillë duhet që të përbëjë një shkelje të traktateve ndërkombëtare³⁰³. Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë i ka ratifikuar Konventat e Gjenevës dhe të dy Protokollet Shtesë. Në lidhje me

³⁰⁰ Tadic, Aktgjykimi i Dhomës gjykuese të GjNPJ, 7 Maj 1997, Çështja no. IT-94-1-T, paragrafi 638.

³⁰¹ R. Goldman, *Ligji Ndërkombëtar Humanitar dhe Konfliktet e Armatosura në Salvador dhe Nikaragua*, në: *American University Journal of International Law and Policy*, 1987.

³⁰² Kjo përfshin vrasjet, torturat, trajtimi jo njerëzor, vuajtje e madhe ose shkelja e integritetit trupor ose i shëndetit; aplikimi i masave të frigimit dhe terrorit.

³⁰³ Shih Vendimin e Gjykatës Supreme në apelin e Miroslav Vuckovic, 15 Korrik 2004, faqe 20.

aktet e kryera në një konflikt të brëndshëm të armatosur, akti duhet që të kryhet në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 dhe/ose Protokollit Shtesë II³⁰⁴.

Trajtimi njerëzor është guri i themelit i të gjitha katër Konventave, dhe përbën bazat themelore të nënvizuara përgjatë Nenit të Përbashkët 3 dhe Protokollit Shtesë II, përderisa dispozitat e këtyre traktateve garantojnë të drejtën për një trajtim njerëzor dhe qartazi ndalojnë një numër aktesh. Është e pamundëshme të përcaktohet një listë shteruese e akteve jo njerëzore, por këto akte specifikisht të përshkruara prej Nenit të Përbashkët 3 dhe Neneve 4 e 5 të Protokollit Shtesë II përfshijnë torturën, trajtimin çnjerëzor, fyerje të dinjitetit njerëzor, dhe trajtimin ofendues dhe degradues të tij. Këto aktivitete janë plotësisht të ndalueshme në çdo kohë dhe në çdo vënd çfarëdoqoftë³⁰⁵, dhe të gjithë personat e mbrojtur në të gjitha rrethanat duhet që të trajtohen në mënyrë humane.³⁰⁶

Veçantitë e Krimeve të Luftës të pohuara.

Tortura: elementët ligjorë

Midis veçantive të Krimeve të Luftës të pohuara, është listuar tortura.

Në çështjen Kvočka³⁰⁷ të GjNPJ janë përcaktuar elementët e veprës penale të torturës si në vijim.

- (i) Tortura konsiston në shkaktimin prej aktit ose heqjes së dhimbjes ose vuajtjes së madhe, qoftë fizike ose mendore;
- (ii) akti ose heqja duhet që të jetë i qëllimshëm; dhe
- (iii) akti ose heqja duhet të jetë për një qëllim ndalues, sikundër është marrja e informacionit ose pohimit, ndëshkimit, frigimit, turpërimit, ose shtrëngimit të viktimës ose një personi të tretë, ose diskriminimin, mbi çdo bazë, kundër viktimës ose një personi të tretë.

Përsa i përket elementit të vuajtjes, çështja Kvočka³⁰⁸ deklarohet se,

“Në përputhje me jurisprudencën e të drejtave njerëzore duke interpretuar torturën, Dhoma e Gjykimit të Celibici-t ka përcaktuar se ashpërsija e dhimbjes ose e vuajtjes, është një karakteristikë dalluese e torturës që e veçon atë prej veprave penale të ngjashme.

³⁰⁴ Neni 3 (1)(a) i Konventës së Gjenevës e ndalon dhunimin e jetës, shëndetit ose mirëqënies shëndetsore ose mendore të personave, po ashtu trajtimin vrasës mizor sikundër tortura, mutilimi ose ndonjë formë të ndëshkimit trupor.

³⁰⁵ Neni i Përbashkët 3 (1).

³⁰⁶ Protokollit Shtesë II, Neni 4.

³⁰⁷ Kvočka, GjNPJ, Aktgjykimi i Dhomës Gjyquese, 2 Nëntor 2001, Çështja no. IT-98-30/1-T, paragrafi 141.

³⁰⁸ E njëjta, paragrafet 142 deri në 149.

Një kufi i qartë për përcaktimin se çfarë shkalle e vuajtjes është e mjaftueshme, për të plotësuar përkufizimin e torturës nuk është vijëzuar. Në vlerësimin e seriozitetit të çfarëdo keqtrajtimi, Dhoma e Gjyimit duhet së pari të marrë në konsideratë ashpërsinë objektive të lëndimit të shkaktuar. Kriteri subjektiv sikundër është efekti fizik dhe mendor i trajtimit mbi një viktimë të veçantë dhe, në disa raste, faktorët sikurse mosha e viktimës, seksi, ose gjendja shëndetsore do të jetë gjithashtu relevante në vlerësimin e rëndesës së lëndimit.

Raportuesi Special i UN-it mbi torturën, organizmat për të drejtat e njeriut, dhe shkollat juridike kanë listuar disa akte që janë konsideruar mjaft të ashpra në vetvete, për të përbërë torturë dhe këto që kanë gjasa të përbëjnë torturë mvaret prej rrethanave. Rrahja, dhuna seksuale, mohimi i zgjatur i gjumit, ushqimit, higjenës, dhe ndihmës mjeksore, po ashtu edhe kërcënimi për torturim, përdhunim, ose vrasjen e të afërmëve janë midis akteve më të zakonshme të përmëndura si ato që kanë gjasë të përbëjnë torturë. Mutilimi i pjesëve të trupit mundet të jetë një shëmbull i akteve që në vetvete përbëjnë torturë.

Jurisprudenca e Gjykatave, konsistente me jurisprudencën e organizmave për të drejtat njerëzore, i mbahet asaj se përdhunimi mundet që të përbëjë dhimbje të ashpër dhe vuajtje që mbrin në torturë, ofruar atë që elementët e tjerë të torturës sikundër është një qëllim i ndaluar, plotësohen.

Në disa raste që përfshijnë Zairen, Komiteti për të Drejtat e Njeriut i UN-it gjen se kombinime të variueshme të akteve që vijojnë përbëjnë torturë: rrahja, shoku elektrik në organet gjenitale, ekzekutimet qesëndisëse, heqja e ushqimit dhe ujit, si dhe “shtypja e gishtit.” Në konsiderimin e ankimimeve individuale të sjella kundër Uruguajt dhe Bolivisë, Komiteti për të Drejtat e Njeriut gjen se rrahja sistematike, elektroshokët, djegjet, varjet e zgjatura me zinxhirë prej duarve dhe/ose këmbëve, zhytjet e përsëritura në një përzierje gjaku, urine, të vjellash dhe ekskrementi (“nëndetsja”), qëndrimi në këmbë për një kohë të gjatë, dhe ekzekutimi qesëndisëse ose amputimi mbrijnë në torturë.

Në gjykimet e mbajtura në Japoni pas Luftës së Dytë Botërore, Gjykata Ndërkombëtare Ushtarake për Lindjen e Largët (GJNULL) mbrin në përfundimin, se shumica e formave prevalente të torturës të shkaktuara sistematikisht prej ushtarëve Japonezë ndaj forcave Aleate ose ndaj civilëve në vëndet e pushtuara përfshinin “trajtimin me ujë, djegjet, shokun elektrik, shpalosjen e gjurit, varjen, gjynjëzimin mbi instrumenta të mprehtë dhe fshikëllimin me kamxhik.” Qartazi është e pamundëshme që të sajohet një listë shteruese e torturave të praktikuar.

Megjithse praktika të tilla të torturës shpesh shkaktojnë dëmtime të përherëshme ndaj shëndetit të viktimave, lëndimi i përhershëm nuk është një kërkesë për torturën.

Dëmtimi ndaj shëndetit fizik ose mendor duhet që të mirret parasysh në vlerësimin e rëndesës së lëndimit të shkaktuar. Dhoma e Gjyimit vëren se abuzimi në mbrtitjen te tortura në mënyrë të domozdoshme përfshin lezionimin fizik, mqse lëndimi mendor është një formë prevalente e shkaktuar prej torturës. Për momentin, vuajtja mendore e shkaktuar ndaj një individi i cili është i detyruar të vëzhgojë shkaktimin e keqtrajtimeve të rënda ndaj një të afërmi mundet që të ngrihet në nivelin e rëndesës së kërkuar në krimin e torturës. Në mënyrë të ngjashme, Dhoma e

Gjykimit të Furundzija mbrin në përfundimin se të qënurit i detyruar për të vëzhguar shkaktimin e sulmeve të rënda seksuale ndaj një të afërmit tënd femër ishte torturë për vëzhguesin e detyruar. Prani e shikuesve në veçanti të anëtarve të familjes, gjithashtu shkaktonte lëndim të rëndë mendor që mbrin torturën mbi personin që përdhuhet”.

Element tjetër është qëllimi i ndaluar që qëndron pas torturës. Çështja Delailac³⁰⁹ mirret me këtë pikë.

“Një tjetër element kritik i veprës penale të torturës është prani e një qëllimi të ndaluar. Sikundër u deklarua më parë, lista e katër qëllimeve të ndaluara në Konventën mbi Torturën zgjerohet mbi ato të listuara në Deklaratën mbi Torturën duke shtuar “diskriminimin e çdo lloji”. Përdorimi i fjalëve “për këto qëllime” në përkufizimin e zakonshëm të torturës, tregon se qëllimet e variueshme të listuara nuk përbëjnë një listë shteruese, dhe duhet që të kqyret si një përfaqesuese e thjeshtë. Më tej, nuk ka kërkesë që sjellja duhet që të kryhet vetëm për qëllimin e ndaluar. Kështu, me qëllim që kjo kërkesë të plotësohet, qëllimi i ndaluar duhet thjesht që të jetë pjesë e motivimit pas sjelljes dhe nuk ka nevojë që të predominojë ose të përbëjë tabanin e qëllimit”.

Në Kvočka³¹⁰, Dhoma Gjyquese ra dakord që elementi i qëllimit të ndaluar nuk duhet që në mënyrë të kufizuar të ndërtohet dhe deklarohet.

Dhoma e Gjykimit ra gjithashtu dakord me Dhomën e Gjykimit të Celebicit se qëllimi i ndaluar i listuar në Konventën mbi Torturën sikurse pasqyrohet ay nga ligji ndërkombëtar i zakonshëm “nuk përbën një listë shteruese, dhe duhet parë si një përfaqesuese e thjeshtë”, dhe vëren se Dhoma e Gjykimit të Furundzija mbrin në përfundimin se poshtërimi i viktimës ose i një personi të tretë përbën një qëllim të ndaluar për torturën nën ligjin ndërkombëtar humanitar [Paragrafi 40].

Në çfarë mbrihet në një qëllim të ndaluar, GjNPJ në çështjen Kvočka³¹¹ deklarohet:

“Jurisprudenca e Gjykatave njih disa qëllime të ndaluara që kualifikohen si torturë. Dhoma e Gjykimit të Akayesu ka adoptuar qëllimet e ndaluara që përmbahen në Konventën kundër Torturës, pikërisht për të siguruar informacion ose një pohim prej viktimave ose një personi të tretë, për të ndëshmuar viktimën ose personin e tretë, ose për çdo arsye bazuar në diskriminimin e çdo lloji. Dhoma e Gjykimit të Furundzija shtoi qëllimin për të poshtëruar në listën e qëllimeve të ndaluara.

Dhoma e Gjykimit të Celebicit thekson me të drejtë se qëllimi i ndaluar ka nevojë të jetë as tabani dhe as qëllimi kryesor i shkaktimit të dhimbjes së rëndë ose vuajtjeve.

³⁰⁹ Delailac dhe të tjerë, Aktgjykimi i Dhomës gjyquese të GjNPJ, 16 Nëntor 1998, Çështja no. IT-96-21, paragrafi 470.

³¹⁰ Kvočka, GjNPJ, Aktgjykimi i Dhomës Gjyquese, 2 Nëntor 2001, Çështja no. IT-98-30/1-T.

³¹¹ Kvočka, GjNPJ, Aktgjykimi i Dhomës Gjyquese, 2 Nëntor 2001, Çështja no. IT-98-30/1-T, paragrafet 152-154.

Në interpretimin e qëllimit të ndaluar të torturës, Dhoma e Gjykimit ka gjetur rregullisht se tortura ekzistonte kur qëllimi i kryerësit ishte të ndëshkonte ose të siguronte informacion ose një pohim. Gjykatat kanë gjetur gjithashtu shëmbuj kur tortura ishte shkaktuar si një mjet diskriminimi mbi bazën e gjinisë. Për më tepër, Dhoma e Gjykimit të Celebicit thekson se dhuna e shkaktuar në një kamp burg është shpesh e kryer me qëllim, të sigurimit të frigimit jo vetëm të viktimës por gjithashtu edhe të të burgosurve të tjerë.”

Elementi i fundit është elementi i qëllimit. Duhet që të përcaktohet se kryerësi kishte për qëllim të veprë në një mënyrë të tillë, e cila në zhvillimin normal të ngjarjeve do të shkaktojë viktimave të tij dhimbje viktimave të tij të madhe ose vuajtje, qoftë fizike ose mendore.

Trajtimi mizor dhe jo njerëzor

Në çështjen Delalic³¹², GjNPJ bëri vëshgimet e mëposhtëme në atë se çfarë përbën trajtimin jo njerëzor:

“Në thelb, Dhoma e Gjykimit është e opinionit se trajtimi jo njerëzor është një akt i qëllimshëm ose heqje, që është një akt i cili i gjykuar objektivisht është i paramenduar dhe jo aksidental, që shkaktjnë vuajtje ose lëndime serioze mendore ose fizike, ose përbëjnë një sulm serioz mbi dinjitetin njerëzor. Kuptimi sheshtë, i zakonshëm i termit trajtim jo njerëzor në kontekstin e Konventave të Gjenevës konfirmon këtë qasje dhe sqaron kuptimin e veprës penale. Kështu, trajtimi jo njerëzor është një trajtim i qëllimshëm i cili nuk është konform me principet fundamentale të njerëzimit, si dhe formon një ombrellë nën të cilën ajo çka mbetet prej listës “shkeljet e rënda” në Konventë bije. Kështu, aktet e karakterizuara në Konventat dhe Komentaret si jo njerëzore, ose të cilat nuk janë konsistente me principet e njerëzimit, përbëjnë shëmbuj veprimesh që mundet të karakterizohen si trajtim jo njerëzor”³¹³.

“Në këtë kornizë të veprave penale, të gjitha aktet që gjinden të përbëjnë torturë ose shkaktim të qëllimshëm të vuajtjes ose lëndime serioze të trupit ose shëndetit përbëjnë gjithashtu trajtimin jo njerëzor. Megjithatë, kjo kategori e tretë e veprës penale nuk kufizohet në ato akte tashmë të inkorporuara në dy të tjerat, dhe zgjerohet më tej në aktet e tjera që shkelin parimet bazë të trajtimit njerëzor, në veçanti respektin për dinjitetin njerëzor. Së fundmi, çështja e asaj nëse çdo akt i veçantë i cili nuk bije në kategoritë e këtij grupi qëndror është i papajtuashëm me principin e trajtimit jo njerëzor, dhe përbën kështu trajtimin jo njerëzor, është një çështje e faktit, i cili duhet të gjykohet në të gjitha rrethanat e çështjes së veçantë”³¹⁴.

“Bazat e përfundimit të një trajtimi mizor në përputhje me Nenin 3 të Statutit është ndalimi i tij prej Nenit të Përbashkët 3 (1) të Konventave të Gjenevës, të cilat përshkruajnë, “dhunë ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e të gjitha llojeve, mutilacionet, trajtimin mizor dhe torturën”. Përveç ndalimit të tij në Nenin e Përbashkët 3, trajtimi mizor ose mizorija është përshkruar prej Nenit 87 të Konventës së Tretë të Gjenevës, e cila mirret me dënimet për të burgosurit e luftës, dhe Neni 4 i Protokollit Shtesë II, që ofron atë se sjellja në vijim është e ndaluar: dhuna ndaj

³¹² Delalic dhe të tjerë, Aktgjykimi i Dhomës së Gjykimit të GjNPJ, 16 Nëntor 1998, Çështja no. IT-96-21.

³¹³ Delalic dhe të tjerë, Aktgjykimi i Dhomës së Gjykimit të GjNPJ, 16 Nëntor 1998, Çështja no. IT-96-21, paragrafi 543.

³¹⁴ E njëjta, paragrafi 544.

jetës, shëndetit dhe mirëqënies fizike dhe ose mendore të personave, në veçanti vrasja po ashtu edhe trajtimi mizor sikurse është tortura, mutilacioni ose çdo formë tjetër e ndëshkimit trupor”³¹⁵.

“Përsa i përket veprës penale të trajtimit jo njerëzor, instrumentat jo ndërkombëtarë e përkufizojnë këtë veprë penale, megjithse ao është specifikisht e ndaluar prej Nenit 5 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Neni 7 i MNDCP, Neni 5, paragrafi 2 i Konventës Ndër-Amerikane të të Drejtave Humane dhe Neni 5 i Kartës Afrikane të të Drejtave Humane dhe Popujve. Në secilin prej këtyre instrumentave, është përmëndur në të njëjtën kategori të veprës penale si trajtim jo njerëzor”³¹⁶.

“Në Aktgjykimin e Tadic, Dhoma Gjykuese II ofron mendimin e saj të kuptimit të kësaj veprë penale, që deklaron se në përputhje me Nenin e Përbashkët 3, “ndalimi kundër trajtimit mizor është një mjet për ti dhënë fund, dhe ky fund është që të sigurojë se personi që nuk merr pjesë aktive në veprime ushtarake duhet që në të gjitha rrethanat të trajtohet në mënyrë humane.” Kështu, që Dhoma e Gjyimit njih që trajtimi mizor është trajtim që është jo njerëzor”³¹⁷.

“E parë në këtë kontest të Nenit të Përbashkët 3, Neni 4 i Protokollit Shtesë II, instrumentat e ndryshëm të të drejtave njerëzore të përmëndura më lart, si dhe kuptimi i sheshtë i zakonshëm, Dhoma Gjykuese është e mendimit se trajtimi mizor i një sulmi serioz, i cili shkakton vuajtje serioze mendore ose fizike ose përbëjnë një sulm serioz ndaj dinjitetit njerëzor, që është e barazvlerëshme me veprën penale të trajtimit jo njerëzor në kornizën e shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës”³¹⁸.

“ Në dritën e asaj që u tha më lart, dhoma e gjykates konstaton që trajtimi mizor përbën një veprim të qëllimshëm ose mosveprim që është veprim që, i gjykuar objektivisht, është i qëllimshëm dhe jo rastësishëm, që shkakton vuajtje serioze mendore ose fizike ose lëndim ose përbën një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor. Si e tillë, mban një kuptim të barabartë dhe për këtë i njëjti funksion i ngelur për qëllime të të njëjtit nen 3 të Statutit, si trajtimi çnjerëzor lidhur me shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës. Përkatesisht, vepra e torturës nën nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, është gjithashtu e përfshirë brenda konceptit të trajtimit çnjerëzor. Trajtimi që nuk i plotëson kushtet e qëllimshme për veprën e torturës në nenin e përbashkët 3, përbën një trajtim çnjerëzor”³¹⁸.

Shkurtimisht, trupi gjykues i ICTY ka konsideruar që elementet e trajtimit çnjerëzor janë identike me ato të Trajtimit jo human që është përkufizuar “si një veprim i qëllimshëm ose mosveprim që i gjykuar objektivisht është i qëllimshëm dhe jo rastësishëm, që shkakton vuajtje serioze mendore ose fizike ose lëndim ose përbën një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor”. “*Mens rea*” e nevojshme kërkon që kryesi të veprojë me qëllim po sa i përket kategorisë së

³¹⁵ E njëjta, paragrafi 548.

³¹⁶ E njëjta, paragrafi 549.

³¹⁷ E njëjta, paragrafi 550.

³¹⁸ E njëjta, paragrafi 551.

³¹⁸ Ibid, paragrafi 552.

fundit, kryesi nuk nevojitet të ketë qëllimin specifik të poshtërojë ose degradojë viktimën, por ai duhet të jetë në gjendje që ta perceptojë këtë si pasojë të arsyeshme të këtyre veprimeve.

Në rrethanat e luftës jo çdo aspekt i parehatise njerzore imponuar nga një person me vullnet tjetër qon në trajtimin çnjerëzor. Ashtu siç tashmë është deklaruar “Trajtimi çnjerëzor” nuk kufizohet me shkaktimin e lëndimit fizik ose lëndimit të shendetit. Duke konsideruar që pak të drejta njerëzore janë më të rëndësishme se liria e personit, gjykata konsideron për rrjedhojë që masa të caktuara, p.sh, që mund të presin krejtësisht të paraburgosurit civil nga bota e jashtme dhe në veçanti nga familjet e tyre, ose që shkakton lëndime të rënda dinjitetit të tyre njerëzor, mundet të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme si trajtim çnjerëzor.

Në një konflikt ndërkombtar izolimi i civilëve lejohet në disa situata të caktuara. Në rastin e konflikteve të brendshme, as neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenezës as Protokolli shtesë II nuk parashikon me hollësi të drejtën e paraburgimit. Një e drejtë e tillë, sidoqoftë, mund të nënkuptohet nga gjuha e përdorur dhe mund të konkludohet që arrestimet ose paraburgimet nuk qojnë në shkelje të së drejtës ndërkombëtare të traktateve. Sidoqoftë, e drejta për t’u trajtuar në mënyrë njerëzore është në mënyrë të qartë e garantuar dhe më tej, të tilla masa munden vetëm të merren në rastet e nevojës absolute, dhe janë objekt i rregullave të rrepta dhe të drejtave procedurale. Të tilla dispozita kanë mbërritur një nivel si pjesë e të Drejtës Nderkombëtare Zakonore por duke ditur Vendimet e Gjykatës së Lartë të Kosovës, këto nuk aplikohen aktualisht në Kosovo.³¹⁹

Provat në mbështetje të pohimeve të trajtimit çnjerëzor dhe/ose torturës

Termi “ Qendër Paraburgimi” është përdorur gjatë gjithë gjykimit për të përshkruar vendin ku ata që janë marrë, janë mbajtur dhe ku të afërmit e të paraburgosurve kishin qasje. Rasti i Prokurorisë ishte se personat mbajtur ose paraburgosur nga UÇK në muajt Maj, Qershor dhe Korrik të vitit 1998, në një kompleks në fshatin e Drenovc. Kompleksi është përshkruar si ndërtesë shkollë nga disa dëshmitarë. Dëshmitarë të tjerë madje përshkruan hyrjen që të qon te burgu dhe gjendjen aktuale të dhomave të paraburgimit. Disa nga dëshmitarët madje identifikuan kompleksin ose një pjesë të tij nga fotot. Rasti i prokurorisë është që shumica e të burgosurve ose të paraburgosurve janë mbajtur në kompleks pa kushtet dhe pajisjet jetike bazë. Ushtarët e UÇK-së që ruanin burgun u mblodhën në këtë kompleks dhe shumica e marrjeve në pyetje dhe të rrahjeve mendohet që të kenë ndodhur këtu. Referim i është bërë të paraburgosurve atyre që mendohet të jenë mbajtur në këtë kamp të burgut në kohë të ndryshme relevante të aktakuzës.

Nuk ka dyshim që një qendër paraburgimi ka ekzistuar në zonën e Drenovcit në kohët kritike. Në fshatin Drenovc dhe në rrethinat e tij gjatë periudhës kritike, provat e paraqitura nga dhe të vërtetuara nga dëshmia e dëshmitarëve të ndryshëm në mënyrë të qartë vërteton një regjim të rrëmbimeve arbitrare dhe paraburgimeve e pasuar nga rrahje, në të cilën të akuzuarit, si anëtarë të UÇK-së kanë marrë pjesë. Provat do të tregojnë që viktimat ishin ose të rëmbyer nga shtëpitë e tyre nga burra të armatosur të UÇK-së dhe më pas janë dërguar nga UÇK-ja në qendrat e paraburgimit në Drenovc, ose që u është thënë të raportojnë në shtabin e UÇK-s. Të

³¹⁹ Prokurori kundër Kolasinac, Gjykata e Lartë e Kosovës, Aktgjykimi, 9 Janar 2001, AP-KZ

Job No.: AA2937
Created on

Path name: my documents/altina's alb doc Selim Krasniqi verdict/ Boolell
Translated by: ER 1-20, G121-35, ASH 36-48, TK 49-61, OGJ 62-74, ARW 75-87,
ID88-102

Comp. No.: 016
Page 61 of 99

tjerët janë rrëmbyer ndërsa kërkonin për të afërmit që mungonin. Akoma të tjerë janë ndaluar në automjetet e tyre. Disa janë madje arrestuar ndërsa përpiqeshin t'i bashkangjiteshin UÇK-së.

H■■■■ R■■■■ deklaroj lidhur me fotot 13,15,18 dhe 19, Prova materiale D, që qendra e paraburgimit është atje. Shkolla e vjetër ka dy bodrume ose qeli poshtë dhe ishte një burg ose Qendër Paraburgimi. Dëshmitari shtoi që ishte hyrja me disa shkallë. Duke parë foton 13, prova materiale D, dëshmitari tregoi hyrjen kryesore në zonën e paraburgimit. Një hyrje e tillë mundet gjithashtu të shikohet në fotot 15 dhe 18. Dritarja për tek zona e paraburgimit mund të shikohet nga fotoja numër 19.

Dëshmitari E■■■■ R■■■■ deklaroj që ishin dy shkolla afër njëra tjetrës, një e vjetër dhe një e re. Bodrumi i shkollës së vjetër përdorej si burg dhe këto shkolla gjenden në Drenovc. Dëshmitari i është thënë që bodrumi i shkollës së vjetër është përdorur si ndrtesë paraburgimi.

M■■■■ B■■■■ i është thënë nga Bedri Zyberaj, që ka parë në Drenovc që po merrej me çështjen e rrëmbimit të A■■■■ B■■■■ dhe që ai duhet të shkojë në shkollë/burg dhe të pyesë për Selim Krasniqin(Celiku).

Dëshmitari N■■■■ R■■■■ tha që kur ai shkoi të kërkonte për M■■■■ R■■■■ ai po bisedonte me Zaim Bajraktarin dhe ai njohu ata të burgosur që mbaheshin në qendrën e paraburgimit, në shkollën e Drenovcit. Ai dëgjoi këtë nga shumë njerëz sepse të gjithë e dinin që qendra e paraburgimit ishte atje dhe që të paraburgosurit janë mbajtur në shkollë.

Dëshmitari e përshkroi shkollën dhe tregoi që fotoja me numër 6, prova materiale dhe një dritare të vogël në bodrum, që tregohet në anën e majtë të fotografisë, duke treguar që vendi ku janë mbajtur të paraburgosurit. Ai atëherë shpjegoi që ai e dinte këtë sepse kur shkoi në atë vend për t'i dërguar rrobat M■■■■.Atëherë ai u takua me Z■■■■ B■■■■ t'ia dorëzonte rrobat atij. Shkoi te shkallët dhe i kapi veshi që të burgosurit ishin atje. Ai e dëgjoi padashur këtë përmes dritares. Ai u kthye por ishin rojet që qëndronin te dera, kjo i tregoi atij që të burgosurit janë mbajtur atje.

Sipas Dëshmitarit anonim "A" ishte një qendër praburgimi afër ndërtesës së shkollës në Drenovc që ishte e zënë nga UÇK-ja. Ushtarët të cilët i ka parë dëshmitari në Drenovc e dëguan atë brenda " ai vend në të cilin ata mbanin dhe rrihnin njerëzit".Ky vend kishte tre dhoma dhe një korridor. Ushtria ishte në njërën nga dhomat dhe policia në korridor, ndërsa dëshmitari ishte në njërën nga dy dhomat e ngelura, që ishin 3x3 metra. Nuk kishte absolutisht asgjë në atë dhomë me përjashtim të sirtareve ku librat janë mbajtur.

Dëshmitari anonim "B" shkuan të kërkonin për Avdi Berishën dhe ai/ajo pa shkollën në Drenovc. Ai/Ajo identifikoi shkollën nga fotografia numër 3, prova materiale C.

Dëshmitari anonim "E" konfirmoi që ishte një qendër paraburgimi në Drenovac. Ai/Ajo shtoi që disa njerëz janë dërguar gjithashtu në Malisheve, sepse kishte hapësirë të pamjaftueshme në Qendrën e paraburgimit në Drenovac.

Sipas Dëshmitarit anonim "TT" policia ushtarake e UÇK-së kishte zënë shkollën e vjetër në Drenovc njohur si Kazermt e Qymyrit. Këtu është dërguar H [REDACTED] K [REDACTED]

Kur është pyetur që të përshkruaje shtabin ushtarak në fshatin Drenovc ku ai/ajo është marrë në pyetje dhe është rrahur, Dëshmitari anonim "TT" tha ishte një ndërtesë një katëshe dhe ishte e mbuluar me një shtresë të hollë betoni të bardhë. Kishte mure prej druri dhe dritare xhami. Kishte shtëpi prona private afër ndërtesës së shtabit dhe poshtë rrugës ishte gjithashtu ambulance mjekësore e fshatit. Dëshmitarit/res i është kujtuar që para gjyqtarit hetues ai/ajo identifikoi ndërtesën e veçantë ose një pjesë e tyre ku ai/ajo është mbajtur dhe ai/ajo është kërkuar që të vërë një "X" në ndërtesën ose pjesën e ndërtesës që shërbeu si qelia e tij/saj e paraburgimit dhe ai/ajo dhe ai/ajo tha që kujtonte këtë hollësi shumë mirë dhe "Unë e kujtoj që e kam bërë këtë por nuk është i/e përgatitur që të flasë më tej nga frika".

Dëshmitari anonim "X" është arrestuar në Reti dhe është dërguar në shtabin e UÇK-së atje. Ishte një shtëpi dhe ai/ajo është marrë në pyetje atje. Ai/ajo është mbajtur atje dy ditë dhe atëherë u dërguan në bodrumin e ndërtesës së shkollës në Drenovc. Ndertesa e shkollës ishte e zënë nga UÇK-ja. Ai/ajo është mbajtur në një dhomë me dritare të vogël.

Dëshmitari anonim "Z" dha një përshkrim të ndërtesës së shkollës së vjetër ku policia ushtarake ishte vendosur. Ndertesa e vjetër kishte një burg në bodrum. Bodrumi kishte një dritare të vogël me 50x50 cm dhe kishte hekura. Kishte gjithashtu disa hekura në dritare "për të evituar dalen dhe hyrjen në atë vend". Ai/ajo shtoi që shkolla e vjetër nuk ishte e riparuar.

Dëshmitari/rja identifikoi shkollën nga fotot 6,7,8 dhe 9 si shkollën e vjetër, tani e riparuar. Fotografia 11 tregon banjën. Fotografia numër 13 tregon derën hyrëse të burgut. Fotografia numër 18 tregon derën e burgut. Fotografia numër 19 tregon dritaren e burgut. Fotografia numër 20 tregon shkollën e re dhe më pak më tej, është një tip muri që ngrihet mbi dyshemenë, dhe këtu është ku dëshmitari ishte i ulur kur ai/ajo pa H [REDACTED] P [REDACTED].

I pandehuri Selim Krasniqi vetë pranoi ekzistencën e një Qendre të Paraburgimit në Drenovc. Kur u pyet nëse ai dinte rreth ekzistencës së Qendrave të Paraburgimit që operoheshin nga UÇK-ja gjatë së njëjtës kohë i pandehuri u përgjigj "varet çfarë do të thotë Prokurori publik me "paraburgim". Unë kam deklaruar më parë dhe e përsëris që në atë kohë unë shkova në Drenovc dhe UÇK-ja kishte dy zyra. Njëra nga këta zyrat ishte në shkollën e vjetër në Drenovc. Qëllimi i kësaj zyre, që është udhëhequr nga G [REDACTED] P [REDACTED], ishte vetëm për të lejuar njerëzit që të shkonin atje dhe të jepnin informacion dhe deklarata me qëllim që të ndihmonin civilët dhe të ofronin ndihmë.

Ai shtoi "unë kurrë nuk kam deklaruar që njerëzit ishin mbajtur për një ose dy ditë ose një javë. Unë po them që Z.G. [REDACTED] P [REDACTED] mund t'ë më ketë treguar në bisedë që njerëzit do të jepnin një deklaratë dhe atëherë të shihnin punën e tyre. Ndoshta ata kanë ofruar informacion dhe atëherë janë larguar. Bazuar në atë që unë di kam përshypjen që kam sot dhe nuk e përjashtoj

mundësinë që madje dhe një armik bashkëpunëtor ishte i pranishëm në zyrën e tij, qëllimi ishte të qortohej dhe ta kthenim atë në rrugën e duhur kështu që ai mund të punonte për njerëzit e tij dhe të mos bashkëpunonte më tej me armikun. Kjo është mënyra sesi e kuptoj psikologjinë dhe punën e G P

Ai është pyetur nëse i qëndronte atyre deklaratave dhe shpjegimi i tij ishte si më poshtë vijon, “Unë pajtohem me mënyrën sesi e thashë atë por jo në mënyrën sesi u lexua. Është e shkruar këtu që personat janë mbajtur por çfarë kuptoni me fjalën “e mbajtur”? Unë gjithashtu kam deklaruar që njerëzit qëndruan atje derisa dhanë deklaratat e tyre ose derisa ata bënë raportet e tyre dhe përsëri unë e përsëris, që po them që çfarëdo që kam dëgjuar përmes G P. Unë kurrë nuk e kam thënë, dhe nuk do ta them, që një qendër paraburgimi ekzistoi në Drenovc. Unë vetëm thashë që ishte një zyrë e përdorur për funksionet që unë i përmenda më lart.”

I pandehuri nuk dinte për askënd të ishte sjellë tek zyrat e UÇK-së në Drenovc kundër vullnetit të tij ose të saj. Ai e dinte sidoqoftë që njerëzit shkuan atje vullnetarisht. Ai shtoi “ ndoshta ka pasur raste kur njerëzit janë thirrur por nuk jamë në dijeni të rasteve të tilla dhe nuk dua të mendoj që raste të tilla kanë ndodhur”. Ai nuk e dinte nëse ata njerëz që kanë shkuar atje ishin të detyruar të qëndronin për dy ose tre ditë ose më shumë. Meqë ai nuk ishte i pranishëm ai nuk e dinte çfarë lloj njerëzish kanë shkuar atje, por ai mendoj që ishin njerëz që kishin nevojë për ndihmë ose që donin të ofronin informacion. Ata ishin njerëz që kishin respekt të madh për UÇK-në, ose njerëz që vetëm donin të shikonin ato zyra nga kurioziteti”.

Ai është ballafaquar me deklaratën e tij të policisë ku deklaroi, kur iu referua ndërtesës së shkollës në Drenovc, që ai e dinte“ që ata kishin disa zyra ku mbanin disa njerëz që “G P ishte përgjegjës për këtë”. Ai gjithashtu deklaroi në këtë deklaratë që “G P kishte të drejtën që t’i dërgonte njerëzit në atë ndërtesë” dhe që G P njëherë i tha atij që “ai solli Shqiptarët e Kosovës që ishin të dyshuar të ishin bashkëpunëtor të Serbëve dhe që disa nga ata janë kapur në aksion”.

Në lidhje me edukimi/qortimin e bashkëpunëtorëve të dyshuar, ai nuk dinte formën që ai edukim mori dhe nëse ishte e bërë individualisht apo në grup. Nuk i është përmendur atij kurrë që çfarëdo lloj metode është ushtruar kundër bashkëpunëtorëve për të bërë që ata të korrigjojnë sjelljen e tyre. Me sa e dinte ai ata që folën me të dyshuarit e kanë bërë këtë në mënyrë shumë njerëzore. Ai e dinte këtë sepse kështu i kishin thënë. Ai shtoi që nëse ndonjë metodë tjetër është përdorur ai do të kishte dëgjuar rreth kësaj.

Kur ai është pyetur të sqaronte më tej për shprehjen “metodë tjetër” ai deklaroi “me metodë tjetër” unë nënkuptoj cilendo mjete të tjera ose mënyrën e trajtimit të tyre, ose cilendo formë tjetër të komunikimit me ata që do të dëgjohej sigurisht. Dua të theksoj që kjo bisedë ishte një bisedë shumë spontane. Unë po them shembulli sporadik bazuar në atë që kam dëgjuar dhe në kujtesën time sepse siç e kuptoni në atë kohë që ne ishim të zënë nga gjëra të tjera. Unë përmenda dje që në atë kohë unë kam qenë duke u marrë me shumë gjëra të tjera më të rëndësishme se kjo”. Ai gjithashtu shtoi që kur ai përmendi “metodën” dhe “mertodën tjetër”, ai tentoi të krahasonte metodat human dhe jo humane. Kur është pyetur nëse ai ka dëgjuar

ndonjë metodë jo humane të përdorur për qëllime qortimi ai deklaroi që gjatë kohës së shpenzuar në Drenovc ai nuk ka parë të kenë ndodhur gjëra të jashtëzakonshme.

Kur është pyetur nëse ai është pajtuar që G. P. i pati thënë atij ai solli bashkëpunëtor të dyshuar në këtë zyrë, përgjigjja e të pandehurit ishte “Unë pranoj që ai pati biseda me të tillë njerëz gjithashtu dhe më duket krejtësisht normale”. Ai gjithashtu shtoi që ai nuk kishte parë ndonjë armik bashkëpunëtor, por nuk ka përjashtuar mundësinë që një bashkëpunëtor armik ishte i pranishëm në zyrën e G. P. Qëllimi ishte që te ndëshkohej ky bashkëpunëtor dhe ta kthenin atë “në rrugën e duhur”. Ai shpejtoi që nuk mund ta përjashtonte këtë mundësi sepse G. P. i kishte thënë atij kishte njerëz që sollën informacion në këtë zyrë dhe në mesin e tyre, ishin gjithashtu njerëz të cilët më parë bashkëpunonin me Serbinë. Ai pretendon që nuk ka parë kurrë dhe nuk është në dijeni që dikush të jetë marrë ne keto zyra dhe jane marre ne pyetje kundër vullnetit të tyre.

Në lidhje me bashkëpunëtorët që G. P. mund të ketë përmendur, ai nuk dinte nëse ata janë dërguar në zyrën e G. P. Ku ai është pyetur nëse ishte policia ushtarake, ai deklaroi që nuk donte të spekulonte dhe e përsëriti që nuk e dinte. Atij iu tregua deklarata e tij në polici ku ai kishte thënë që nuk dinte kush i solli bashkëpunëtorët në zyrë, por mund të ketë qenë policia ushtarake dhe pyetja e mëposhtme i është bërë atij nga prokurori, “Pse do t’i thonit policisë në atë kohë që mund të ketë qenë policia ushtarake dhe ju jeni kaq i sigurtë tani? Apo kjo e gjitha ishte e imagjinuar? Përgjigjja e tij është që madje edhe në atë kohë nuk e ka ditur nëse një forcë policore ushtarake është themeluar ose jo. Ai nuk ishte në dijeni nëse UÇK-ja ka ndërmarrë ndonjëherë ndonjë akt ndëshkues ndaj bashkëpunëtorëve. Ne Maj dhe Qershor te vitit 1998, ai nuk dinte asgjë rreth anëtarëve të njësisë së Drenovcit që paraburgosnin civilë në dhe rreth Drenovcit.

Ai ishte shumë afër G. P. një shok shumë i ngushtë ashtu si dhe bashkë luftëtarë me të cilët ai erdhi nga Shqipëria në Kosovë. Ai u pajtua që duke ditur natyrën e kauzës për të cilën ushtria e UÇK-ës po luftonte në atë kohë, marrja në pyetje e të dyshuarve bashkëpunëtor të Serbëve ishte një element shumë i rëndësishëm i luftës së UÇK-së. Ku ai është pyetur, duke ditur marrëdhënien e tij te ngushtë me G. P., nëse ai po i tregonte gjykatës që G. P. nuk e ka përmendur kurrë këtë aspekt të rëndësishëm atij, ai u përgjigj “Unë nuk kam thënë që ai kurrë nuk e ka përmendur atë, ai ma ka përmendur mua atë. Sidoqoftë, nëse do t’i kthehem natyrës së mënyrës sesi unë ia shpjegova këtë çështje dje prokurorit Publik, në mënyrën që bashkëpunëtorët emrat e të cilëve ai nuk m’i përmendi dolën vullnetarë për të dhënë informacion me vullnetin e tyre të lirë. Dhe secili nga ata, duke konsideruar politikën e UÇK-së, ishte objekt i edukimit nga UÇK-ja, me qëllim që t’i bënin ata të punonin për njerëzit e tyre. Kështu e kam marrë informacionin. Sidoqoftë, ne kurrë nuk kemi folur specifikisht sa i përket ndonjë emri ose ndonjë rasti të caktuar si ky”. Ne rastet e rralla që G. P. mendohet të ketë folur rreth marrjeve në pyetje ai nuk përmendi ndonjë emër për këtë çështje të veçantë, por ai përmendi emrat e shokëve të tij.

Rrethanat e zhdukjes ashtu siç përshkruhen nga disa dëshmitarë

Rrethanat e zhdukjes së Sh. Sh. ashtu siç përshkruhet nga H. M. nuk mund të dyshohen. Të dy dëshmitarët H. M. dhe F. H. deklaruan që Sh. Sh. nuk është

lejuar që të kthehet me ata pas udhëtimit të tyre me atë për në Drenovc. Pjesa e rëndësishme e dëshmisë së H███M███ është fakti që një ushtar i tha atij: “ ju shkoni në shtëpi tani për këtë është një individ shumë i rëndësishëm ndoshta shumë me i rëndësishëm se ju” dhe dëshmitari atëherë u largua. Sipas M███Sh███ gruas së Sh███Sh███ H███M███ pati thënë asaj që ai mund të largohet por Sh███ do të duhej të qëndronte mbrapa. Babai i Sh███Sh███ R███Sh███ kishte parë makinën e Sh███Sh███ në Drenovc ku ai shkoi të kërkonte djalin e tij dhe një person që ai nuk e njohte i tha atij që Sh███ ishte atje.

Dëshmitari anonim “A” pa B███B███ në një zonë malore ku ai/ajo ishte dërguar pasi ishte paraburgosur dhe ai/ajo pa gjak në faqen e B███. Atij/asaj i është dorëzuar një bluzë me gjak e Bedrisë që ai/ajo e identifikoi në gjykatë. Kjo është konfirmuar nga dëshmitari Anonim “B” në gjykim.

Dëshmitari anonim “B” deklaroi që me 3 Qershor 1998, ushtarët e UÇK-së me veshje të ushtrisë në ngjyrë të gjelbër erdhën në shtëpine e vëllait të tij/saj, dhe ata hapën zjarr në ajër tre herë. Kur B███B███ doli jashtë shtëpisë dhe bëri të ditur identitetin e tij, ata i thanë atij që duhet t’i shoqëronte ata në shtab. B███ i pyeti ata nëse ai duhej të merrte makinën e tij. Por ata u përgjigjën negativisht dhe thanë që kanë makinën e tyre. Atëherë ata e dërguan B███ në Drenovc. Dëshmitari “B” shpjegoi që njerëzit kane panë B███ në Ratkovac për dhjetë minuta dhe me pas është dërguar në Drenovc. Në Ratkovac, B███B███ i është thënë nga njerëzit që ata e morën ta dërgonin në Drenovc. Ditën tjetër në orën 6:00 në mëngjes dëshmitari u drejtua për në shtab në Drenovc dhe kërkoi B███. Atij/asaj iu tha që B███ do të mbahej për dy orë ose dy ditë dhe atëherë do të lirohej. Dëshmitari atëherë u kthye në fshatin e tij/saj në Bresje/Brestovac. Dëshmitari shkoi atje disa herë për të kërkuar B███. Ai/ajo pa B███ me 13 Korrik 1998.

Dëshmitari anonim “TT” përkroi rrethanat e zhdukjes së H███K███ dhe konfirmoi datën pas rifreskimit të kujtesës së tij/saj. Dëshmitari “TT” pa H███K███ në atë që ai/ajo quan burg, më saktë në një dhomë lart sipër burgut, për 15 minuta.

Dëshmitari anonim “N” deklaroi që Agron Krasniqi, Z███B███ dhe një person erdhi me 4 Qershor 1998, dhe e morën H███K███. Ai/ajo shkuan të kërkonin për atë me dëshmitarin anonim “TT” dhe ishte ky i fundit që e bëri bisedën. Dëshmitari anonim “TT” i foli Isuf Gashit, atëherë Selim Krasniqi dhe Bedri Zyberaj. Dëshmitarët “N” dhe “TT” përsëri shkuan në Drenovc në një ditë tjetër. Ishte një komandant i quajtur Zaim Krasniqi dhe dikush i quajtur Paqarizi. Ata janë lejuar që të shohin Hysen Krasniqin. Vizita zgjati rreth njëzet minuta. Dëshmitari anonim “TT” organizoi për dëshmitarin “N” për të vizituar H███K███ dhe leja për vizitë është dhënë nga G███P███.

Ditën pas rrëmbimit të Bedri Berishës me 3 Qershor 1998, Dëshmitari anonim “A” shkoi në Drenovc për ta kërkuar atë. Kur ai/ajo arriti në Drenovc disa ushtarë e arrestuan atë dhe e dërguan në një bodrum ku ata burgosnin njerëzit. Ai/ajo është mbajtur atje për tre ditë dhe më pas është liruar. Gjatë tre ditëve të para të qëndrimit të tij/saj në atë vend, nuk ishte askush atje.

Dëshmitari gjithashtu identifikoi H███P███, nga fotografia numër 3, prova B dhe deklaroi që ishte i njëjti person që ai/ajo kishte parë kur ai/ajo ishte në paraburgim dhe shtoi “bazuar në

kujtesen time më të mirë ishte i njëjti person por e kujtoj kur e kam parë atë në atë kohë ai ishte i mbuluar me gjak”.

Ndërsa i mbajtur në Drenovc, dëshmitari anonim “E” dëgjoi rreth H■■■■ P■■■■ dhe H■■■■ D■■■■. Ky i fundit u largua gjithashtu dhe nuk u kthye më. Por ndërsa dëshmitari anonim “E” ishte në bodrum në Drenovc, asnjë nga njerëzit që e mbanin atë në paraburgim nuk e përmendi emrin e H■■■■ P■■■■ ose H■■■■ D■■■■, ose emri i ndonjë të paraburgosurit tjetër atij/asaj. Ishin 20 persona të tjerë të paraburgosur gjithashtu. Ata ishin nga Bestovac, Drenovc, dhe Senovc dhe nga fshatrat e tjerë. Ai/ajo i njeht të gjithë ata por ai/ajo përmendi pak emra dhe njëri nga ata ishte Murati.

Meqë dëshmitari “E” kishte deklaruar që ai/ajo nuk mund të shikonte asgjë nga paraburgimi, ai/ajo u pyet sesi u vu në dijeni për praninë e të paraburgosurve të tjerë dhe si ai/ajo mund të përmendte emra të caktuar. Dëshmitari dha shpjegimin e mëposhtëm: “ishin njerëz nga fshatrat e tjera në paraburgim por unë nuk i kam njohur ata, si mund të them gjëra për njerëz të cilët unë nuk i njoh” dhe shtoi “Unë kam dëgjuar që shumë njerëz janë mbajtur në paraburgim dhe ishin gjithashtu njerëz që nuk i kam njohur”.

Përmes provave të dëshmitarit anonim “E” duket të jetë kontradiktore Gjykata e konsideroi që ky dëshmitar dëshmonte ngjarjet që ai /ajo dëgjoi dhe kuptoi ndërsa ishte në burg në rrethana të vështira. Trupi i gjykues nuk kishte arsye që të dyshojë provat të dhëna nga dëshmitari në lidhje me tre viktimat, që do të thotë H■■■■ P■■■■, H■■■■ D■■■■ (do të thotë nga Denje) dhe M■■■■. Kur dëshmitari deklaroi “kishte njerëz nga fshatrat e tjera në paraburgim por unë nuk i njihja ata, si mund të them gjëra rreth njerëzve që nuk i njoh, “ishte e qartë që ai/ajo po shpejgonte në një mënyrë të ndershme çfarë ai/ajo ka parë në vërtetë. Ky shpjegim spontan i shtuar kredibilitetit të dëshmitarit. Prova u konsiderua si e besueshme për të vërtetuar prezencën e H■■■■ P■■■■, H■■■■ nga D■■■■ dhe M■■■■ në qendrën e paraburgimit.

Dëshmitari “Z” dha rrethanat e zhdukjes së H■■■■ P■■■■ dhe madje shkoi të kërkonte për atë. Dëshmitari anonim “Z” takoi të pandehurin B■■■■ Z■■■■, që i tha dëshmitarit të shkojë në polici. Në një rast kur ata shkuan atje, një Rrezik tha që “kushdo mund të shkojë dhe të shohë H■■■■”, por Bedri Zyberajn tha, “Ata mund të shohin H■■■■ por H■■■■ nuk mund t’i shohë ata”

Pasi lanë Bedri Zyberajn dëshmitarin dhe një shok shkuan te shkolla e vjetër ku stacioni i policisë ishte dhe ata takuan me Selim Krasniqin që kishte të veshur një uniforme ushtarake dhe kishte një thikë në brez. Ai/ajo konfirmoi që ai/ajo kishte thënë si më poshtë vijon gjyqtarit hetues: “ I■■■■ B■■■■ na tha që A■■■■ K■■■■ dhe R■■■■ janë ata që janë marrë me keqtrajtimin dhe rrahjen, nëse një gjë e tillë është bërë”. R■■■■ tha që H■■■■ ishte në duart e policisë por nuk dha asnjë arsye për këtë dhe dëshmitari as që ka pyetur për asnjë gjithashtu. Dëshmitarit i është kujtuar dëshmia dhënë gjyqtarit hetues që Rrezik erdhi dhe tha “H■■■■ nuk ka bërë asgjë të gabuar por nëse ju sillni N■■■■ P■■■■ mund të merrni H■■■■ në shtëpi që tani”. Dëshmitari u pajtua që ai/ajo kishte thënë kështu dhe shpjegoi “ gjithçka që thashë në atë kohë do ta perseris edhe njëherë por ka kaluar një kohë e gjatë që atëherë dhe ndoshta unë kam harruar dy gjëra”.

Ne atë kohë dëshmitari pa H■■■■ P■■■■, duart e tij ishin të lidhura ose me pranga nga mbrapa kur po e dergonin te Rreziku dhe Selim Krasniqi ishte pas tij. Edhe pse dëshmitari pa H■■■■ P■■■■ nga një distancë 50 ose 60 metra ai/ajo vuri re që “shprehja e tij e fytyrës nuk ishte mirë”. Në një rast dëshmitari shkoi që të japë një urë dhëmbësh të riparuar H■■■■ P■■■■ dhe pa të pandehurin Selim Krasniqi përsëri.

Dëshmitari takoi Z■■■■ B■■■■ dhe Selim Krasniqi me 12 ose 13 Qershor 1998. Kur dëshmitari shkoi në vendin e kooperativës, ai kërkoi të shikonte shefin e policisë, ata i thanë atij që ai nuk ishte atje dhe të priste poshtë. Në të njëjtën kohë Selim Krasniqi mbërriti me një BMË në ngjyrë të bardhë dhe shkoi lart. Personat të cilët dëshmitarët besuan që ishin oficerë të policisë informuan Selim Krasniqin që dëshmitari po priste poshtë dhe Selim Krasniqi zbriti poshtë dhe dëshmitari e pyeti atë për H■■■■ P■■■■. Selim Krasniqi tha që disa njerëz nga shtabi ishin atje në ditën e mëparshme dhe që ata ishin duke pritur të merrnin informacionin. Atij/asaj i është thënë nga Selimi që të gjithë të burgosurit nga Drenovci i kanë dërguar në Malishevë.

Dëshmitari anonim “D” shkoi të kërkonte H■■■■ P■■■■ dhe pa Selim Krasniqin që i tha i atij/asaj se ai nuk dinte asgjë rreth fatit të H■■■■ P■■■■. Dëshmitari atëherë e përsëriti se ai/ajo do ta kërkonin H■■■■ P■■■■ përmes Kryqit të Kuq. Selim Krasniqi i tha tij/asaj të shkonte dhe dëshmitari u largua. Në kohën që ai/ajo pa Selim Krasniqin, ky i fundit kishte të veshur një uniformë me emblemën e UÇK-së në krah dhe në kasketë, dhe ai mbante një kallashnikov.

Dëshmitari E■■■■ Rr■■■■ pa të pandehurin A■■■■ K■■■■ dhe një Z■■■■ B■■■■ që rrëmbyen M■■■■ Rr■■■■. Kur u pyet pse ai nuk dëshmoi në deklaratën e mëparshme që ai i kishte parë këta persona, ai shpjegoi: “Kur unë dëshmova në 2004 mua më thanë që ishte një dëshmitar tjetër lidhur me M■■■■ dhe më është thënë që nuk është nevoja për ju të dëshmoni”. Trupi gjykues nuk kishte arsye të besonte që dëshmitari shpikte prova. Është mjaft natyrale për një dëshmitar t’i përgjigjet pyetjeve që janë bërë nga ai/ajo. Ashtu siç është treguar edhe nga ICTY³²⁰. Është bërë e njour që “qëndron në natyrën e procedurave penale që një dëshmitari mund t’i bëhen pyetje të ndryshme ne gjykim nga ato që i janë bërë në intervistat e mëparshme dhe që ai kujton detaje shtesë kur pyetet me specifikisht ne gjykate³²¹”

Nga ora 4:00 në të njëjtën ditë dëshmitari dhe xhaxhai i tij/saj N■■■■ dolën jashtë për të kërkuar për atë. Ata shkuan në zyrën e zonës. Atje ata pyetën Z■■■■ B■■■■ rreth M■■■■ dhe ai u përgjigj, “Ai është mirë dhe hetimet janë në proces”.

Me 11 Qershor ata dolën jashtë të kërkonin M■■■■ edhe një herë. Ata shkuan të kooperativa dhe atje panë Bedri Zyberajn që ishte Komisar Politik. Kur dëshmitari H■■■■ Rr■■■■ e pyeti Bedri Zyberajn rreth babait të tij, Bedri Zyberaj i tha atij, “Çdo person pesëdhjetë vjeç e lart, është për t’u mbajtur përgjegjës”.

³²⁰ Fatmir Limaj et al, gjykimi gjyqesor, 30 Nentor 2005, Rasti nr. IT-03-66-T

³²¹ ibid, paragrafi 1112(citohet Gjykimi i Naletilic, paragrafi 10)

Në praninë e H [REDACTED] Rr [REDACTED] N [REDACTED] i tha Bedri Zyberajt, “Çfarë bëri ai person, pse e keni marrë atë”. Bedri Zyberaj u përgjigj “Gjatë 1992 ju më thatë, “mos guxo ta vozisësh traktorin në tokën time”. Djali i xhaxhait të dëshmitarit pati një grindje me fëmijët e Bedri Zyberajt. Ku i fundit shtoi “unë jam ai që mori babanë tënd, bëni atë që doni të bëni, tani largohuni.”

I panehuri Bedri Zyberaj deklaroi që ishte një fakt që dëshmitarët H [REDACTED] dhe N [REDACTED] erdhi njëherë të më shikonte mua në lokalet e kooperativës gjate verës së vitit 1998 dhe ata kërkuan që familjeve te tyre t’u jepej ndihme, që UÇK i ofroi atyre në atë kohë.

Dëshmitari H [REDACTED] Rr [REDACTED] shkoi të kërkonte për babanë e tij përsëri me 12 Qershori 1998, bashkë me N [REDACTED]. Ata sollën disa cigare dhe veshje për babain e tij M [REDACTED] dhe ia dhanë ato Islam Gashit dhe Z [REDACTED] B [REDACTED] që ishin në oborr të shkollës. Pasi e bënë këtë ata shkuan në shtëpi.

Atëherë Bedri Zyberaj i tha tyre “ M [REDACTED] Rr [REDACTED] është këtu, dhe po merret me ate, tani ju mund të dilni jashtë. Unë nuk kam kompetenca, jam këtu si mbikqyrës i magazinës dhe policia po merret me atë³²². Dëshmitari dhe H [REDACTED] shkuan të shikojnë Bedri Zyberajn për herën e dytë të nesërmen, te Premten. Ata edhe njëherë i thanë atij “Ne jemi ketu të mësojmë çfarë i ndodhi vëllait tonë, nëse ai është i vdekur ose gjallë dhe ku po e mbani atë”.

B [REDACTED] Z [REDACTED] i tha atëherë H [REDACTED], “ Gjatë 1992 ju nuk më keni lejuar që të përdor traktorin në tokën tuaj, dhe vëllai juaj dhe djali i xhaxhait kanë shqetësuar fëmijët e mij kur ata ishin në oborr. Për rrjedhojë unë isha i detyruar të kthehesha nga ajo copë tokë kështu që u futa në një livadh, u bllokova atje. Unë mezi e kam pritur ta shikoj këtë ditë, po e prisja këtë ditë, për këtë arsye unë kam marrë babanë tuaj, pra bëni çfarë keni për të bërë”.

B [REDACTED] B [REDACTED] u përgjigj, “Po, une i kam thënë vëllait tuaj sepse ai ishte këtu për të takuar sepse vëllai juaj punon në Sekretariat.”

Gjatë tentatives së dytë dhe të tretë për të gjetur M [REDACTED] dëshmitari vinte nga kooperativa kur ai pa Islam Gashin duke ardhur nga poshtë. Islam Gashi ishte oficer i policisë në zonë. Nën dritën e faktit që ai i tha gjyqtarit hetues që ai kishte parë Islam Gashin dhe Z [REDACTED] B [REDACTED] të ulur në karrike te shkallët e shkollës së vjetër, ai është pyetur të shpjegonte ku dhe kur ai në fakt pa Islam Gashin. Ai shpjegoi që ai mund të kishte keqkuptonte pyetjet e gjyqtarit hetues dhe që ai iu përgjigj pyetjes të gjyqtarit në përgjithësi.

Dëshmitari anonim “X” është arrestuar në Reti dhe është marrë nga shtabi i UÇK-së i vendosur në një shtëpi atje. Ai/ajo është pyetur nese ai/ajo bashkëpunoi me Serbët. Kur dëshmitari anonim “X” është pyetur nëse ai/ajo është rrahur gjatë paraburgimit të tij/saj, ai/ajo deklaroi që kjo nuk ka ndodhur. Ai/ajo mund të dëgjonte të tjerët që rriheshin, por nuk ka mundur të shikojë askënd që rrihej.

³²² Shih procesverbalin e gjyqimit të dëshmitarit H [REDACTED] R [REDACTED] 15 Dhjetor 2005, faqe 7

Dëshmitari anonim "X" i deklaroi gjyqtarit hetues, se me 10 Shtator 2004, që ai/ajo ishin rrahur dy herë në ditë kur ai/ajo ishin në bodrumin e shkollës në Drenovc. Dëshmitari anonim "X" i kishte gjithashtu thënë Gjyqtarit hetues që ai/ajo kishin parë M [REDACTED] të rrihej gjithashtu. Ai/ajo gjithashtu shpjeguan ndryshim të deklaratës në gjykim, Dëshmitari anonim "X" deklaroi "Unë ka mundësi që të kem harruar shumë gjëra që atëherë. Kaloi një kohë e gjatë. Nëse ma kujtoni mund të përmisoj veten".

Dëshmitari anonim sulmuesit do të rrihnin kurdo që i pëlqente atyre dhe që rrahja ndodhi një herë në ditë ose një herë në javë. Ai/ajo ishte në paraburgim për një muaj në dhomën e ndarë ndarazi nga të paraburgosurit e tjerë dhe pa dritare. Gjatë paraburgimit të saj/tij merrte ushqim rregullisht dhe i duhej të flinte mbi një copë dru sepse nuk kishte krevat.

Në lidhje me mospajtimet në dëshminë e dëshmitarit, Trupi gjykues ishte i mendimit që ato nuk e kanë ndikuar këtë dëshmi në mënyrë të disfavorshme. Është e qartë që dëshmitari po vuante nga gabime te kujteses dhe ai/ajo ishin të kthjellët në mënyrë të mjaftueshme dhe ai/ajo bëri një deklaratë të ndershme rreth gabimeve kur ai/ajo deklaroi: "Unë ka shumë mundësi të kem harruar shumë gjëra që nga ajo kohë. Ka kaluar një kohë e gjatë. Ndoshta nëse do ma kujtonit unë do përmisoja veten."

Në ditën që dëshmitari anonim "X" është sjelle në bodrum ku ai/ajo ishte në paraburgim, ai/ajo pa M [REDACTED] atje në të njëjtën dhomë. Dëshmitari anonim "X" nuk mund t'i jepte atij/asaj mbiemrin e tij. Dëshmitari mësoi nga të paraburgosurit që M [REDACTED] ishte nga Drenovci. M [REDACTED] dhe një i paraburgosur tjetër erdhën së bashku pas dhjetë ditësh. Ishte kohe ditë kur dëshmitari anonim "X" është dërguar në dhomë dhe ai/ajo mund t'i shikonte të dy ata. Dëshmitari përshkroi M [REDACTED] si një person 50 vjeçar, i shkurter dhe i ngjallur dhe e identifikoi atë nga fotografia me numer 8, prova materiale B.

Mbrojtja kërkoi të konstatohej mospajtimi në dëshminë e dëshmitarit anonim "X" për rrethanat në të cilat ky dëshmitar e pa M [REDACTED] Trupi gjykues nuk ishte i këtij mendimi. Dëshmitari anonim "X" po përpiquej vetëm që të jepte detajet e rrethanave dhe kjo nuk i pakëson vlerën dëshmisë qendrore që ai/ajo e kanë parë M [REDACTED] në Qendrën e paraburgimit.

Dëshmitari Z [REDACTED] T [REDACTED] shpjegoi rrethanat e rrëmbimit të H [REDACTED] T [REDACTED] dhe dëshmitari anonim "X" ka parë H [REDACTED] duke u rrahur kur ai/ajo është paraburgosur.

Pas rrëmbimit të A [REDACTED] B [REDACTED] dëshmitari M [REDACTED] B [REDACTED] shkoi të kërkonte atë dhe të takonte Bedri Zyberajn. Dëshmitari takoi Bedri Zyberajn sepse ishte një emër shumë i njohur dhe te gjithë do të thonin që ai ishte lideri. Ai e pyeti Bedri Zyberajn, "A do të ishte e mundur që të mësohej pse A [REDACTED] B [REDACTED] ishte rëmbyer dhe gjithashtu vendndodhja e tij?" në një moment Bedri Zyberaj i tha dëshmitarit që ai nuk ishte i vetmi që po merrej me këtë çështje por e informoi atë që ai duhej të shkonte në shkollë/ burg dhe e pyeti për Celikun, Selim Krasniqin. Bedri Zyberaj e dërgoi atë te Selimi Krasniqi sepse ky i fundit ishte burri me detyrë i policisë ushtarake".

Dëshmitari e pyeti Selim Krasniqin reth A ■■■ B ■■■. Ai u përgjigj: “ nuk është askush në Drenovc ata janë diku në Drenicë. Ne nuk mund t’i sjellim ata këtu duke ditur kushtet shumë të këqija të rrugës. Kjo është pse ata janë në Drenice”. Kur u pyet se çfarë donte të thonte me “ata” dëshmitari u përgjigj “doja të thoja që babi im ishte diku në Drenicë”. Dëshmitari vazhdoi t’i bënte pyetje të tjera Selim Krasniqit dhe ai u përgjigj “ unë nuk kam asgjë të ju them. Hajdeni nga fundi i javës me qëllim që të sqaroni disa gjëra. “ dëshmitari nuk mund të shkonte në fund të javës sepse paraushtarakët Serbë kishin filluar ofensiven e tyre dhe për rrjedhojë nuk mund të merrte një përgjigje për pyetjet e tij.

Dëshmitari anonim “X” është arrestuar në Reti dhe është dërguar në shtab të UÇK-së atje ku ai/ajo është dërguar ku është mbajtur për dy dite dhe atëherë është dërgur në bodrumin e ndërtesës së shkollës në Drenovc. Ndertesa e shkollës është zënë nga UÇK-ja. Ai/ajo është mbajtur në një dhomë me një dritare të vogël.

Dëshmitari anonim “E” është paraburgosur në Drenovc në vitin 1998 dhe ai/ajo përmendën mes të tjerash, emrat e të paraburgosurve të H ■■■ P ■■■ M ■■■ dhe H ■■■ D ■■■.

Dëshmitari është paraburgosur në një kazermë ku ai/ajo është takuar dhe marrë në pyetje nga i akuzuari Bedri Zyberaj. Isuf Gashi atëherë erdhi dhe i tha Bedri Zyberajt, “Pse po e merrnin në pyetje atë, më mirë ta likuidoni këtë horr, hiqeni qafe atë”. Dëshmitari ishte vetëm atëherë. Bedri Zyberaj e akuzoi atë të ishte spiu i Serbëve. Isuf Gashi i tha atij/asaj “Ju po spiunoni kundër UÇK-së dhe ju po punoni për Serbët”. Ai/ajo është marrë në pyetje vetëm një herë.

Kur dëshmitari është kërkuar të shpjegojë të gjitha mospajtimet dhe mospërputhjet në dëshminë e tij/saj dhe kur është pyetur nëse ai po gënjente ose mashtronte Gjykatën, ai/ajo u përgjigj “Unë nuk jam këtu të gënjej gjykatën por të them të vërtetën” dhe “Unë e di çfarë kam thënë është e vërtetë dhe jam një person analfabet kështu që nuk kam mundur të marr shënime pra të mbaja mend gjërat më mirë”. Trupit gjykues i konsideron mospajtimet në prova të këtij dëshmitari, veçanërisht për atë, mes Bedri Zyberajt dhe Isuf Gashit, kishin kërcënuar atë dhe si ai/ajo e mori vesh nofken e Selim Krasniqit që ai tha që është Celik.

Trupi gjykues i kushtoi kujdes këtyre çështjeve. A po bënte dëshmitari gabim? A ishte ai/ajo konfuz? Apo ai/ajo po përpiqej të sillte në detaje atë që ai/ajo mund të kishte dëgjuar nga hera e fundit kur ai/ajo kishte dëshmuar? Dëshmia e dëshmitarit është kqyrur me kujdes në kontestin e provave të tij/saj të përgjithshme. Dëshmitari ra në kundërshtim me vetveten për çështje të tjera, më hollësisht nëse ai/ajo ishte rrahur; një çështje e cila shpjegohet më poshtë.

Trupi gjykues i atribuon këto gabime kalimit të kohës, dështimeve të kujtesës dhe analfabetizmit. Pas një analize të hollësishme të provave dhe gjykimit nga sjellja e tij/saj, që do të mund të merrej vetëm përmes zerit të tij/saj sepse ai/ajo ishte një dëshmitar anonim, Trupi gjykues formoi një opinion që dëshmitari po fliste të vërtetën dhe nuk ishte as duke shpikur asgjë as duke thënë gënjeshtër. Trupit gjykues konsideron që ky dëshmitar është me të vërtetë analfabet. Ai/ajo ishte, si në ratin e të gjithë dëshmitareve të tjerë, duke dëshmuar për ngjarjet që ndodhen në vitin 1998. Gjithashtu, Gjykata konsideron që, përveç faktit që ai/ajo është mbajtur dhe rrahur në paraburgim, ai/ajo arriti të jepte një llogari koherente të ngjarjeve që ai/ajo ka përjetuar.

Agron Krasniqi dhe Z. K. shkoi në fshatin e tij/saj dhe morën Dëshmitarin anonim “U” në shtabet ushtarake në Drenovc. Agron Krasniqi përdori një shkop për të rrahur atë, ndërsa Z. K. përdori një tub metalik të gjatë 60 cm. Dëshmitari deklaroi që ai/ajo është rrahur për gjysëm ore. Më vonë ai/ajo deklaroi që ai/ajo ishte marrë në pyetje për 40 minuta nga Selim Krasniqi dhe rrahur për 15 minuta. Ai/ajo është rrahur një herë nga Agron Krasniqi. Pas ai/ajo është rrahur dhe derguar përsëri në zyren e Selim Krasniqit dhe ky i fundit i tha atij/asaj, “nëse diçka tjetër do të ndodhe ne do të heqim qafe” dhe ai/ajo është liruar. Selim Krasniqi morën në pyetje dëshmitarin në shtabin ushtarak në Drenovc nëse ai/ajo kishte lidhje me ushtarët e UÇK-së dhe ai e pyeti dëshmitarin pse nuk kishte lidhje të mira me atë ushtar. Ai atëherë urdhëroi dy ushtarët e UÇK-ës për të rrahur dëshmitarin. G. P. ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje.

Dëshmitarit i është kujtuar që me 6 Gusht 2004, ai/ajo i tha gjyqtarit hetues që ai/ajo është marrë në pyetje për katër orë, ndërsa në gjykatë ai/ajo deklaroi “bazuar në kujtesën time më të mirë marrja në pyetje mori 40 minuta. Kjo nga shenimet që kam mbajtur për marrjen në pyetje”. Ai nuk pranoi të jepte shënimet nga frika e zbulimit të identitetit të tij.

Marrja në pyetje ndodhi me 16 Qershor 1998. Kur atij/asaj ju kujtua që ai/ajo i kishte thënë gjyqtarit hetues që ndodhi me 16 Korrik, ai/ajo dha datën 12 Qershor dhe pas konsultimit me shënimet e tij/saj ai/ajo përsëriti ishte me 16 Qershor. (Trupi gjykues i pa shënimet; ishte data 16 Qershor e shkruar në ato dhe një datë tjetër është fshirë. Ky fakt ishte komunikuar të gjitha palëve.)

Kishte dy mospajtime në dëshminë e këtij dëshmitari, më hollësisht datën kur ai/ajo është marrë në pyetje dhe kohëzgjatjen e marrjes në pyetje. Pa dyshim, dëshmitari bie në kundërshtim me vetveten për këto çështje. Trupi gjykues është i mendimit që nëse dëshmitari sinqerisht bën një gabim, dhe me ndershtetëri e korrigjon atë gjatë zhvillimit të dëshmisë së tij/saj, kjo nuk duhet të ndikojë në mënyrë të disfavorshme për dëshminë e dëshmitarit.

Dëshmitarit anonim “E” i është thënë nga një anëtar i familjes që ai/ajo duhej të shkonte në Drenovc. Kur ai/ajo shkoi atje “ata” i thane asaj/atij “hyr brenda trathtar”, dhe ata i thanë asaj/atij që ai/ajo kishin lidhje me Serbët. Dëshmitari e mohoi këtë. Ai/ajo e sqaroi këtë kur ai/ajo përdori fjalën “ata” ai/ajo po i referohej Selim Krasniqit. Biseda u bë në katin perdhës të ndërtesës që është përdorur si qendër e paraburgimit.

Selim Krasniqi e goditi atë në hundë dhe ai/ajo ra përdhe nga karrigja ku ai/ajo ishte. Selim Krasniqi i tha asaj/atij “Unë u inatosa me fjalët e tyre kur me thanë që i ke dhënë Serbeve si mish të gjallë edhe të vdekur, dhe kjo do të thotë që i ke shërbyer gruan tuaj atyre dhe i keni dhënë atyre diçka për të ngrënë”. Atij/asaj i është rënë me shuplakë vetëm një herë. Atij/asaj i doli gjak dhe mori një shami për ta fshirë.

Gjatë takimit me Selim Krasniqin, ai e pyeti dëshmitarin për lidhjen farefisnore që kishte ai/ajo me H. K.

Konstatimet për çështjet e torturës dhe trajtimit çnjerëzor

Është parashtruar nga prokuroria që të gjitha elementet e torturës ishin të pranishme.

Gjate hetimeve dhe gjykimit kryesor, një numër i dëshmitareve të prokurorisë dëshmuar për rrethanat e tyre të rrembimit nga vende të ndryshme, në rrethinat e Drenovacit dhe për trajtimin që ju është bërë.

Edhe pse provat e kombinuara të këtyre dëshmitareve përcaktojnë ekzistencën e një regjimi ndeshkues si dhe mbajtje në një ambient jo njerëzor, gjykata nuk është bindur që këto akte përbenin torturë. Një nga kushtet paraprake të torturës është shpaktimi i një vuajtje e jashtëzakonshme. Natyra e të rrahurave, kushtet e mbajtjes (ndalimit) me pasoja lëndime, sipas mendimit të Trupit Gjykoës nuk arrijnë të hyjnë në veprime të rënda dhe vuajtjet e kërkuara për torturë sic janë shpjeguar në jurisprudencën e ICTY.

Nga ana tjetër Trupi Gjykoës nuk kishte dyshim që trajtimet subjekt i të cilave janë bërë të mbajturit janë zbatuar me një mosperfillje serioze ndaj të drejtave të tyre themelore (të të mbajturve) dhe në mënyrë kaq degraduese dhe poshtuese, që hapur tregojnë se të drejtat e të mbajturve për trajtim human janë shkelur. Se bashku me veprime të tjera kryera gjatë luftës gjatë periudhës kritike, këto kanë përbërë sigurisht veprime mizore apo jo njerëzore.

Në çfarëdo lloji mënyre që këto rrembime apo mbajtje janë bërë, del që ato janë “*ab initio*” (“që në fillim”) të paligjshme duke patur parasysh faktin që janë të pajustificuara dhe të pa arsyeshme.

Pjesmarrja e të akuzuarve në veprat penale

A janë identifikuar/njohur si duhet të pandehurit?

Dëshmitarët i identifikuan të pandehurit nga një rreshtim pamor i fotografive

Dëshmitari M [REDACTED] B [REDACTED] pasi ka përshkruar të akuzuarin Selim Krasniqi e identifikoi atë rreshtimi pamor i fotografive, Provat C.

Dëshmitari Anonim “A” e përshkroi Selim Krasniqin si një njeri të moshës mesatare, as të shëndoshe e as të hollë, me trup të beshëm, dhe përafërsisht 170 - 175 centimetra i gjatë (edhe pse përpara Gjyqtarit Hetues ai kishte përmendur 183 centimetra). Kur atij i treguan rreshtimin pamor të fotografive Prova C, dhe pyeten nëse ajo/ai mund të identifikonte ndonjë nga personat e treguar dëshmitari tha “Vertet nuk mund të shikoj aq mirë dhe si rrjedhojë nuk jam në gjendje të identifikoj ndonjë nga personat të treguar në Proven C. Ajo/ ai sidoqoftë konfirmoi që ajo/ai kanë identifikuar si duhet personat përpara gjyqtarit hetues pasi të parit e tij/saj ka qenë me mirë në atë kohë.

Dëshmitari Anonim “D” e identifikoi Selim Krasniqin në rreshtimin pamor të fotografive, foto 8, prova C.

Deshmitari Anonim "TT" e identifikoi Selim Krasniqin ne rreshtimin pamor te fotografive, foto 8, prova C.

Deshmitari M [REDACTED] B [REDACTED] pas pershkrimit te te akuzuarit Bedri Zyberaj, e identifikoi at ne rreshtimin pamor te fotografive, Prova C.

Deshmitari N [REDACTED] Rr [REDACTED] tha se ai dhe Bedri Zyberaj jane te te njejtës moshe dhe se e ka njohur ate qe ne shkollen fillore. Ai shtoi se Bedri Zyberaj eshte pak me floke te rena perpara. Ai e identifikoi Bedri Zyberajn ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 16, Prova C.

Deshmitari Anonim "B" e pershkroi Bedri Zyberajn si te shkurter, jo edhe aq te gjate, me fytyre ne forme te rrumbullakosur dhe me tipare pak te erreta dhe sa i perket moshës tha se ishte rreth 30 vjec. Ajo/ai nuk e ka njohur Bedri Zyberajn personalisht perpara dates qe ajo/ai e takuan ate. Deshmitari eshte prezantuar me rreshtimin pamor te fotografive (Prova C) dhe ajo/ai treguan fotografine 15 ose 16 si fotot qe tregonin Bedri Zyberajn. Deshmitari gjithashtu ka identifikuar Bedri Zyberajn perpara policise dhe se e kishte pare ne TV tre ose kater here.

Deshmitari Anonim "D" identifikoi Bedri Zyberajn ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 16, Prova C.

Deshmitari Anonim "E" e pershkroi Bedri Zyberajn te gjatesise mesatare, pa floke dhe jo te shendoshe. Shtoi se ai/ajo nuk e di se si duket tani Bedri Zyberaj pasi ai/ajo nuk e ka pare ate per 6 vjet.

Deshmitari nuk e njihte Bedri Zyberajn perpara se ai/ajo ta kete takuar, e pershkroi pa floke, pak te shkurter dhe ka mundesi te jete 40 vjec ose me teper. Ajo/ai e identifikoi Bedri Zyberaj ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 16, Prova C.

H [REDACTED] Rr [REDACTED] identifikoi te pandehurin Bedri Zyberaj te cilin e ka njohur qe kur kane qene femije. E pershkroi si pak te shendoshe dhe me pak floke te rena perpara kokës dhe ai pershkirm ishte i qendrueshem me pamjen e te pandehurit.

Deshmitari Anonim "TT" e pershkroi Islam Gashin te gjate me floke te zeza dhe e identifikoi te pandehurin rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 27, Prova C.

Deshmitari N [REDACTED] Rr [REDACTED] e pershkroi Islam Gashin me tipare te erreta, fytyre rrumbullake dhe 1.75 ose 1.80 metra te gjate. Deshmitari gjithashtu theksoi se Islam Gashi dhe ai ishin nga i njejti vend. Ai e identifikoi Islam Gashin ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 27, Prova C.

Deshmitari Anonim "TT" e pershkroi Agron Krasniqin si person qe nuk ishte dhe aq i gjate, te shkurter dhe te ri ne moshe. Ajo/ai e ka njohur Agron Krasniqin nga fshati i H [REDACTED] K [REDACTED] dhe ajo/ai e kane njohur ate perpara dites kritike. Deshmitari identifikoi Agron Krasniqin ne fotografine 2 ne rreshtimin pamor te fotografive (Prova C) si te njejtin person qe ka marre

H [REDACTED] K [REDACTED]¹⁹.

Agron Krasniqi eshte kusheriri i Deshmitarit N [REDACTED] K [REDACTED] dhe ata kane lidhje lidhje te aferta familjare³²⁰. Kur e pashe Agron Krasniqin ai kishte floke te zeza. Ai shtoi se eshte mesatar me trup dhe 1.65 i gjate. Ai e identifikoi Agron Krasniqin ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 2, Prova C dhe shtoi “nuk jam 100% i sigurte pasi nuk e kam pare per ca kohe, por mendoj se eshte ai”.

Deshmitari Anonim “N” e identifikoi Bedri Krasniqin ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 16, Prova C.

Deshmitari E [REDACTED] Rr [REDACTED] identifikoi te pandehurin Agron Krasniqi ne rreshtimin pamor te fotografive, fotografia 1, Prova C.

H [REDACTED] Rr [REDACTED] nuk e njohu Agron Krasniqin menjehere pasi ai nuk e njihte ate. Ai mesoi kush ishte Agron Krasniqi kur filluan bombardimet dhe kur fshataret ishin te detyruar te largoheshin nga fshati i tyre per Dejne. Ai nuk mund ta pershkruante Agron Krasniqin pasi ishte e veshtire pas shtate vjetesh dhe ai nuk e kishte pare ate per nje periudhe.

Ne te gjitha rastet Deshmitaret i kishin pare te pandehurit, te cilet ata identifikuan, njohen ne rreshtimin pamor te fotografive gjate gjykimit kryesor. Ka qene me teper proces njohjeje se sa identifikimi per here te pare. Sidoqofte Trupi Gjykues konsideroi paralajmerimin e ICTY-it lidhur me rreshtimin pamor te fotografive apo tregimin e fotografive per qellimin e njohjes apo identifikimit ne ceshtjen e prokurorise kunder Fatmir Limaj et al³²¹:

“nje shqetesim i caktuar me rreshtimin pamor te fotografive eshte se nje fotografia e te akuzuarit ne perdorim, mund te mos jete tipike ne ngjashmeri, edhe pse ka te regjistruara me saktesi tiparet e te akuzuarit, sic ato ishin ne ne nje moment te caktuar. Ne kete pike, gjykata, do te shtonte si faktore relevante, qartesine apo kualitetin e fotografise se te akuzuarit te perdorur ne rreshtimin pamor, dhe kushtezimet esenciale ne nje fotografi te vogel dy-dimensionale ne kontrast me me pamjen tri-dimensionale te personit ne realitet. Gjithashtu eshte faktor material nese deshmitari ka qene me pare i familjarizuar me subjektin e identifikimit, i.e. nese ai eshte “njeh” dike qe a ka te njohur nga me pare ose “identifikon” nje te panjohur. 26 ndersa gjykata nuk eshte e pergatitur te hedhe poshte identifikimin e bere me rreshtim pamor per nje apo me shume te akuzuar ne kete ceshtje, eshte perpjekur shume per te analizuar te gjitha rrethanat sic jane paraqitur ne prova, dhe qe potencialisht mund te ndikojne keto identifikime, koshiente per limitacionet dhe per jo-qendrueshmerine e mundshme e tyre dhe e ka vleresuar qendrueshmerine e ketyre identifikimeve me kujdes dhe vemendje te konsideruesheme. Ndermjet ceshtjeve gjykata pa me relevance te vecante per kete eksperience nese fotografia ishte e qarte mjaftueshem dhe nese i perputhej pershkrimet te te akuzuarit ne kohen e ngjarjeve, nese i akuzuari u shkri ne harmoni apo u dallua nga te tjeret , nese ka kaluar nje kohe e gjate nga koha e shikimit origjinal te te

³¹⁹ Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor Deshmitari Anonim “TT”, 17 Maj 2006, faqe38.

³²⁰ Shih Procesverbalin e Gjykimit Kryesor deshmitari N [REDACTED] K [REDACTED] 15 Shkurt 2006 faqe 9.

³²¹ Fatmir Limaj et al, ICTY aktgjykimi, 30 Nentor 2005, Ceshtja No. IT-03-66-T.

akuzuarit dhe identifikimit te rreshtimit pamor fotografik, nese identifikimi u be menjehere dhe me konfidence, ose perndryshe, nese ka patur mundesi per deshmitarin te familjarizohej me aparence e te akuzuarit pas ngjarjeve dhe perpara identifikimit, ky ose ne person ose permes mediave.³²²”.

Trupi Gjykues mori parasysh deshmime e deshmitarit anonim “E” lidhur me identifikimin e Selim Krasniqit duke pare disa kontradikta dhe mosqendrime nga deklaratat e tij/saj te meparshme. Ne deklaraten e dhene perpara Gjyqtarit Hetues, lidhur me pseudonimin e Selim Krasniqi, eshte pyetur si me poshte “*Destan Rukiqi (avokat mbrojtës):* a mund ti tregoni gjykates perseri me cilin emer njihej ai? “A”: ai nuk njihej si Selim Krasniqi. Ai njihej si Rrezik (qe ne anglisht perkthehet danger). *Destan Rukiqi:* atehere ate dite qe jeni ndalur nga B [REDACTED] B [REDACTED], e njihnit Selim Krasniqi vetem me emrin Rreziku? “A”:po. *Destan Rukiqi:* a eshte e vertete qe Rreziku ju goditi me pjesen e prapme te Kalashnikovit? “A”: nese keto nuk do ishin te verteta, atehere perse do denjoja te vija so te ketu”.

Nen driten e kesaj prove ajo/ai u kerkua qe te jepte qartesine te metejshme per pseudonimin e Selim Krasniqit dhe ai/ajo u pergjigjen “nuk me kujtohet cdo gje pasi nuk di te shkruaj e as te lexoj, dhe nuk jam i shkolluar”. Ne pyetje te metejshme ajo/ai tha se Selim Krasniqi ishte Celiku dhe se kur kishte thene Rrezik ishte gabim pasi nuk mund te mbante mend cdo gje.

Ne lidhje me prova te deshmitareve te tjere, kolegji vuri re se disa nga deshmitaret, thjesht kane deklaruar qe ata nuk mund te njihnin apo identifikonin dike pasi nje kohe e gjate ka kaluar. Per shembull, kur deshmitari anonim “A” u vu perpara rreshtimit pamor te fotografive Prova C dhe u pyet nese ai/ajo mund te identifikonte dike prej kesaj deshmitari u deklarua “une nuk shoh dhe aq mire dhe si rrjedhoje nuk jam en gjendje per te identifikuar ndonje nga personat ne Proven C. Ajo/ai sidoqofte konfirmuan qe e kishte konfirmuar drejt ate person perpara gjyqtarit hetues pasi ne ate kohe shikimi i tij/i saj ishte me mire.

Ne ceshtje te tjera deshmitaret deklaruan se edhe pse ata mund te identifikonin apo njihnin personin nga rreshtimi pamor i fotografive, perseri ata shprehen rezerva.

Ne rastin e deshmitareve te tjere Trupi Gjykues ishte i mendimit qe mirebesimi dhe sinqeriteti i tyre ishte tipar kyc i provave te tyre. Askush prej tyre nuk tentoi per te trilluar identifikimin. Secili prej deshmitareve ishte ne gjendje per te dhene nje pershkrim te mire te te pandehurve qe kishin pare. Sic u permend dhe me lart secili nga deshmitaret ka qene i sinqerte mjaftueshem per te shprehur rezervat apo pamundesine ne lidhje me identifikimin.

Format e pergjegjesise

Bashkepunimi (pjesmarrja)

Neni 22 i of the KP RFSJ mundeson, “nese disa persona se bashku kryejne nje veper penale duke marre pjese ne aktin e kryerjes apo ne ndonje menyre tjeter, sejcili prej tyre duhet te denohet sic eshte pershkruar per vepren penale”.

³²² Ibid, paragrafi 19.

Neni 22 deklaron te pergjegjshem penalisht individet qe ne menyre te perbashket kryejne veper penale duke marre pjese ne vepren e kryerjes apo ne ndonje menyre tjeter. Sipas Neni 22, bashkepunimi (pjesmarrja) egziston thjesht kur disa persona marrin pjese ne ne aktin e kryerjes se krimi dhe kur egziston akti i vetedijes dhe deshires i lidhjes me keta pjesemarres me qellim per te kryer sebashku nje detyre te caktuar. Pjesmarrja dhe qellimi si rrjedhoje jane faktoret kyc ne percaktimin e fajesise per ndonje krim. Si rrjedhoje, cdo lloj aktiviteti i nje pjesemarresi te vetem mund ta beje ate bashkepunetor, nese kryerja ndodh brenda kufijve te performances se perbashket, dhe nese nje pjesemarres provon deshiren dhe qellimin per kryerjen e nje detyre te tille.

Komentaret theksojne “pjesmarrja egziston kur disa njerez marrin pjese ne aktin e kryerjes se krimi. Si rrjedhoje pjesmarrja ehste nje akt koshient dhe deshire per tu lidhur me pjesemarres te tjere, me qellim per te pembushur sebashku nje detyre te caktuar. Nje situat e tille egziston kur disa persona qe permbushin te gjitha kushtet –kerkesat sipas aktorit kryesor te nje detyre te caktuar dhe bien dakort sebashku qe te veprojne si pjesemarres.”³²³. nje pjesemarres me tej eshte pershkruar si dikush qe bashke me te tjeret, kryen vepren e vendosur me nje rol te rendesishem ne procesin e performances se detyres (kriminale). Fakti qe ai eshte pjesemarres i nje vendimi te tille dhe pjese e ketij procesi te realizimit – ne menyre decizive e ben ate pjesemarres te vepres, pasi si rrjedhoje ai eshte ne pozite –qe bashke me nje person tjeter – te mbaje vepren e pjesmarrjes ne duart e tij, psh te kete autoritet (te kete te veten) mbi vepren penale”³²⁴.

Pjesmarrja i kerkon te dy elementet – ate subjektiv dhe objektiv.

Objektivisht, provat dhe deshmit e ne ceshtjen aktuale demonstrojne nje kordinim shume te mire te veprimeve kunder viktimave, ku i njeiti grup individesh ka marre pjese rregullisht, ne nje forme apo ne nje tjeter, ne kryerjen e krimeve te ngarkuara.

Ndersa nuk ka prova direkte te pjesmarrjes se te pandehurve ne nje vendim formal per te arrestuar, ndalur, rrahur apo trajtuar viktimat ne menyre jo humane, ka prova te mjaftueshme nga rrethanat per te konkluduar qe ka patur nje qellim te perbashket nga nje grup i UCK-se se Dranovcit, per te arrestuar dhe ndalur anetare te popullates civile, dhe me pas te derguar ne shtabin e UCK-se, apo ne qendren e ndalimit ne Drenovac, ku ata jane keqperdorur.

Provat tregojne qe trajtimi i rende dhe qe kane duruar viktimat, ka qene produkt i nje metode te rregullt dhe te organizuar qe kishte te bente me individe qe dyshoheshin nga UCK-ja si bashkepunetore te Serbeve.

Per me tej, nuk ka dyshim qe ne Dranovc ka patur qender ndalimi. Kohe pas kohe deshmitaret kane deshmuar qe ose jane mbajtur ne Dranovc ose ne ndertesen e shkolles se vjeter ose qe kane shkuar atje ose ne shtabin e UCK-se per te kerkuar te ndaluarit. i akuzuari Selim Krasniqi, ndersa ka mohuar dijeni per qendren e ndalimit theksoi se UCK-ja e ka okupuar ndertesen e shkolles se vjeter. Ai i tregoi gjykates se ka pare ne oborrin e shkolles se vjeter H

³²³ Lubjsa Lazarevic, Komentaret ne Kodin Penal te RFJ, 1995, Neni.22

³²⁴ Lubjsa Lazarevic, komentaret ne Kodin Penal te RFJ, 1995, Neni.22

K[REDACTED] Ai kishte degjuar per H[REDACTED] P[REDACTED]

Subjektivisht, ka mjaft prova per te perfshire te gjithë te akuzuarit direkt dhe jo- direkt ne akuzen e pjesmarrjes permes pjesmarrjes se tyre te vullnetshme ne ngjarje. Deshmitaret deklaruan qe te kene pare te njejtin grup personash te perfshire ne ose/dhe arrestime, ndalime, ose rrahje. Ne keta persona perfshihen: Agron Krasniqi, Z[REDACTED] B[REDACTED], Selim Krasniqi (I njohur edhe si Celiku), G[REDACTED] P[REDACTED] i nohur edhe si Reziku, Xh[REDACTED] G[REDACTED] Islam Gashi, Bedri Zyberaj dhe I[REDACTED] B[REDACTED].

Provata e deshmitareve sa i perket pjesmarrjes se te akuzuarve dhe perfshirjes se tyre ne krime, percakton dijeni nga ana e te akuzuarve qe e krimet e kryera jane kryer, po ashtu edhe pjesmarrja, direkte apo jo direkte, ne krimet e ndaluara. Trupi Gjykes gjeti se eshte porvuar qe te pandehurit kane vepruar ne bashkepunim sic eshte percaktuar ng Neni 22 i KP RFSJ.

Ndihma

Kjo eshte menyra e dyte e pjesmarrjes e theksuar ne aktakuze. Teoria e “ndihmes” egziston ne ligjin anglo-sakson dhe ne ligjin civil te juridiksionit lokal , si dhe ne ligjin nderkombetar. Ndihma (dhe mbeshtetja) fillimisht perfshin qe i akuzuari nderrmerr veprime ne vecanti per te ndihmuar, inkurajuar apo te jape ndihme morale ne kryerjen e krimet. Si ne rastin e bashkeveprimit duhet te jete kusht subjektiv dhe objektiv. Elementet e nevojshem si nga ligji aplikues ne Kosove dhe nga juridiksionet e tribunaleve nderkombetare Ad Hoc (ICTY dhe ICTR) jane te njejta.

Nuk kerkohet ndonje plan para-egzistues apo marreveshje per tu angazhuar ne vepren criminale ne fjale. Sidoqofte veprimet e te akuzuarve duhet te kene sidoqofte nje efekt te rendesishem ne vepren penale ne pyetje dhe i akuzuari duhet te kete vepruar me dijeni qe veprimet e tij do te vinin ne ndihme ne kryerjen e vepres penale.

Nuk eshte e domosdoshme te dihet qe krimi preciz ishte me qellim apo eshte kryer, per aq sa i akuzuari ehste ne dijeni qe nje nga nje numer krimesh ndoshta do te kryhej, dhe nje nga keto krime ne fakt eshte kryer. Per nje krim te qellimit te caktuar, i akuzuari duhet te kete njohuri te krimet qe ai apo ajo eshte duke ndihmuar apo mundesuar. Nuk kerkohet qe i akuzuari te ndaje qellim me kryesin kryesor.

Ne rastin ne fjale egzistojne prova direkte dhe jo direkte qe te akuzuarit ne kohe te ndryshme ndihmuan ne arrestimin, ndalimin, ose rrahjet e viktimave, me qellimin e perbashket. Te akuzuarit Agron Krasniqi, Selim Krasniqi, Islam Gashi dhe Bedri Zyberaj jane identifikuar te tere nga deshmitare te ndryshem qe te kene ndihmuar ne planin e arrestimeve, ndalimeve, rrahjeve dhe duke dhene bashkryesve te tjere ne nje forme apo tjeter ndihme morale drejteperdrejt ose jo drejteperdrejt.

Pa kete ndihme aktive apo ndihme morale qe grupi nga Dranovci i dhane njeri tjetrit, krimet mund te mos ishin kryer. Si vizitore te rregullt te qendres se ndalimit ose te shtabit te UCK-se, ku disa nga marrjet ne pyetje jane bere, ata duhet te kene qene ne dijeni te numrit te ndalimeve si dhe qe ato vazhdoheshin si dhe vazhdimi i abuzimit te te ndaluarve.

Grupi kriminal (nderrmarja e perbashket kriminale)

Neni 26 i KP RFSJ mundeson si ne viim:

“kushdo qe krijon apo ve ne perdorim nje orgaizate, nje organizim kriminelesh, nje qeli, grup apo ndonje lidhje tjeter per qelim te kryerjes se veprave penale eshte penalisht pergjegjes per te gjithë veprat penale qe rezultojne nga plani kriminal i ketyre lidhjeve dhe do te denohet sikur ai vet ti kete kryer ato, pamvaresisht nese ai, dhe ne cfare menyre ai vete ka marre pjese drejteperdrejt ne kryerjen e ketyre veprave.”

Gjykata eshte mbeshtetur ne ne arsyetimin e gjyqtarit paraprak³²⁵ ku thuhet; “Neni 26 i KP RFSJ eshte analog me doktrinen e nderrmarjes se perbashket kriminale (apo qellim ose plan te perbashket), sic eshte interpretuar nga ICTY ne ceshtjen Tadic. Sipas kesaj doktrine kur nje krim rezulton nga veprimet e disa personave, te gjithë personat jane njejesisht pergjegjes nese ata marrin pjese ne veprim cilido pozicioni i tyre dhe masa e kontributit dhe qellimi per tu perfshire ne veprimin kriminal te perbashket”.

Vendimi Tadic thote: “nuk eshte e nevojshme qe ky plan apo qellim te jete planifikuar apo formuluar me heret. Plani i perbashket apo qellimi mund te materializohet pa pergatitje dhe mund te konkludohet nga fakti i pluralitetit te personave qe veprojne ne unison per te zbatuar nderrmarrjen e perbashket penale...” Per me tej pergjegjesia per nje krim pervec asaj qe eshte rene dakort apo marre me mend ne fillim mund te ngrihet nese ishte e parapare qe nje krim i tille mund te kryhet nga nje apo anetare te tjere te grupit dhe i akuzuari me deshire e nderrmori ate rrezik.

Tri lloje te nderrmarrjes se perbashket kriminale jane identifikuar ne jurisprudencen e ICTY. Ato te tera kerkojne sipas *actus reus*, disa persona, egzistencen e nje plani te perbashket apo qellimi, qe vjen te apo perfshin kryerjen e krimit, shkelje qe parashikohet ne Nenin 142 KP RFSJ si dhe Neni i Perbashket 3 dhe Protokolli Shtese II, dhe pjesmarrja e te akuzuarit ne planin e perbashket.

Ne llojin e pare te nderrmarrjes se perbashket penale, i pandehuri, duke vepruar sipas nje qellimi te perbashket, ka per qellim te kryeje nje krim, dhe ky qellim eshte i perbashket te te gjithë bashke-kryesit. Qellimi i perbashket mund te konkludohet nga dijenia per planin dhe pjesmarrja ne avancimin e tij. Ne tipin e dyte te nderrmarrjes e perbashket kriminale i akuzuari ka njohuri per nje sistem represioni apo keqtrajtimi, ne te cilin ai/ajo merr pjese dhe ka per qellim ta coje me tej planin per te keqtrajtuar. Ne kete rast rekuizita qellim mund te konkludohet nga dijenia e provuar e krimeve te kryera dhe vazhdimi i pjesmarrjes ne funksionimin e sistemit te keqtrajtimit, si dhe nga pozicioni i autoritetit te mbajtur nga nje i akuzuar. Lloji i trete i nderrmarrjes se perbashket kriminale ka te beje me ceshtje ne te cilat nje prej te akuzuarve kryen krim jashte planit te perbashket dhe krimi ishte pasoje “e natyrshem dhe e parapare” e planit ose qellimit te pergjithshem.

Mens rea ne raste te tilla eshte e dyfishte. Se pari i akuzuari duhet te kete qellim per te marre

³²⁵ Ruling of Confirmation Judge, Timothy Baland, 21 May 2005.

pjese ne dhe te kontribuojte per qellimin e perbashket kriminal. Se dyti ne menyre qe te mbahehsh pergjegjes per krime qe nuk kane qene pjese e qellimit te perbashket kriminal, por qe sidoqofte ishin nje pasoje e natyrshme dhe e parashikuar e tij, i akuzuari duhet te dije qe nje krim i tille mund te kryhet nga nje anetar i grupit, dhe me deshire te marre parasyh rrezikun qe krimi mund te kryhet duke ju bashkangjitur apo duke vazhduar te marre pjese ne grup. Prania e pjesmarresit ne ndermarjen e perbashket kriminale ne kohen e kryerjes se krimi nuk kerkoet.

Ne rastin aktual, plani i perbashket kryesor kriminal mund te sygjerohet nga veprimet e te akuzuarve dhe te pjestareve te tjere dhe ishte i thjeshte – arrestime te paligjshme, ndalime te te dyshuarve per bashkepunetore, ne disa raste ka vijuar me rrahje te tyre dhe trajtime brutale duke i mbajtur viktimat ne ndalim pa aplikuar dispozitat apo masa proceduriale. Prova demonstrojne qe kater te akuzuarit nga Maji deri ne Shatator kane vene ne shenjester civile Shqiptare, qe jane pare si bashkepunetore me Serbet, per ti arrestuar, burgosur dhe keqtrajtuar.

Gjate periudhave ne te cilat ata jane mbajtur, te ndalurit jane keqtrajtuar vazhdimisht ne menyra dhe ne kushte qe ishin denigruese dhe degraduese, me qellimin per ti “korrigjuar” apo “rehabilituar” ata. Plani u provua teresisht kur duke marre parasysh numrin e personave te arrestuar dhe te ndalur nga grupi i UCK-se se Dranovcit gjate nje periudhe kritike, metoda dhe menyra e arrestimit e njejte, kushte te cilave ju nennshtruan te durojne dhe natyra e akuzave.

Nje tjeter prove e fuqishme eshte qe te akuzuarit jane permendur me emra kohe pas kohe, ose individualisht ose bashkeveprim me te tjeret si ata qe kane ndermare arrestimet dhe ndalimet, qe kane marre pjese ne drejtimin e qendres se ndalimit, ose qe kane qene te perfshire ne marrjet ne pyetje dhe rrahjet. Gjithashtu mund te arrihet lehtesisht ne perfundim nga nje numer vizitash bere viktimave nga shoke dhe familjare te UCK-se ne Dranovc, qe te akuzuarit duhet te kene qene ne dijeni se shtate viktimat e para dhe te tjeret e ndaluar jane keqtrajtuar, rrahur dhe ndalur ne kushte te veshtira, dhe se ka patur nje rrezik serioz qe kjo te vazhdonte ne rast se ata nuk liroheshin.

Mohimi i Pergjithshem

Te gjithte te akuzuarit i mohua akuzat dhe i quajten ato genjeshtra dhe fabrikime. Te gjithte te akuzuarit kane mohuar teresisht perfshirjen e tyre dhe kane marre pozicionin qe atje ka patur nje konspiracion masiv per te akuzuar ata padrejtesisht. Ata pretendojne se kane qene pa autoritet, pa dijeni, nuk kane qene te eprfshire; qe nuk ka patur polici ushtarake; UCK-ja nuk ka qene organizuar; nuk ka patur qender ndalimi; nuk jane ndalur te civile dhe nuk ka patur keqtrajtime.

Per me teper te pandehurit Agron Krasniqi dhe Islam Gashi ngriten alibi ne linje te mbrojtjes. i pandehuri Selim Krasniqi ngriti alibi lidhur me daten ne Korrik pasi sipas tij dhe deshmitareve qe ai thirri, ai ishte ne kohen relevante ne Shqiperi.

Ne rastin e Agron Krasniqit ai theksoi se ai nuk mund te kishte qene ne zonen e Dranovcit ne kohen perkatese per aktakuzen pasi ai ishte duke studiuar ne Prishtine dhe udhetimi ne fshatin e tij ishte teper i rrezikshem nga aspekti i prezences se Serbeve.

Sa per Islam Gashin, mbrojtja e tij konsistoi ne ate se ai kishte marre plage serioze nga fundi i Majit 1998 dhe ishte pothuaj i handikapuar per te levizur dhe si rrejdhoje nuk mund te kishte qene ne vendet ku deshmitaret e ndryshem e kishin pare ate. Ne ndihme te kesaj ai thirri deshmitarin qe e ka mjekuar ate fillimsht dhe pastaj Dr H [REDACTED] qe e mjekoi me pas.

Edhe pse nje alibi quhet zakonisht mbrojtje, i takon prokurorise qe ta hedhe poshte, duke patur parasysh qe i akuzuari ka hedhur bazat duke permendur prova te mjaftueshme . kjo nuk behet rastesisht, kerkohet karakterizim i vecante i vendeve dhe aktiviteteve te ndermara nga te akuzuarit ne kohen qe veprat penale jane kryer. Edhe pse pesha mbetet gjithnje me prokurorine per te hedhur poshte alibine, nuk eshte e mjaftueshme per nje te akuzuar te thote thjesht qe nuk ka qene ne vendin e ngjarjes; ai duhet te paraqese prova qe ne menyre efektive do te perjashtonin prezencen e tij nga vendi i krimi pa patur ne ndonje menyre peshen e proves te hedhur mbi vete.

Pretendimet per Fabrikim

Kohe pas kohe te pandehurit deklaruan permes pyetjeve ose komenteve qe provat e udhehequra nga prokuroria ishin te fabrikuara.

Sipas mendimit te Trupit Gjykues nuk ka patur ngjashmeri te dukshme ndermjet provave te dhena nga deshmitaret. Deshmitaret ishin te kujdesshem per te identifikuar se cilet kishn pare me syte e tyre dhe pranuan ato gjera qe ata vete nuk i kishin pare por qe te tjeret ju kane treguar, apo te konkluduara nga obzervimet e tyre fillestare. Kur u vune perpara mosperputhjeve nga deklaratat e meparshme te dhena te gjyqtari hetues shume deshmitare ishin mjaft te sinqerte ne korrigjimin e deklaratave te meparshme. Deshmitare te tjere pretenduan per probleme ne perkthim, ose qe atyre ne ate kohe nuk u eshte kerkuar te elaborojne ne kohen kur jane marre ne pyetje nga gjyqtari hetues. Ndersa mosperputhjet ne provat e deshmitareve perpara gjyqtarit hetues dhe ne gjykimin kryesor mund te sygjerojne jo-kredibilitet, nga ana tjetere ata nuk percaktuan pretendimin qe faktet ishin te fabrikuara.

Provat qe implikojne te pandehurit

I pandehuri Selim Krasniqi

Sipas vete Selim Krasniqit, ai arriti ne zonen e Dranovcit rreth Majit 1998 per te marre pjese ne lufte. Ai pretendon te kete qene nje ushtar i thjeshte dhe qe nuk ju caktuan detyra te vecanta. Ai sherbeu ne zonen e Dranovcit gjate muajve Maj dhe Qershor si dhe gjate nje pjese te Korrikut kur ai pretendon te kete ikur per ne Shqiperi, duke u kthyer ne Kosove rreth dates 11 Gusht 1998. Ai mohoi cdo dijeni te civileve te ndalur ne Dranovc gjate periudhes kritike dhe kategorikisht hodhi poshte ndonje sygjerim qe ai ka qene i perfshire ne aktivitete te tilla. Edhe pse eshte referuar ne disa raste gjate marrjes ne pyetje nga policia dhe gjyqtari hetues per egzistencen e policise militare ne Dranovc ai kalonte ceshtjen e egzistences se tyre, gjate seances kryesore.

Ai pranoi qe bashkepunetoret jane intervistuar nga G [REDACTED] P [REDACTED] me qellim te sjelljes se tyre ne rruge te drejte. Ai me tej pranoi qe UCK-ja okupoi ndertesen e agrikultures ne Dranovc dhe

kishte zyra ne ndertesën e shkolles se vjeter, por jepte pershtypjen qe ai ka njohur shume pak per kete dhe pretendoi se nuk kishte punuar atje. Pervec qe kishte pare H. K. ai nuk dinte asgje per personat e tjere te humbur, edhe pse ai theksoi qe e kishte degjuar emrin e Sh. Sh. dhe se ky ishte shoqeruar me bashkepunetoret. Ai me vone i dha nje shpjegim kontradiktor panelit per kete. Ai deklaroi se nuk kishte veshtiresi me ndonje nga lokalet.

Trupi Gjykues analizoi keto prova ne driten e provave te deshmitareve te ndryshem dhe konkluzioni eshte qe nje pjese e madhe e mohimit te Zt. Krasniqi tingellon bosh dhe e pavertete. Provat e te pandehurit vete dhe disa deshmitare te degjuar, demonstrojne qarte pjesmarrjen e tij aktive ne ngjarje. Ne disa raste, provat tregojne per pjesmarrjen aktuale te te pandehurit Selim Krasniqi ne rrahjet dhe keqtrajtimin e viktimave.

Ne deklaraten e tij ne polici, i pandehuri Bedri Zyberaj deklaroi se Selim Krasniqi "filloi pune ne Shtabin tone." Pytje eshte perse Bedri Zyberaj do ta permendte ekte po te mos ishte e vertete. Kjo eshte kontradikta e pare qe i pandehuri Selim Krasniqi i tregoi Gjykates.

Ne 2 Qershor 1998, Sh. Sh. eshte ndalur kur shkoi te takonte UCK-ne ne Dranovc. Sipas deklarates se tre anetareve te familjes Sh., H. M. ju tha atyre, i cili kishte shoqeruar Sh. ne Dranovc, qe Selim Krasniqi ose Celiku ishte njeri prej atyre qe kishin qene pergjegjes apo kishin dijeni per ndalimin e Sh. H. M. mohoi kete kur u thirr per te dhene prova dhe erresoi emrin e familjes Sh. duke sygjeruar qe ata e kishin kercenuar ate, por nuk ka asgje per te sygjeruar qe keta dehsmitare po genjejne.

Fjalet e raportuara te H. M. nuk jane te mjaftueshme ne vetvete per te provuar perfshirjen e Selim Krasniqit ne kete apo ne ngjarje te tjera. Sidoqofte ka nje numer faktoresh mbeshtetes qe konfirmojne prezencen dhe perfshirjen e tij ketu.

Ka patur prova qe ndermjet 3 dhe 7 Korrik 1998, B. B. H. K. dhe H. P. jane rrembyer nga bashke-te pandehurit e Selim Krasniqit dhe jane ndalur ne ndertesën e shkolles se vjeter te Dranovcit. Prania e H. K. te shkolla e vjeter eshte konfirmuar nga vete Selim Krasniqi, qe i tha policise, Gjyqtarit Hetues dhe Trupit Gjykues qe ai pa H. K. ndersa po e sillnin ne shkollen e vjeter.

Deshmitari Anonim "A", qe kishte shkuar UCK ne Dranovc ne 4 Qershor 1998 ne kerkim te B. B. ka deshmuar ka qene i/e ndalur per tre dite gjate se ciles kohe ai/ajo takoi B. B. Sh. Sh. dhe nje fare H. nga fshati i Denjes me rojet e UCK-se. Deshmitari anonim "A" vuri re qe faqja e B. B. ishte e skuqur, ndersa Sh. Sh. dhe H. ishin te mbuluar me gjak. Deshmitari Anonim "A" deshmoi se gjate tre diteve te para ai/ajo u rrah nga tre meshkuj, njerin prej te cileve e identifikoi si Celikun dhe me vone mesoi se ishte Selim Krasniqi. Deshmitari anonim "A" deklaroi se ai/ajo u lirua por u ndal perseri disa dite me vone ne Dranovc ku ajo ai perseri u rrahen nga Celiku dhe te tjeret.

Ne rastin e dyte, qe del se ka qene diku rreth 10 Qershorit 1998, Deshmitari anonim "A" pa Sh. Sh. i cili sipas atij/asaj ishte i mbuluar ne gjak bashke edhe me nje te burgosur tjeter te quajtur H. P. te cilin e pershkroi te mbuluar me gjak gjithashtu. Deshmitari Anonim "A" i mesoi emrat e tyre ndersa ata ishin te ndalur dhe emrat me vone jane konfirmuar nga

anetare te familjeve te viktimave

Deshmitari Anonim "A" pershkroi Selim Krasniqin per kolegjin si diku ndermjet 170 dhe 175 cm te gjate, jo te shendoshe, jo te dobet, ndersa ajo/ai dha nje pershkrim tjetër perpara Gjyqtarit hetues. Ai/ajo sidoqofte nuk ishte ne gjendje per te dalluar te pandehurin Selim Krasniqi nga nje rreshtim pamor fotografish te prezantuara gjate hetimeve apo gjykimit kryesor per shkak te shikimit te dobet.

Te dy Deshmitaret Anonim "N" dhe "TT" deklaruan qe te nesermen pas arrestimit te H [REDACTED] K [REDACTED], ata shkuan ne Shtabin e Dranovcit ku u takuan me anetare te ndryshem te UCK-se duke perfshire ketu edhe Selim Krasniqin qe ju tha atyre se ai nuk dinte asgje per zhdukjen e H [REDACTED] pamvaresisht faktit qe ai kishte thene se ai e kishte pare H [REDACTED] nje dite me pare. Gjate hetimeve Deshmitari anonim "TT" rikujtoi qe kur ai/ajo shkuan per te folur me Bedri Zyberaj i tha atij/asaj qe ata duhet te flisnin me Selim Krasniqin pasi kjo ishte kompetenca e tij dhe ai ishte komandanti i policise.

Deshmitari anonim "TT" gjithashtu identifikoi te gjyqtari hetues qe ai/ajo shkoi perseri ne ditet ne vijim dhe perseri bisedoi me Selim Krasniqin, i cili ne ate kohe pranoi qe te merrte rrobat per tu nderruar dhe ushqim per H [REDACTED]. Disa jave me vone te dy deshmitaret anonime "N" dhe "TT" u lejuan per te pare H [REDACTED] dhe Selim Krasniqi ishte i pranishem. Gjate deklarates tij/saj perpara Trupi Gjykues, deshmitari anonim "TT" pretendoi se ai/ajo nuk mbante mend te kishte permendur Selim Krasniqin gjate hetimeve. Sidoqofte deklaraten e policise se 2 Qershorit 2001 ai/ajo qarte permend qe ka takuar dhe biseduar me Selim Krasniqin ne disa raste.

Pamvaresisht kesaj Deshmitari anonim "N" doli qe nuk i qendroi deklarates se meparshme ku implikonte Selim Krasniqi, duke i sygjerruar Trupit Gjykues qe ai/ajo kishte permendur Z [REDACTED] K [REDACTED] dhe jo Selim Krasniqi. Sidoqofte perseri ne deklaraten e 29 Nentorit 2001 te policise, kur identifikoi fotografine e Selim Krasniqit, ajo/ai deklaroi se ai/ajo kishin leje nga Selimi qe te vizitonte H [REDACTED].

Te dy deshmitaret "TT" dhe "N" dhane nje pershkrim te arsyeshem dhe te sakte te te akuzuarit, por me e rendesishme ishin ne gjendje qe te identifikonin te akuzaurin nga fotografite e prezantuara.

Prova e Deshmitarit anonim "A" me tej implikon Selim Krasniqin ne ndalimin e H [REDACTED] P [REDACTED] disa dite perpara 7 Qershorit 1998 ne vazhdim te te ciles ajo/ai ehste marre ne pyetje lidhur me lidhjen e tij me H [REDACTED] R [REDACTED], nje polic. Ajo/ai u lirua po te njejten dite. Sidoqofte deshmitari Deshmitari "D" theksoi se Popaj perseri eshte ndalur ne 7 Qershor 1998 nga UCK-ja dhe eshte derguar ne Dranovc. Deshmitari anonim "Z" gjithashtu dha deklarate te qendrueshme qe ajo/ai shkoi ne Dranovc ne 16 Qershor 1998 per te pare per H [REDACTED] P [REDACTED] qe ishte marre ne 07 Qershor 1998. Nd dhenien e kushteve per lirimin e H [REDACTED] ai/ajo u kthye disa dite me vonedhe foli me Selim Krasniqin qe po bente negociatorin. Kur deshmitari Anonim i tha Selim Krasniqit qe ai nuk mund ti permbahej kushteve Selim Krasniqi u pergjigj: "kushtet qendrojne dhe nese e sillni ate person ju mund te merrni H [REDACTED]". Deshmitari Anonim "D" pretendoi te kete takuar Selim Krasniqin ne Qershor 1998 ne te cilen kohe Krasniqi e siguroi at qe P [REDACTED] "gjalle dhe mire".

Me tej kemi proven e Deshmitarit anonim “E”, i cili pretendon qe eshte marre me makine ne Dranovc gjate se ciles kohe eshte rrahur nga Selim Krasniqi dhe Reziku (gjithashtu i njohur si G P nje mik i njohur dhe shok i Selimit. Ne deklaraten e tij/saj ne polici ne 17 Korrik 2004 ai/ajo theksoi qe kjo ndodhi mesin e Qershorit 1998. Ajo/ai ishte sidoqofte jo ne gjendje per te identifikuar nga fotografite qe i jane treguar ne ndonje faze gjate procedures.

Deshmitari anonim “U” me tej deklaroi qe ose ne Qershor apo Korrik 1998 ajo ai eshte marre ne qendren e ndalimit nga Agron Krasniqi dhe nje tjetër. Ajo/ai eshte marre ne pyetje nga Selim Krasniqi, pas se ciles Selim Krasniqi urdheroi Agron Krasniqin dhe Z B ta rrahin deshmitarin anonim “U”. gjate hetimeve, Deshmitari anonim “U” nuk e identifikoi dot Selim Krasniqin nga fotografite, por gjate gjykimit kryesor ajo/ai njohen foton 8, qe ishte fotografia e Selim Krasniqit.

Sa i perket egzistences se qendres se ndalimit dhe marrjes ne pyetje te njerezve qe dyshoheshin te ishin bashkepunetore Serb, shpejgimi i Selim Krasniqit ishte se kishte nje q ender ku njerezit vinin per te dhene deklarata vullnetarisht nuk mund te pranohej pasi kjo ishte ne kontadikte me ate cfare ai kishte thene ne polici ne pyetjet e bera per bashkepunetoret e dyshuar. E as qe mund te pranohej ky shpjegim ne driten e provave marramendese te disa prej deshmitareve; qe atyre ju kishin thene qe viktimat ishin ndalur dhe po merreshin ne pyetje.

Selim Krasniqi shpjegoi se G P nuk e kishte permendur ate ai ndonjehere prezencen dhe marrjet e njerezve ne pyetje ne qendrat e ndalimit. Trupi Gjykues mendon se ky shpjegim ishte shume jo bindes, duke patur parasysh mardhenien e afert ndermjet atij te pandehuri dhe G P. Ne deklaraten e tij ne polici ne 17 Shkurt 2004 ai theksoi se UCK-ja po perpiqej per te korrigjuar njerezit; qe ai e dinte qe atje ishin disa zyra ku ata mbanin njerezit dhe se G P i kishte thene atij nje here qe ai kishte sjelle Shqiptare te Kosoves qe dyshoheshin te ishin bashkepunetore te Serbeve atje, dhe qe disa prej tyre i kishin kapur ne veprim.. ai e vizitoi G ne zyren e tij disa here, dhe tre ose kater here ai pa qe G kishte njerez ne zyrene tij qe po i merrte ne pyetje. Ai u pyet nese i qendronte ketyre deklaratave dhe dha shpjegimin ne vijim, “Une bie dakort me menyren se si e tregova por je me menyren qe sapo u lexua. Aty shkruhet q e personat jane mbajtur, por cfare kuptoni me fjalen ‘ mbajtje’? une gjithashtu thashe se njerezit kane qendruar atje derisa ata jepnin deklaratat e tyre apo derisa ata kane bere raportet”. The Trupi Gjykues ka mendimin se i pandehuri eshte kapur ne rrjeten e kontradiktave te tija dhe pasi ka kuptuar pasojat e deklaratave te tij ai u perpoq te dale prej kesaj duke dhene ate shpjegim³²⁶.

³²⁶ “ne rast se ka patur qender ndalimi ne Dranovc te Zatriq, i dyshuari thote qe ai e di se ata kishin disa zyra ku ata kane mbajtur disa persona. Keto zyra ishin nderteset e shkolles, perafersisht 500 metra larg nga Shtabi i UCK-se. G P ishte i pergjegjshem per kete dhe se ai gjithashtu ka zyrene e tij ne te njejten ndertese” dhe “pyetjet: kushi mbante disa persona atje, i dyshuari thoshte qe vetem G P kishte te drejte ti conte njerezit ne ate ndertese. Ne pyetjen se kush i sollli ne kete ndertese, i dyshuari thote qe ai kete nuk e di. G i tha atij nje here se ai i sollli Shqiptaret e Kosoves qe dyshoheshin per bashkepunetore te forcave Serbe, dhe se disa prej tyre i kishin kapur ne veprim. Gjate marrjes ne pyetje i dyshuari thote se ai nuk i di emrat e ndonjerit prej tyre qe u sollen ne zyren e G i dyshuari thote se e kihste viztuar zyren e G disa here dhe tre ose kater here ai pa qe G kishte njerez ne zyren e tij. Te cilet po imerrte ne pyetje kur kjo ndodhi i dyshuari foli me G per arsyet se perse i dyshuari e vizitoi G dhe i dyshuari pastaj u largua menjehere. ajo qe ai pa ishte G duke marre ne pyetje si raportuesi qe po e merr ate ne pyetje tani. Ai shton se nuk ka pare asgje tjetër ne zyren e G

I akuzuari prezantoi disa deshmitare alibie qe deshmuar qe ai ka shkuar ne Shqiperi fillim te Korrikut. Keto prova ishin nga shoke te luftes, te afert apo oficere te TMK-se me te cilet ai kishte sherbyer ne kohen e arrestimit. Deshmitari M [REDACTED] J [REDACTED] e ka njohur te akuzuarin, Selim Krasniqi, te cilin e takoi per here te pare 8 ose 12 Gusht 1998 ne Vlore³²⁷, (qe gjendet ne jug te bregdetit Shqiptar). Deshmitari shkoi ne Shqiper ne fund te Korrikut ne filim te Gushtit dhe u takua me Selim Krasniqin atje ndermjet datave 8 dhe 10 Gusht 1998.

Deshmitari R [REDACTED] R [REDACTED] theksoi se e kishte takuar Selim Krasniqin ne Tirane ne Korrik 1998. Mund te kete qene ndermjet datave 8, 9 ose 10 Korrik. Ai nuk ishte shume i sigurte per datat. Pastaj ai shtoi “ne kemi hyre ne Kosove ne 9 Gusht 1998”. Deklarata e tij ishte “ ne hypem ne taksi nga Tirana. Taksia ne coi ne Krume dhe pastaj ne hypem ne nje automjet tjetër. Nga Kruma ne shkuam ne nje fshat me emer Vlora. Atje ne ate fshat ne ndenjëm tre ose kater ore, perafersisht. Ate nate une kalova kufirin ndersa Selim Krasniqi qendroi ne fshtin e Vlores. Kur u ktheva ne Kosove, ne Drenice dy ose tre dite me vone degjova qe Selim Krasniqi ishte duke u kthyer ne Kosove”.

Ramiz Lladrovci deklaroi qe ai takoi Selim Krasniqin ne Tirane diku rreth javes se pare te Korrikut dhe qendruan se bashku dhe u takuan shpesh deri ne javen e fundit te Gushtit ne Tirane. Selim Krasniqi qendroi ne Shqiperi per nje muaj ndersa deshmitari qendroi me gjate. Deshmitari nuk e dinte kur Selim Krasniqi vendosi per tu larguar nga Shqiperia dhe ai u largua permes Kukesit (ne verilindje te Shqiperise, pothuajse ne kufi me Prizrenin ne Kosove) ne javen e fundit te Gushtit. Deshmitari e korigjoi veten dhe tha se ishte “pjesa e fundit e javes se pare te Gushtit” qe Selim Krasniqi u kthye ne Kosovë. Më vonë ka thënë se ka dy rrugë kryesore që të çojnë për nga kufiri verior, Durres ose Bajram Curri, por ai nuk e dinte se cilën ka marrë Selim Krasniqi. Selim Krasniqi u largua nga Tirana me R [REDACTED] R [REDACTED]. Pasi dëshmitari e kishte dhënë atë përgjigje, avokati mbrojtës për Selim Krasniqin ndërhyri për të thënë se dëshmitari nuk e kishte kuptuar pyetjen, por dëshmitari përsëriti se Selim Krasniqi ishte larguar nga Tirana për në veri të Shqipërisë me R [REDACTED] R [REDACTED]

Dëshmitari ka marrë vesh se Selim Krasniqi ka hyrë në Kosovë nga fundi i javës së dytë të Gushtit, mbase të Shtunë ose të Djelë. Ai informatat i ka marrë përmes telefonit satelitor të të vëllait, Fehmi. Ai nuk ka mundur që të japë datën e asaj telefonate por ka shpjeguar “se mund të ketë qenë 11 ose 12 Gusht por “mos ma merrni për bazë sepse mund të ketë qenë disa ditë para ose dy ditë pas” megjithëse, e kishte përcjellë Selim Krasniqin dhe R [REDACTED] R [REDACTED] pasi ata kishin qenë të zyra e tij. Dëshmitari nuk ishte në gjendje të thoshte se çfarë transporti kishte përdorur Selim Krasniqi. Ai shtoi se mund të kishte qenë taksi ose transport me makinë që ishte siguruar për të.

F [REDACTED] B [REDACTED] tha se mw 6 Korrik 1998, kur ka ardhur të vendbanimi i tij në fshat se gruaja i kishte treguar se dy miq po flinin aty. Ata kishin shkuar aty për të vazhduar më tej në Shqipëri. Shtëpia e dëshmitarit ishte bazë pritjeje për ushtarët që kalonin ose ktheheshin për/nga

dhe nuk njeft asnjërin nga personat qe ai pa ne zyren e Ganiut..” Ekstrakte nga 17 Shkurt 2004 deklarata e policise se Selim Krasniqit.

³²⁷ Ne procesverbalin e gjykimit ky emer ka hyre gabimisht i shtypur si

Vlane

Job No.:AA2937
Created on

Path name: my documents/altina's alb doc Selim Krasniqi verdict/ Boolell
Translated by: ER 1-20,GI21-35,ASH 36-48, TK 49-61, OGJ 62-74,ARW 75-87,
ID88-102

Comp. No.:016
Page 85 of 99

Shqipëria. Dy miqtë ishin Selim Krasniqi dhe H. K. Dëshmitari njoftoi disa shokë të cilët e shoqëruan Selim Krasniqin dhe H. K. Dëshmitari mbeti pas dhe nuk ishte në pozitë që të thoshte nëse vertetë të dy të ftuarit u larguan për në Shqipëri, por ka marrë njoftime nga persona të tjerë se ata të dy ishin nisur për Shqipëri.

Trupi gjykues konstatoi se kishte mospërputhje materiale në dëshminë e dëshmitarëve të alibisë të thirur nga mbrojtja, R. R. dhe R. L. R. R. tha se Selim Krasniqi dhe ai u larguan nga Tirana për të shkuar në Krumë dhe prej aty në Vlorë ku kaluan tri deri në katër orë. R. L. nga ana tjetër, tha se ai dhe Selim Krasniqi u larguan nga Tirana përmes Kukësit duke marrë rrugën përmes Durrësit. Dy dëshmitarë që dëshmuan largimin e Selim Krasniqit dhanë dy versione të ndryshme mbi rrugën dhe destinacionin e të akuzuarit. Gjykata e konstatoi këtë provë si kontradiktore dhe të paqëndrueshme e për rrjedhojë e hodhi atë poshtë. Gjykata u beson provave të parashtruara nga prokuroria lidhur me praninë e Selim Krasniqit në Dranovc/Drenovac në Korrik dhe Gusht të cilat në pjesën e tyre dërrmuese e hedhin poshtë alibinë e Selim Krasniqit se ai ka qenë në Tiranë gjatë periudhës së cekur prej tij.

Aktakuza i akuzon të pandehurit për ngjarje të cilat ndodhën në datat midis Majit dhe Gushtit 1998. Ka prova se Selim Krasniqi e ka vazhduar marrëdhënien e tij me njësitin në Dranovc/Drenovac Gusht 1998.

M. B. dëshmoi se ai shkoi në Dranovc/Drenovac në fillim të Gushtit 1998 për të kërkuar të jatin, A. B. i cili ishte ndaluar më 13 Korrik 1998 dhe se Bedri Zyberaj e referoi te policia dhe i tha pyet për Çelikun. Atij I. B. i tha se Selim Krasniqi ishte Çeliku dhe se ai ishte kryesori në polici dhe se Avdi Berisha ishte mbajtur në Dranovc. Kur Selim Krasniqi erdhi ai i tha Berishës se babai I tij ishte lëvizur në Drenicë dhe se për shkak të kushteve të rrugës nuk ka qenë e mundur të kthehej. Berisha ka dhënë një përshkrim të Selim Krasniqit dhe e ka identifikuar në një rreshtim fotografik.

Dëshmitari/ja anonim/e “D” gjithashtu tha se ai/ajo e ka takuar Selim Krasniqin në Dranovc/Drenovac në Shtator 1998 kur ai/ajo e ka pyetur për Hidaj Popaj.

Dëshmitari/ja anonim “W” dëshmoi se më 19 Gusht 1998, djali tij/saj ishte rrahur nga policia serbe. Pastaj është marrë nga ushtarët e UÇK –së të cilët e kanë marrë në pyetje se çfarë i kishte thënë policisë Serbe dhe pse ishte liruar. Djali i saj/tij i tha dëshmitarit/es anonim/e “W” se është rrahur nga Selim Krasniqi në një godinë shkolle në fshatin Dranovc/Drenovac. Kur djali mbëriti në shtëpi ai i tregoi dëshmitarit/es anonim “W” se ai/ajo duhet të shkonte te shkolla ditën tjetër në ora 9:00 paradite. Dëshmitari/ja anonim/e “W” bëri ashtu siç i tha djali. Me të mbërritur te godina e shkollës, Selim Krasniqi e ka quajtur tradhtar/e dhe e ka akuzuar atë se u ka dhënë ushqim Serbëve. Selim Krasniqi e ka qëlluar me shpullë atë dhe ai/ajo ka rënë nga karrikja. Gjatë gjykimit gjykimi ajo/ai e ka identifikuar Selim Krasniqin si personin që e ka rrahur atë nga rreshtimi i fotografive.

Gjatë gjithë procedurave asnjë nga dëshmitarët nuk ka dëshmuar të ketë pasur konflikt të mëhershëm me Selim Krasniqin. Megjithatë cilësia e identifikimeve të tyre ndryshon, të gjithë duket se janë të sigurt se Selim Krasniqi ishte ai që kanë parë apo me të cilin kanë biseduar.

Nuk ka arsye përse ata pa e ditur dhe në mënyrë të panevojshme do ta implikonin.

Nuk ka pasur prova të prezantuara gjatë hetimeve të cilat implikojnë drejtëpërdrejtë të akuzuarin në rrëmbime, ndalime, dhe keqtrajtim të M [REDACTED] Rr [REDACTED] ose Ha [REDACTED] T [REDACTED] të cilët ishin të arrestuar më 10 Qershor 1998 dhe 2 Korrik 1998 respektivisht. Megjithatë duke pasur parasysh se këta dy të ndaluar janë dërguar në Dranovc/Drenovac në kohën kur i akuzuari dihet që kishte marrë pjesë në ndalime të tjera dhe rrahje të shoqëruara me to, paneli konstatoi se është e arsyeshme të vihet në përfundimin se këta dy të burgosur gjithashtu janë mbajtur si pjesë e një grupi të zgjeruar kriminal pjesëtar i të cilit ka qenë edhe Selim Krasniqi.

Nga provat e kombinuara të dëshmitarëve, si edhe të të pandehurit, paneli konstatoi se është provuar se Selim Krasniqi ka qenë shumë i angazhuar në arrestimin, burgosjen, rrahjen, dhe keqtrajtimin gjatë periudhës Maj, Qershor, Korrik dhe Gusht 1998 të viktimave të përmendura në Aktakuzë, dhe se ai aktivisht ka marrë pjesë personalisht ose në bashkëpunim me një grup të përbashkët kriminal në këto akte.

Provat e dëshmitarëve të thirur nga prokuroria, të cilët kanë dëshmuar se ata e kanë parë dhe kanë folur me Selim Krasniqin, në Korrik, është gjithashtu bindëse që alibia nuk është e vërtetë.

I Pandehuri Bedri Zyberaj

Bedri Zyberaj nuk ka dhënë deklaram tjetër përpos atij të dhënë në polici. Në atë deklaram ai thotë se është bërë ushtar me UÇK-në në Mars 1998. Detyra e tij kryesore ishte shpërndarja e ushqimit dhe shpërndarja e informative. Ai ka thënë se kurrë nuk ka veshur uniformë ushtarake dhe se nuk ka pasur gradë specifike. E ka pranuar se e njeh Selim Krasniqin që nga Qershori 1998 kur ky i fundit nisi punë në shtabin e UÇK-së në fshatin Dranovc/Drenovac. Ai ka prezantuar dëshmitarë që dëshmuar mbi karakterin e tij, të cilët thanë se gjatë periudhës kritike, Bedri Zyberaj ka qenë i përfshirë në punë humanitare ose në menaxhimin e depove kur pranoheshin mallrat, të cilat ruheshin dhe u shpërndaheshin fshatarëve. Këta dëshmitarë nuk e panë kurrë atë në uniformë ose të armatosur.

Megjithatë, ky imazh i një personi me qëllime të mira, të arsimuar, të një personi që nuk dinte asgjë për arrestimet, ndalimet, rrahjet, dhe funksioni i të cilit ishte vetëm që të ndihmonte bashkë-fshatarët në fushën humanitare nuk mbështetet në provat e dhëna nga dëshmitarë të tjerë.

Ka prova se Bedri Zyberaj kishte influencë dhe mbante një pozitë autoriteti brenda në UÇK. Gjithashtu ka prova se Zyberaj rregullisht frekuentonte ose punonte në shtabin e UÇK-se në Dranovc/Drenovac. Në disa raste ai njihej si personi te i cili vinin për takime personat që vizitonin shtabin e UÇK-se ose të cilëve u referohej ai, si hap i parë në përpjekjen për të gjetur njerëzit e dashur. Ka edhe prova të tjera që e implikojnë në trajtimin jo-njerëzor që ka ndodhur atje.

Dëshmitari/ja anonim/e “B”, anëtarët e familjes Sh [REDACTED] M [REDACTED] dhe H [REDACTED] R [REDACTED] Dëshmitarët/et anonimë/e “TT” dhe “Z”, Dëshmitari M [REDACTED] B [REDACTED], kur kanë dhënë prova

periudhën kritike.

Gjatë Shtatorit 1998 ai ka qenë në gjendje që të ndihmojë me evakuimin e personave nga zona e Gajrakut për shkak të ofensivës serbe. Pas sulmeve të Shtatorit, atij i është dashur që të shkojë në Shqipëri dhe ai ka qëndruar atje për rreth një muaj e gjysëm. Në Januar 1999, ai është kthyer në Kosovë dhe i është bashkuar UÇK-së.

Megjithatë gjatë hetimeve, i akuzuari Selim Krasniqi ka thënë me siguri se Islam Gashi ishte emëruar në Policinë Ushtarake. Ajo deklaratë mbështetet nga ajo që i ka thënë N [REDACTED] R [REDACTED] nga fshati Dranovc/Drenovac panelit të kësaj gjykate kur dëshmoi se Islami ishte oficer policie.

I Akuzuari Islam Gashi dëshmoi gjatë hetimeve dhe në shqyrtim kryesor se nuk kishte provë anëtarësie me UÇK që mund t'i jetë dhënë; se ushtarët e UÇK-së zakonisht as nuk e njihnin njëri tjetrin, edhe në fshatra të vogla si Dranovc/Drenovac; se ai kishte shkuar të mblidhte armë për UÇK në 27 Maj 1998 më një person (Sakip Bellaqa) të cilin sapo e ka parë për herë të dytë në jetën e tij, por në të njëjtën kohë e ka ditur se ishte furnizues me armë për UÇK. Në ditën kur ka vënë jetën e tij në rrezik ai nuk e dinte se ku do t'i merrnin armët dhe se ku do të dorëzoheshin.

Sipas deklarimit të K [REDACTED] P [REDACTED] Islam Gashi ka qenë në gjendje që të shkojë te shtëpia e tij në këmbë, megjithëse kjo ndodhi fill pas marrjes së plagëve natën kritike, kur ai ka ecur në shtëpinë e tij nga vendi i ngjarjes ku e kishin qëlluar. Gjithashtu është edhe dëshmia e Dr. H [REDACTED] që e ka kuruar Islamin. Sipas Dr. H [REDACTED] pavioni mjekësor nuk ka pasur mjetet e nevojshme për të konstatuar qartë gravitetin e plagëve. Ato janë pastruar, është ndaluar gjakderdhja, dhe janë hequr pjesër e gëzhojave dhe plaga është fashuar. Dr H [REDACTED] deklaroi se Islami është shtruar në spital fill pas kësaj dhe ai e ka vizituar Islamin çdo ditë për ca javë ndërkohë që bënte vizitat e tij.

Dëshmitari/ja anonim/e "A" tha se është rrahur më 4 Qershor 1998 nga Islam Gashi, i cili ka përdor shkop me tel të përshtjellë rreth tij, dhe nga dy ushtarë të UÇK-së. Në ose rreth 10 Qershorit 1998, ai/ajo është sjellë përsëri në shtabin e Shtabin e UÇK-së në Dranovc/Drenovac dhe është rrahur përsëri nga Islam Gashi e të tjerë. Ndërsa ai/ajo nuk ka qenë në gjendje që ta identifikojë Islam Gashin në foto ose të japë një përshkrim të saktë fizik të të pandehurit referenca e tij/saj për Islamin si "Islam Isufi", emri i babait Isuf Sherifi, ishte e qartë dhe nuk linte vend për pasiguri se për kë bëhej fjalë.

Islam Gashi gjithashtu është parë rastësisht më 4 Qershor 1998 nga Dëshmitari/ja anonim/e "N" dhe Dëshmitari/ja anonim/e "TT" të cilët/at kanë dëshmuar rrëmbimin e Hysen Krasniqit dhe e kanë identifikuar Islam Gashin si njërin prej rrëmbyesve. Dëshmitari/ja anonim/e "N" gjithashtu e ka takuar edhe në një rast tjetër rreth 3 javë më vonë kur i pandehuri sëbashku me ushtarë të tjerë të UÇK ka qenë i pranishëm në dhomën ku Dëshmitari/ja anonim/e "N" është takuar me viktimën H [REDACTED] K [REDACTED] Kjo është provuar nga Dëshmitari/ja anonim/e "TT" sepse ata/o ishin bashkë në përpyekjet e tyre për ta gjetur viktimën. Dëshmitari/ja anonim/e "TT" tha se e ka parë Islamin në oborrin e shkollës me shokët e tij patericë. Dëshmitari/ja anonim/e "NN" dhe Dëshmitari/ja anonim/e "TT" e identifikuan të pandehurin në rreshtimin e fotografive dhe e përshkruan atë. Dëshmitari/ja anonim/e "TT", që ka qenë ushtar/e me UÇK-

në, tha se ai/ajo e ka parë atë në bazën e Policisë Ushtarake në fshat me një pjesë të fytyrës të mbuluar nga plaga. Ky/kjo dëshmitar/e nuk e ka ditur emrin e njërit prej rrëmbyesve dhe e ka quajtur “djali axhës së Islamit”. Në fakt ky ishte B [REDACTED] G [REDACTED], i cili ishte i afërm i të pandehurit Isuf Gashi. Kjo tregon qartë se Dëshmitari/ja anonim/e “TT” njihnte anëtarët e klanit Gashi.

Dëshmitari N [REDACTED] Rr [REDACTED] gjithashtu ka thënë se e ka parë Islam Gashin një javë më vonë më 11 Qershor 1998, kur ka shkuar në qendrën e mbajtjes në fshatin Dranovc/Drenovac për të kërkuar vëllanë/viktimën M [REDACTED] Rr [REDACTED]. Islam Gashi po qëndronte pranë të ashtuquajturës “zona e zyrave”, ishte me uniformë dhe pa shenja të dukshme plagësh. Ai gjithashtu e ka përzgjedhur Islam Gashin nga fotot në rreshim pamor dhe e ka bërë përshkrimin e tij.

Prania e Islam Gashit në qendrën e mbajtjes provohet më tej nga dëshmia e H [REDACTED] Rr [REDACTED] të cilit i kujtohej se e ka parë Islam Gashin në qendrën e mbajtjes më 12 Qershor 1998, kur ai, së bashku me N [REDACTED] Rr [REDACTED] kanë ardhur përsëri për ta kërkuar viktimën dhe kanë sjellë teshat të pastra. Ato/a ja kanë dhënë teshat të Akuzuarit Islam Gashi dhe Z [REDACTED] B [REDACTED]. Përsëri Dëshmitari e përshkruan të Akuzuarin dhe e njeh në fotot e prezantuara në rreshtim. Ky dëshmitar është nga i njëjti fshat me të pandehurin dhe i është referuar Islam Gashit “djali i Isuf Gashit”, që është i afërm i familjes Rr [REDACTED].

E [REDACTED] Rr [REDACTED] gjithashtu e ka parë Islam Gashin në rrethana të ngjajshme kur ka shkuar t’i japë teshat Muratit.

Dëshmitari/ja anonim/e “Z” e ka parë Islam Gashin të ulur në makinë me Rrezikun ditën kur trupi, që gabimisht është identifikuar si H [REDACTED] P [REDACTED], është gjetur. H [REDACTED] P [REDACTED] ishte rrëmbyer më 7 Qershor 1998 dhe kjo ka ndodhur disa ditë më vonë. Ai nuk ka vënë re shenja plagësh përderisa Islam Gashi nuk ka dalë nga makina.

Nuk ka dyshim se i pandehuri ishte plagosur në incidentin e datës 27 Maj 1998. Gjithashtu nuk ka arsye për të mos besuar të gjithë dëshmitarët të cilët kanë thënë se e kanë parë Islam Gashin në vende të ndryshme se gjoja e kanë akuzuar në mënyrë të rreme. Asnjë nga Dëshmitarët nuk ka pasur konflikt me Islam Gashin. Asnjë dokument i përshkrimit të plagëve nuk i është prezantuar nga mbrojtja gjykatës për të provuar llojin e rëndesës së plagëve që ai ka marrë. Dokumentet mjekësore nga Shtetet e Bashkuara që u prezantuan duhet të japin një ide të gjendjes së plagëve të tij ashtu si dukeshin në vitin 2002.

Paneli është i mendimit se nuk ka arsye që të hidhen poshtë provat e dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar se e kanë parë Islam Gashin. Nga provat në kombimin të dëshmitarëve, si edhe të të pandehurit, ka prova të cilat e implikojnë të pandehurin në arrestimet, mbajtjet, rrahjet dhe keqtrajtimet, dhe rrjedhimisht ai ka marrë pjesë personalisht ose i është bashkuar një shoqërie të përbashkët kriminale në periudhën kritike.

Paneli gjithashtu ka konsideruar edhe dëshminë e të pandehurit të dhënë mbi plagët e tija si edhe pamundësinë e tij për të lëvizur sëbashku me provat e dhëna nga dy Dëshmitarët e thirur nga ai, Dr. H [REDACTED] dhe K [REDACTED] P [REDACTED]. Paneli nuk ka gjetur arsye që t’i hedhë poshtë ato prova. Prezumohet se për këtë arsye, prokurori me shumë drejtë parashtrroi se nëse, pavarësisht nga

provat në posedim të prokurorisë, kishte dyshim në mendje të Gjykatës, i Akuzuari e ka të drejtën e avantazhit nga ky dyshim.

Përderisa provat e prokurorisë dhe ato të mbrojtjes qëndronin në të njëjtin nivel ligjor, trupi gjykues nuk kishte alternativë tjetër përpos t'i jepte të dyshuarit avantazhin e dyshimit bazuar në parimin *in dubio pro reo*.

I Pandehuri Agron Krasniqi

Nuk ka prova që provojnë se në të gjitha kohët materiale të përshkruara në Aktakuzë, Agron Krasniqi ishte anëtar i njësitit të Policisë Ushtarake me UÇK-në që vepronte në Denje dhe fshatin Drenovc. Disa Dëshmitarë dëshmuar se Agron Krasniqi ka vepruar me Policinë Ushtarake me UÇK-në, në arrestimin e disa civilëve shqiptarë të Kosovës ose ka qenë roje në qendrën e mbajtjes në fshatin Dranovc/Drenovac.

Edhe i Pandehuri Selim Krasniqi ka thënë se Agron Krasniqi ka qenë me Policinë Ushtarake sëbashku me Islam Gashin.

Pjesmarrja e tij në rrëmbime është në fillim përmendur nga Dëshmitari/ja anonim/e "N" që tha në gjykatë se Agron Krasniqi, sëbashku me Islam Gashin, Z. B. , dhe B. G. , kanë rrëmbyer viktimën H. K. më 4 Qershor 1998.

Dëshmitari/ja anonim/e "TT" (që ishte anëtar/e me UÇK-në) e ka konfirmuar deklarin e Dëshmitarit/es "N" lidhur me rrëmbimin e H. K. Të dy e kanë identifikuar të Pandehurin nga rreshtimi i fotografive.

Agron Krasniqi është parë përsëri nga N. R. i cili në mënyrë konsekuente e ka identifikuar Agron Krasniqin si njërin nga tri rrëmbyesit të cilët i kanë marrë vëllain, M. R. më 10 Qershor 1998. Ky Dëshmitar e njihte Agron Krasniqin përpara ngjarjeve dhe ka dhënë një përshkrim të të Pandehurit si edhe e ka identifikuar në rreshtimin e fotografive.

H. R. gjithashtu ka dëshmuar mbi rrëmbimin e M. R. dhe plotësisht e ka mbështetur deklarin e N. R.

Dëshmitari/ja anonim/e "U" dëshmoi se më 16 Qershor 1998 ai/ajo është rrëmbyer nga Agron Krasniqi dhe Z. B. dhe është sjellë në shtabin e fshatit Dranovc/Drenovac ku ai/ajo është marrë në pyetje nga Selim Krasniqi. Selim Krasniqi e ka urdhëruar Agron Krasniqin dhe Z. B. ta rrahë Dëshmitarin/en anonim/e "U". Ata e kanë rrahur Dëshmitarin/en anonim/e "U" me shkop për gjysëm ore. Ky/kjo Dëshmitar/e gjithashtu e njihte Agron Krasniqin nga përpara dhe ka dhënë përpos kësaj një përshkrim shumë të saktë të tij. Paneli gjykatës nuk ka pasur dyshim për provat e identifikimit. Do të ishte absurde që të vihej në përfundimin se ky/kjo Dëshmitar/e, apo dikush tjetër, do të harronte apo ngatërronte fytyrën e një personi të njohur më parë që e ka arrestuar, mbajtur dhe rrahur.

Dëshmitari/ja anonim/e "Z" tha se ai/ajo është takuar me Agron Krasniqin dhe Z. B. në stacionin e Policisë Ushtarake që ndodhej te shkolla e vjetër, ndërsa po kërkonin

për H■■■■ P■■■■ pas rrëmbimit të tij më 9 Qershor 1998. Ai/a jo ka dhënë një përshkrim të mirë të të Pandehurit, Agron Krasniqi, dhe e ka identifikuar nga rreshtimi i fotografive në shqyrtim kryesor.

Agron Krasniqi dëshmoi se i është bashkuar UÇK-së vetëm pasi është kthyer në fshatin e tij Denje më 21 Qershor 1998. Ai gjithashtu e ka mohuar t'i ketë njohur të Akuzuarit e tjerë duke përfshirë edhe Islam Gashin ose që të ketë pasur ndonjë lidhje me njësitin e UÇK-së në Dranovc/Drenovac. Ai pretendon se nuk ka pasur detyra specifike dhe se kurrë nuk ka shërbyer jashtë fshatit të tij. Gjithashtu ka thënë se ka udhëtuar në Shqipëri në fund të Qershorit 1998, ku ka mbetur deri në fund të Korrikut 1998. Është domethënëse të thuhet se në asnjë moment Agron Krasniqi nuk e ka përmendur se shoku i tij D■■■■ K■■■■ ishte me të në Shqipëri, megjithëse e ka thirrur D■■■■ K■■■■ si Dëshmitar dhe D■■■■ K■■■■ ka dëshmuar për atë udhëtim në Shqipëri.

Gjatë ditëve të tija studentore ai nuk udhëtonte përditë në fshatin e tij. Ai shkante në shtëpi një herë çdo dy ose tri muaj. Kështu që nuk ka qenë në Prishtinë gjatë kohës që ai pretendon se ka qenë atje përpara 20 ose 21 Qershorit 1998.

Midis datave të martesës së tij deri në datën që Agron Krasniqi u arrestua ai ka udhëtuar në Kosovë nga Zvicra dy ose tri herë gjatë pushime ose festive. Hera e fundit që ka qenë në Kosovo ishte përpara arrestimit në vitin 2005 gjatë verës së vitit 2004, 5 ose 6 Korrik, me sa i kujtohet atij. Pasi është vendosur në Zvicër, i Pandehuri nuk i kalonte gjithmonë verat në Kosovë, por mund të ketë qenë me pushime në Shqipëri ose Turqi³²⁸. Kur është pyetur nëse ka shkuar me pushu në vitin 2005, ai tha se jo sepse nuk ka pasur ditë leje atë vit. Atij i është bërë pyetja tjetër: “po na thoni se keni pasur pushime midis vitit 1999 dhe 2004, por jo gjatë vitit 2005”? I Pandehuri u përgjegj: “kam pasur leje dhe mund të shkoja në pushime, por nuk kam shkuar në Kosovë atë vit. Kam shkuar në Turqi”. Ai shpjegon se ka zgjedhur që të mos shkojë në Kosovë në vitin 2005 sepse i është dukur më e arsyeshme që të kalojë pushimet e verës diku tjetër. Ai e ka ditur për arrestimin e të akuzuarve të tjerë në vitin 2004, por kjo nuk ka qenë arsyeja pse ai nuk ka ardhur në Kosovë në vitin 2005 për pushime. Paneli këtë e ka konsideruar të jetë koinçidencë të veçantë dhe ka ardhur në përfundimin se i Pandehuri po i shmangej Kosovës pasi kishte mësuar për arrestimin e të pandehurve të tjerë.

Vetëm Dëshmitari, Z. S■■■■ K■■■■, që e ka pranuar se ka qenë i afërm dhe shok me Agron Krasniqin është prezantuar si Dëshmitar alibie për të Pandehurin. Dëshmitari tha se Agron Krasniqi ishte student në Prishtinë që prej vitit 1997 deri në fund të Qershorit 1998, mbase 20 Qershor. Ai nuk ka qenë i sigurt për datën e saktë. Vetë Dëshmitari ka qenë në Gjermani midis viteve 1994 dhe 1997 dhe ka mësuar se Agron Krasniqi po studionte Juridik në Prishtinë sepse këtë e kishte diskutuar me familjen e tij sepse Agron Krasniqi ishte i afërm në fis.

Sinan Krasniqi ka treguar interes të veçantë në studimet e Agron Krasniqit sepse kishte qenë jashtë shtetit për një farë kohe dhe kur është kthyer ka qenë i interesuar të mësojë për të afërmit e tij. Por nga fundi i Prillit 1998, nuk ka qenë i interesuar në studimet e Agron Krasniqit duke thënë se nuk ishte prindi i tij dhe se nuk e ka parë atë. Ai vetëm dinte se ai ka qenë student. Ai

³²⁸ Shih Procesverbalin e të Pandehurit Agron Krasniqi, 19 Korrik 2006, faqja 17.

tha se e dinte se Agron Krasniqi ka qenë gjithë kohën në Prishtinë midis viti 1997 dhe 1998. Ai shtoi gjithsesi se ka mësuar nga e ëma e Agron Krasniqit se ai kthehej në shtëpi një apo dy herë çdo muaj apo dy muaj.

Sinan Krasniqi konfirmoi se Agron Krasniqi është kthyer në Denjë pas studimeve në Prishtinë, diku nga Qershori 1998. Ai nuk ishte i sigurt nëse ishte 19, 20 apo 21 Qershor. Kur është pyetur nëse e priste që të kthehej Agron Krasniqin, ai tha se e ka takuar të Pandehurin rastësisht. Agron Krasniqi më pas ka udhëtuar në Shqipëri në fund të Qershorit 1998, ose në 28 ose në 29. Dëshmitari u kthye në 2 ose 3 Korrik, ndërsa Agron Krasniqi qëndroi në Shqipëri deri në fund të Korrikut 1998. Megjithatë Dëshmitari ka arritur ta mbajë mend këtë datë në mënyrë specifike, por nuk ka qenë në gjendje që të mbajë mend çfarë ka ndodhur një javë më vonë.

S ■■■ K ■■■ gjithashtu ka deklaruar se grupi i tyre nuk ishte pjesë e UÇK-së dhe se ka pasur kontakte minimale me strukturat dhe operacionet e saj. Ai tha se ata nuk kanë pasur nevojë për leje nga askush që të kalonin kufirin dhe të merrnin armët. Dëshmia e atij Dëshmitari, se çdo grup personash mundej lirisht të kalonte kufirin Shqiptar, që të blinte armë, nga “persona të panjohur” dhe të ktheheshin në Kosovë pa u ndaluar nga patrullat kufitare Serbe apo njësitë e UÇK-së, të cilët luftonin për kontrollin e kufirit në atë zonë, hidhet poshtë nga trupi gjykues. Në fakt ka prova se nuk ka qenë e lehtë që të kalohet kufiri. R ■■■ L ■■■ dha prova se ai dhe shokët e tij janë zënë në pritë nga forcat Serbe në të njëjtin rast, ndërsa sillnin armë për në Kosovë. Dy luftëtarë janë vrarë dhe disa janë lënduar.

Provat e S ■■■ K ■■■ nuk janë konstatuar të besueshme. Dëshmitari, i cili ishte në Gjermani midis viteve 1994 dhe 1997, tha se ka qenë i interesuar në studimet e Agron Krasniqit sepse ka biseduar për këtë çështje me familjen e tij, dhe sepse Agron Krasniqi ishte i afërm i familjes. Po ky Dëshmitar i cili ishte kaq i interesuar në studimet e Agron Krasniqit nga largësia në Gjermani, e ka humbur këtë interes në studimet e tij nga fundi i Prillit 1998 sepse nuk ishte prindi i Agron Krasniqit dhe se nuk e ka parë atë në fund të vitit 1998. Ai nuk ka pasur njohuri të drejtpërdrejta ose të tërthorta se Agron Krasniqi qëndroi në Prishtinë gjatë gjithë kohës në atë periudhë. Ai tha se e dinte se Agron Krasniqi ishte në Prishtinë gjatë kësaj periudhe por nuk e ka shpjeguar se si e dinte këtë fakt.

Mbrojtja në disa raste e ka theksuar se regjistrat e shkollës për frekuentimin e klasave nga Agron Krasniqit egzistojnë për vitin 1998 dhe se mund të disponoheshin për gjykatën nëse do të nevojiteshin, megjithatë i vetmi dokument që u prezantua në Gjykatë ishte një certifikatë e shkrimtores së Universitetit të Prishtinës ku konfirmohej se Agron Krasniqi ishte regjistruar në klasën e vitit 1997-1998 të vitit akademik. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, ai dokument nuk provon në asnjë mënyrë praninë e përditshme të të pandehurit në Prishtinë. Trupi gjykues e hedh poshtë këtë provë se kinse ai ka qëndruar në Prishtinë gjatë gjithë kohës kur veprimet ushtarake kishin nisur në zonat si Rahovec/Orahovac, Gjakova/Djakovica, dhe Malishevo/Malisevo, të cilat gjenden pranë fshatit të të pandehurit.

Paneli erdhi në përfundimin se alibia e Agron Krasniqit nuk është e besueshme në kontrast të drejtpërdrejtë me provat e dhënë nga dëshmitarët e prokurorisë, ku asnjëri nuk ka dëshmuar të ketë pasur një konflikt të athershëm apo prezent me Agron Krasniqin, dhe ku të gjithë ishin të

sigurt se ishte Agron Krasniqi ai që kishin parë apo me të cilin kishin pasur punë.

I Pandehuri gjithashtu tha se ai kurrë nuk kishte takuar ndonjërin nga të Pandehurit e tjerë përfshi edhe Selim Krasniqin. Kur është pyetur nëse do të kishte ndonjë arsye përse Selim Krasniqi e njihte atë, ai u përgjigj “Nuk e kam ditur se ai më njihte, por mund të më ketë parë gjatë ofensivës në Shtator”. I së njëjtës rëndësi është pohimi i tij se ai nuk ka marrë kurrë pjesë në betejën që ka ndodhur në Ratish, kur Selim Krasniqi vetë dëshmoi se mund ta ketë parë të Pandehurin në Ratish. Në këndvështrimin e trupit gjykues i Pandehuri është orvatur të tregojë se nuk ka pasur të bëjë me ndonjërin nga të pandehurit e tjerë kur të gjitha provat tregojnë se kjo nuk është e vërtetë.

Për sa i përket të pandehurve të tjerë Agron Krasniqi akuzohet për pjesmarrje në një shoqëri të përbashkët kriminale. Pjesmarrja e tij në krimet individuale me të cilat akuzohet është provuar qartë. Provat tregojnë dhe vërtetojnë se në veprim dhe bashkëpunim me të pandehurit e tjetër dhe persona të pa-identifikuar, ai ka marrë pjesë në arrestimet e paligjshme, mbajtjen dhe rrahjen e të burgosurve civilë, në egzekutimin e planit të përbashkët kriminal.

Rrjedhimisht gjykata mendon se është provuar dhe vërtetuar se të gjithë të Akuzuarit kanë luajtur një rol kyç në egzekutimin e planit të përbashkët përmendur më lartë. Nga provat e prezantuara i Akuzuari ishte drejtpërdrejtë i implikuar. Në raste të tjera kanë marrë pjesë në nivele të ndryshme. Në përgjithësi nuk ka dyshim se ata të gjithë kanë pasur pjesë kyçe përmes pjesmarrjes së drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

Tiparet Karakteristike të Krimeve të Luftës

“Përcaktimi statutor i krimit të luftës kundër popullatës civile ashtu si parashihet nga Neni 142 KP RFJ ndërtohet mbi veprat penale të radhitura nën këtë Nen, në atë mënyrë që vepra penale, në varësi të rrethanave, mund të drejtohet kundër popullatës civile si e tërë ose kundër individëve të veçantë apo pronës. Një krim lufte kundër popullatës civile mund të përmbajë disa veprime, disa prej të cilave, janë ordinere, dmth., jashtë kontekstit të situatës së konfliktit të armatosur pa egzistencën e hallkës shkakore të konfliktit të armatosur, që mund të kualifikohen si vepra penale, si përshebull vrasja, lëndimi trupor, vjedhja, rrëmbimi etj. Që të ndodhë veprimi penal i krimit të luftës kërkohet prania e një ose më shumë veprave të nënkuptuara; shumëllojshmëria e veprave të nënkuptuara gjithsesi nuk e përjashton tiparin karakteristik të aktit penal të krimit të luftës”³²⁹.

Duke mbështetur pozicionin e Ljubisa Lazarevic mbi konceptin e tiparit karakteristik të aktit të krimit të luftës³³⁰, Gjykata Supreme gjithashtu pranon “se koncepti i tiparit karakteristik për krimin e luftës nga Neni 142 KP RFJ nuk është absolut. Midisa skenareve faktikë të rasteve konkrete mund të ketë shembuj kur kualifikimi I disa veprave penale të nënkuptuara, si disa Krime lufte do të ishte i arsyetueshëm”³³¹. Gjykata Supreme më tej konstatoi se “veprime të shquajtshme për shkak të një kombinimi të elementeve subjektive dhe objektive, sidomos të elementit të qëllimit kriminal në raport me intervale domethënëse kohore midis veprimeve

³²⁹ Lënda Andjelko Kolasinac, Gjykim i Gjykatës Supreme, 22 Tetor 2003, No.AP-KZ 230/2003

³³⁰ Lënda Ljubisa Lazarevic, Komentar i Kodit Penal të RFSJ, 1995, Neni 142

³³¹ Lënda Andjelko Kolasinac, Gjykim i Gjykatës Supreme, i datës 22 Tetor 2003, No.AP-KZ 230/2003

penale duhet të trajtohen si Krime të ndara Luftë. Rrjedhimisht një keqbërës që jep apo egzekuton një urdhër për vrasjen e civilëve do të jetë i përgjegjshëm për një krim luftë pavarësisht nga shumëllojshmëria e akteve individuale të vrasjes, shumëllojshmëria e vendeve dhe koha në të cilën ndodhën veprimet e tij, për sa kohë që bashkësia e veprave penale të nënkuptuara vjen nga i njëjti urdhër që përbën sulm kundër popullatës civile në tërësi³³². Gjykata ka vënë re se “aktet e përsëritura të veprave të kryera sidomos kur kryhen në të njëjtën mundësi, do të justifikonin shpesh një përfundim për një qëllim të vetëm, ndërsa rrethanat që tregojnë këte të ndara të krimit të luftës praktikisht janë të rralla”³³³.

Paneli e mbështet këndvështrimin e shprehur nga gjykatësi për konfirmim se “Vendimi i Gjykatës Supreme në lëndën Kolasinac na bën me dije në mënyrë efektive që dy faktorë kryesorë duhet të merren parasysh kur vendoset nëse egziston tipari karakteristik i pluralitetit të krimit të luftës kundër popullatës civile: (1) koha e afërt e ngjarjes dhe nëse ato lidhen në mënyrë kauzale, dhe (2) uniteti i qëllimit kriminal dhe mundësisë”³³⁴.

Aktakuza e përmirësuar i akuzon të pandehurit për ngjarjet që kanë ndodhur në një periudhë specifike, nga 2 Qershori deri në 13 Korrik 1998, dhe të cilat kauzalisht lidhen përmes vendit të ngjarjes që është në qendrën e mbajtjes në Dranovc/Drenovac. Për më tepër fakti se të pandehurit ishin të gjithë pjestarë të UÇK-së që punonin në Dranovc/Drenovac sugjeron se ata kishin një qëllim të përbashkët në arrestimin, mbajtjen dhe marrjen në pyetje të civilëve Kosovarë të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet Serbe dhe ndëshkimin e tyre për kinse pabesinë e treguar ndaj UÇK-së, duke torturuar, rrahur dhe në disa rrethana duke i vrrarë.

Rrjedhimisht është e qartë se prokurori publik nuk e ka pasur të nevojshme që t’i akuzojë të pandehurit me katër vepra të ndara të Krimeve të luftës, por vetëm me një vepër penale të Krimeve të luftës, me katër Pika të ndara që shërbejnë për të identifikuar llojet e ndryshme të sjelljes që nëse vërtetohen do të arsyetonin konstatimin se krimi i luftës është kryer.

DËNIMI

Faktorët që e kanë përcaktuar Dënimin

Këta faktorë janë të rradhitur të Neni 64 i KPPK. Terminologjia e Nenit 64 të KPPK, që zëvendëson Nenin 41 të KP RFSJ, nuk është shumë e ndryshme në substancë. Në vlerësimin e ndëshkimit të duhur, Trupi Gjykues është udhëhequr nga komentaret e Nenit 41 të KP RFSJ dhe direktivat e adoptuara nga ICTY.

Faktori i parë është shkalla e përgjegjësisë penale të keqbërësit. “Përgjegjësia dhe fajësia si komponentë të përgjegjësisë penale janë të gradueshëm. Kjo është në veçanti e vërtetë për fajësinë. Jo vetëm që është e rëndësishme cila formë e fajësisë egziston në rastin në fjalë, por gjithashtu shkallëzimi mund të bëhet brenda formave individuale të fajësisë. Për shembull, është e rëndësishme se çfarë intensiteti kishte në dëshirën e keqbërësit që pasojat të ndodhnin.

³³² Lënda Andjelko Kolasinac, Gjykim i Gjykatës Supreme, i datës 22 Tetor 2003, No.AP-KZ 230/2003

³³³ Lënda Andjelko Kolasinac, Gjykim i Gjykatës Supreme, i datës 22 Tetor 2003, No.AP-KZ 230/2003

³³⁴ Aktvendim i Gjykatës Ndërkombëtar për Konfirmim, Timothy Baland, Gjykata e Qarkut Prizren, i datës 21 Prill 2005, Nr.PK. Nr. 17/2005

Në vlerësimin e elementit dashës në paramendim, është e rëndësishme që keqbërësi të ketë treguar këmbëngulje të dukshme dhe mizori³³⁵.

Faktori i dytë që duhet konsideruar ka të bëjë me “motivet për të cilat kryhet vepra. Motivet mund të vlerësohen nga ana etike, që është e domosdoshme për përcaktimin e ndëshkimit (për shembull, nëse dikush ka kryer një vjedhje për të plotësuar nevojat elementare të jetës apo për t’i luajtur në bixhoz)”³³⁶.

Faktori i tretë është “shkalla e rrezikut apo e lëndimit të objektit të mbrojtur. Kur parasheh ndëshkimin ligjvënësi vlerëson shkallën në të cilën një sjellje e caktuar, mund të kërcënojë apo paraqesë rrezik për objektin e mbrojtur. Megjithatë kur vendoset për dënimin, kjo rrethanë nuk mund të konsiderohet në mënyrë abstrakte, duhet të konkretizohet shkalla në të cilën vepra penale ka vënë në rrezik ose ka dhunuar objektin e mbrojtur. Arrihet aty duke vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, mënyrën e kryerjes etj., dhe sidomos pasoja është e rëndësishme në këtë aspekt”³³⁷.

Faktori i katërt ka të bëjë me “rrethanat nën të cilat është kryer akti. Këto rrethana janë të karakterit heterogjen. Ajo që do të kuptohet prej tyre, varet gjithashtu në rrethanat, mbi të cilat varet vlerësimi i seriozitetit të shkeljes apo kërcënimit ndaj objektit të mbrojtur, kuptohen në mënyrë të gjerë ose të kufizuar”³³⁸.

Nga Neni 64, siç shpjegohet nga komentari i Nenit 41 KP RFSJ, del se dënimi varet në të dy faktorët [1] faktorët që janë të lidhur me elementet e krimit dhe [2] faktorët që nuk janë të lidhur me elementet e krimit, por që kanë të bëjnë me rrethanat e aktit dhe keqbërësin dhe që ndryshe janë relevante për qëllimin e ndëshkimit.

Në lëndën Delalic³³⁹, Zdravko Mucic u shpall fajtor për vrasje me dashje dhe vrasje dhe për shkaktimin me dashje të dhimbjes së madhe ose plagëve të rënda trupore apo shëndetit, dhe trajtim mizor dhe torturë të disa personave. Ai është dënuar me shtatë vjet burgim. ICTY e ka konsidruar qëndrimin sfidues dhe mungesën e respektit të të pandehurit në procesin gjyqësor, dhe ndaj pjesmarrësve në gjykim, si edhe mungesën e vetëdijes të peshës së madhe që kanë ato vepra penale për të cilat akuzohej dhe solemnitetin e procesit gjyqësor.

Në lëndën Kvočka³⁴⁰ i Pandehuri u dënua me shtatë vite burgim për krime të persekutimit, vrasjes dhe torturës së kryer kundër të burgosurve vulnerabël, brenda një shoqërie të përbashkët kriminale dhe pjesmarrjes substantive në këtë sistem. Persekutimi përfshinte vrasjen sistematike dhe të gjerë, torturën, rrahjet, dhunimin seksual, ngacmimin, poshtërimin dhe abuzimin psikologjik dhe izolimin në kushte çnjerëzore të të burgosurve që mbaheshin pa ndihmë në kampet e të burgosurve. Shumë nga të burgosurit nuk kanë mbijetuar dhunës dhe vuajtjes intensive. ICTY konstatoi se pjesmarrja e tij në këtë shoqëri e ka bërë atë bashkë-

³³⁵ Stonajovic, Komentari i Kodit Penal të Jugosllavisë 1999, Neni 41.

³³⁶ Stonajovic, Komentari i Kodit Penal të Jugosllavisë 1999, Neni 41.

³³⁷ Stonajovic, Komentari i Kodit Penal të Jugosllavisë 1999, Neni 41.

³³⁸ Stonajovic, Komentari i Kodit Penal të Jugosllavisë 1999, Neni 41.

³³⁹ Delalic e të tjerë, ICTY Aktgjykim i Dhomës së Gjykatës, 16 Nëntor 1998, Lënda nr. IT-96-21

³⁴⁰ Kvočka, ICTY, Aktgjykim i Dhomës së Gjykatës, 2 Nëntor 2001, Case nr. IT-98-30/1-T.

kryes në shoqërinë e përbashkët kriminale. Ai ka luajtur një rol kyç në ndihmën dhe mbajtjen e funksionimit të kampit, gjë që e ka bërë të mundur vazhdimësi e krimeve. Në disa raste ai ka dhënë ndihmë të burgosurve dhe ka ndihmuar parandalimin e krimeve, por shumica e këtyre rasteve kishte të bënte me shokët ose të afërmit.

Në të njëjtën lëndë Dragolub Prcac u gjet fajtor për shkak të përgjigjegjesisë së tij penale individuale në vepra që kishin të bënin vrasjen sistematike dhe të gjerë, torturën, rrahjet, dhunimin seksual, ngacmimin, poshtërimin dhe abuzimin psikologjik dhe izolimin në kushte çnjerëzore të të burgosurve. Ai është dënuar më pesë vite burg. ICTY konstatoi se Prcac “morri pjesë si bashkëkryes në krimet që i viheshin në barrë për pjesmarrje në një shoqëri të përbashkët kriminale. Ai ndihmoi në mirëmbajtjen dhe funksionimin e kampit gjë që i lejoi krimet të vazhdonin. Në pak raste ai u ka ndihmuar të burgosurve dhe është orvatur të parandalojë krimet, por shumica e këtyre rasteve kishte të bënte me shokët ose ish-kolegë.

I Pandehuri Milojica Kos u dënua me gjashtë vite burgim për pjesmarrje në të njëjtat vepra penale në Kvocak dhe për shkak të dijenisë të krimeve të kryera kundër të burgosurve vulnerabël brenda një shoqërie të përbashkët kriminale dhe pjesmarrjes substantive në këtë sistem, gjë që i ka bërë të mundura krimet, e ka bërë atë fajtor dhe bashkëkryes të Krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, për persekutim, vrasje dhe torturë. Persekutimi përfshin vrasjen sistematike dhe të gjerë, torturën, rrahjet e të burgosurve.

Në lëndën Kronejelac³⁴¹ i Pandehuri është akuzuar për torturë; trajtim mizor; vrasje; skllavëri; persekutim për arsye politike, raciale dhe fetare; torturë; vepra jo njerëzore; vrasje; burgosje. Ai është dënuar që të kalojë shtatë e gjysëm vite burg.

Ndërsa lëndët e ICTY janë marrë si udhëzime, trupi gjykues është gjithashtu i vëmendshëm ndaj këshillës së Gjykatës Supreme të Kosovës mbi këtë praktikë dhe nevojës për të parë veprat specifike penale në dhënien e dënimit. Gjykata Supreme obzervon, “Lidhur me respektimin e standarteve të zbatuara nga tribunalet ndërkombëtare, Gjykata Supreme e konsideron të vendit për sa kohë gjykata i sheh bindëse dhe relevante faktet dhe ligjin e lëndës që po studion përpara saj. Me sa duket p.sh faktorët e përgjithshëm që e përcaktojnë dënimin të identifikuar nga gjykata sipas rasteve të përzgjedhura nga ICTY dhe ICTR nuk ndryshojnë shumë nga faktorët të përcaktuar nga Neni 41 KP RFJ. Gjykata gjithsesi duhet të ketë kujdes që konsiderimin e terminit kohor të ndëshkimeve të caktuara nga tribunalet ndërkombëtarë, pasi kjo do të përbënte vetëm një pikë referimi ku gjykata vlerëson faktorët vendimtarë në këto lëndë krahasuar me lëndën që e gjykon. Megjithatë një referim ndaj aktgjykimeve të tribunaleve ndërkombëtare nuk mundet që thjeshtë të zëvendësojë një diskutim substantiv lidhur gravitetin e krimit, përfshirë edhe elementet specifike të akteve që u vihen në barrë të akuzuarve, shqetësimet e parandalimit dhe specifikat e lehtësimit dhe të rrethanave rënduese kur ato janë të pranishme”³⁴².

Dënimet e shqiptuara kundër të Pandehurve

³⁴¹ Kronejelac, ICTY, Aktgjykim, 15 Mars 2002, Lënda nr. IT-97-25

³⁴² Veselin Besovic, Gjykim i Gjykatës Supreme i datës 7 Shtator 2004, Nr. AP-KZ NO.80 /2004

Job No.:AA2937

Path name: my documents/altina's alb doc Selim Krasniqi verdict/ Boolell

Comp. No.:016

Created on

Translated by: ER 1-20,G121-35,ASH 36-48, TK 49-61, OGJ 62-74,ARW 75-87,

Page 98 of 99

ID88-102

Provat e pranuar nga trupi Gjykses provojnë se disa viklima shumica e të cilave nuk janë gjetur më, janë rrëmbyer dhe mbajtur në rrethana që arrijnë trajtimin mizor. Provat e kombinuara të Dëshmitarëve përcaktojnë egzistencën e regjimit të ndëshkimit si edhe mbajtjen në një ambjent jo -njerëzor. Natyra e rrahjeve dhe kushtet e mbajtjes që rezultuan në plagë, megjithëse nuk e arrijnë pragun e akteve të ashpra, dhe të dhimbjes që kërkohet për kualifikimin e veprës së torturës si edhe shpjegohet në jurisprudencën e ICTY, megjithatë arrijnë mospërfilljen serioze ndaj te drejtave themelore të të burgosurve. Ata janë trajtuar në mënyrë poshtëruese dhe degraduese. Të drejtat e tyre fundamentale të trajtimit njerëzor janë shkelur. Së bashku me akte të tjera të kryera gjatë periudhës kritike, ato sigurisht që përbëjnë akte të trajtimit mizorose jo-njerëzor. Trupi Gjykses nuk gjeti rrethana lehtësuese. Përkundrazi, Trupi Gjykses e konstatoi qëndrimin e të pandehurve si sfidues. Ata ishin të obsesionuar me pretendimin se provat e sjellë kundër tyre ishte e sajuar dhe se prokuroria po poshtëronte dhe po përbuzte rolin që UÇK-ja ka luajtur gjatë luftës.

Rrjedhimisht, gjykata ka vendosur të caktojë dëhimin me shtatë (7) vite burg si dënimin e përshtatshëm në këtë lëndë.

Daktilografiste

Nina Maric

